



Gjiganti teknologjik, EON Reality zgjodhi UBT-në si partner për hapjen e qendrës së vetme në rajon për



Faqe 5

UBT certifikohet dhe vlerësohet me Çmimin e Ekselencës me Pesë Yje



UBT bashkorganizatore e Konferencës Ndërkombëtare për Siguri Kibernetike dhe Privatësi



Faqe 3

Prej korrikut, Kosova me standarde të reja të menaxhimit të projekteve



Faqe 4

Weller: Pavarësia e Kosovës nuk është e negociueshme



Faqe 7



UBT certifikohet dhe vlerësohet me Çmimin e Ekselencës me Pesë Yje



Recognised for Excellence 5 star

Awarded to:

UBT

April 2019

This certificate remains valid for 3 years.

Russell Longmuir

Edhe një vlerësim kulmor për Republikën e Kosovës. Si një dhuratë për 20-vjetorin e çlirimit. I ardhur, si gjithnjë nga UBT, që me dhjetëra herë e ka ngritur emrin e shtetit tonë në nivelet më të larta të edukimit, shkencës, inovacionit, ekselencës.

Këtyre ditëve, Këshilli i Ekselencës botërore, konkretisht Organizata e njohur për Menaxhimin e Cilësisë (EFQM), konfirmoi atë që tashmë dihet – UBT certifikohet dhe vlerësohet me Çmimin e Ekselencës me Pesë Yje.

Me këtë vlerësim, që është vazhdimësi e vlerësimit të mëhershëm, fituar në vitin 2014, të nivelit organizativ të ekselencës, UBT hyn në mesin e shumë universiteteve prestigjioze nga e mbarë bota që vlerësohen ekselentë në arsimin e lartë.

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi theksoi se EFQM e vlerësoi UBT-në për politikën e prezantuar nga institucioni, zhvillimin e aftësive dhe për menaxhimin që, sipas ekipit vlerësues, i kalon kufijtë organizativë.

Tutje, rektori Hajrizi tha se raporti i kësaj organizate konstaton se, përveç numrit të madh të programeve inovative që institucioni numëron, UBT ka rol të jashtëzakonshëm për komunitetin, industrinë, etj.

“Kontributi i UBT-së në Republikën e Kosovës demonstron në mënyra të shumta dhe qeveria lokale dhe qendrore i drejtohen UBT-së për mbështetje dhe ekspertizë. UBT tejkalon shumë atë që pritjet prej tyre në këtë fushë, për shembull, objektivat e rekrutimit përmbushen dhe tejkalojnë vazhdimisht. Kur Ekipi i Vlerësuesve pyeti se pse rekrutimi i tejkaloj kërkesat, përgjigja ishte se, duke pasur këto persona shtesë, UBT po

përparon në mënyrë aktive”, thekson Hajrizi.

Ndërsa eksperti i ekselencës, Andre Haynes, i cili e vlerësoi UBT-në përgjatë tërë procesit të marrjes së ekselencës, e konsideroi UBT-në si prijës dhe model menaxhimi që duhet ndjekur nga të gjitha institucionet tjera arsimore në Evropë.

“Unë mendoj që UBT është një institucion shumë i këndshëm, mënyra e të mësuarit, mënyra se si profesorët sillen dhe stafi mbështetës, është absolutisht e shkëlqyeshme”, theksoi Haynes, duke përcjellë përshtypjet e tij, pas disa vizitave dhe njohjes me punën e UBT-së.

Ai është shprehur i kënaqur me angazhimin e UBT-së për plotësimin e kriterëve të ekselencës.

“UBT është një organizatë shumë impresionuese në të gjitha mënyrat. Çdo organizatë që aplikon për çmim të ekselencës nga EFQM duhet të shikojë modelin e ekselencës dhe duhet të përputhet në të shkruar dhe në të folur me atë që ndodhet në atë model, e UBT ka bërë përpjekje shumë të mira që ta bëjë këtë. Nuk do t’i merrte pesë yje dhe 500+ pikë po të mos tregojë efektiv në kryerjen e kësaj përgjegjësie”, tha Haynes.

Qindra universitete, kolegje e institucione të ndryshme në mbarë botën konkurrojnë në vazhdimësi për ta marrë Çmimin e Ekselencës, por të rralla janë ato që kalojnë pragun e 500 pikëve.

Haynes shpjegon: “Shumë kompani të të gjitha llojeve, tash ndoshta mijëra përreth Evropës, janë duke e shfrytëzuar këtë kornizë për të kuptuar se çfarë janë duke bërë dhe për të menduar rreth përmirësimeve. Më pak se kaq, me gjasë qindra, kanë aplikuar për çmime të ekselencës, dhe prej tyre, ndoshta më së shumti vetëm 1/3 kanë shkruar mbi 400 pikë. Arritja e 500 pikëve, që është pragu i të aplikuarit për çmime të ekselencës në Evropë, tash edhe në mbarë globin, është arritje e madhe dhe UBT e ka arritur”.

Për Haynes, UBT është një prijës. “Nuk njoh organizatë në Ballkanin Perëndimor që e shfrytëzon modelin e ekselencës në mënyrën e njëjtë, dhe mendoj që është pjesë e lidhjeve ndërkombëtare me organizatat tjera në Evropë. është bërë pak punë në Slloveni, por jo në arsim. Ka filluar të bëhet pak punë në Rumani, por përsëri, jo në sektorin e arsimit, prandaj vërtetë UBT është prijës”, thekson eksperti i ekselencës, Andre Haynes.

Gjithashtu, UBT është vlerësuar me çmime të shumta dhe është certifikuar edhe me ISO standarde.



IMPRESUM

UBT News – gazetë e studentëve

Botues: Edmond Hajrizi

Numrin e përgatitën: Jehona Kapllani, Anisa Rada, Edona Jerliu, Fatbardhë Kiqina dhe studentët e Media dhe Komunikimit

Adresa: www.ubt-uni.net / Tel: 038 541 400, 044 541 400

Përgatitje grafike: Milot Reçica

Siguria kibernetike dhe privatësia vazhdon të jetë sfidë serioze për Kosovën dhe vendet tjera

UBT bashkorganizatore e Konferencës Ndërkombëtare për Siguri Kibernetike dhe Privatësi



Inovacioni dhe teknologjia po zhvillohen në një ritëm të shpejtë, andaj sulmet kibernetike janë bërë kërcënim i madh për sigurinë dhe privatësinë në Kosovë dhe mbarë botën, për çka duhet angazhim i përbashkët me institucionet dhe akademinë. Kështu u tha në Konferencën Ndërkombëtare për Siguri Kibernetike dhe Privatësi, organizuar nga Cyber Security and Privacy dhe UBT, mbështetur edhe nga Ministria për Inovacion dhe Ndërmarrësi.

Në ditën e parë të punimeve, konferenca mbledhi përfaqësues të institucioneve shtetërore, përfaqësues nga Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Kroacia, Bullgaria, përfaqësues të Agjencionit të Bashkimit Evropian për Sigurinë e Rrjetit dhe Informacionit "Enisa", të kompanive të njohura në botë, si Facebook, Google, HackerOne, etj.

Hapjen e edicionit të katër të kësaj konference e ka bërë rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, i cili theksoi se kjo ngjarje ka për qëllim vetëdijësimin e popullatës për siguri kibernetike, andaj kërkoi edhe bashkëpunim për mbrojtje nga sulmet kibernetike.

"Sigurisht, është ngjarja më e madhe dhe Kosova e meriton një konferencë të tillë. Duke marr parasysh pjesëmarrjen e madhe të Kosovës në fushën e IT, kjo është një nevojë. Kjo është çështje serioze. Me rritjen e digjitalizimit në mund të kemi probleme në aspektin financiar dhe gjëra të tjera. Nëse humbin të dhënat, prej tyre 40 për qind nuk mund të rikthehen. Pra nuk është një dëshirë, por është një masë e nevojshme që të merret seriozisht. Në të gjitha fushat ka nevojë në Ballkanin Perëndimor, po ashtu edhe Kosova. Element që duhet bërë është partneriteti që të parandalohen krimet kibernetike në mënyrë që të reagojmë", potencoi rektori Hajrizi.

Tutje, rektori Hajrizi tha se UBT ka arsim cilësor, merret me shkencë dhe si institucion gjithnjë do të kontribuojnë për siguri kibernetike.

"Ne si UBT kemi liri të veprojmë sepse kemi të akredituar programe për siguri kibernetike, ofrojmë trajnime, kemi krijuar CERT-in, gjitha këto mundësi janë për ti ofruar studenteve ambient adekuat në mënyrë që ata të punojnë në ngritjen e kapaciteteve", tha Hajrizi.

Me anë të një videoprezantimi nga SHBA, ministri i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, tha se është e nevojshme që shteti i Kosovës të krijojë ambient të sigurt për mbrojtjen e të dhënave.

"Secili qytetar secili institucion bashkërisht të merremi me aktivitete të cilët duhet të krijojmë një ambient sa më të sigurt për të dhënat të cilat kanë përhapjen e të dhënave, por njëkohësisht për fëmijët të cilët janë të ekspozuar në mënyrë masive gjatë kësaj periudhe në rrjete sociale të cilët mund të denigrojnë funksionimin e tyre", tha Beqaj.

Gjithashtu, kryetari i Cyber Security and Privacy, Mentor Hoxhaj, tregoi se synimi i këtij komuniteti është që edhe Kosova të jetë pjesë ose të identifikohet në hapësirën kibernetike. Ai tha se vendit i mungojnë edhe standardet e sigurisë dhe privatësisë kibernetike.

mi kibernetikë po prek çdo pjesë të jetës. Në këtë fazë askush nuk është imun nga krimi kibernetikë. Duhet të ekzistoj bashkëpunimi që të paktën mbrojtja duhet të jetë e pranueshme. Aktualisht në top 10 kompanitë më të mëdha, katër janë nga teknologjia informative. Të rinjtë e Kosovës po e shohin mundësinë të hyjnë në tregun botëror. Fokusi në teknologji informative është fokus në të ardhmen. Kjo konferencë do të ndikoj pozitivisht në edukimin qytetar dhe rritjen e vetëdijes", tha Gashi.

Pjesë e diskutimeve në këtë konferencë ishte edhe përfaqësuesja e Facebook-it, Gabriella Cseh, e cila tha ky rrjet social është i fokusuar në çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave, privatësinë, të drejtat e njeriut dhe internetin, tregun digjital, sigurinë në internet, internetin e hapur etj.

"Viteve të fundit Facebook dhe Instagram kanë qenë të ngarkuara duke u marrë me këto probleme, kanë qenë probleme sociale të publikut. Në fakt jemi marrë me këto çështje dhe kjo është rruga që po vazhdojmë të ecim dhe jam shumë lumtur për privatësinë e përdoruesve që përdorin rrjetet sociale nga shtëpitë e tyre. Është një diskutim i madh në botë kur është fjala për rregullat e përdoruesve, nëse e dimë që interneti është kaq i rëndësishme dhe të afektonte secilën pjesë të jetës sonte, përdoruesit duhet të ishin në gjendje të përcjellin rregullat e Facebook-it. Do të ketë zgjidhje vitet e ardhme dhe ne po mendohe mi të mbrojmë integritetin e Kosovës, po këto probleme janë shumë të mëdha dhe ne po punojmë në gjetjen e zgjidhjeve", potencoi ajo.

Profesori i Stanford University, Burton Lee, tha se organizimi i konferencave të tilla ndihmon shumë përdoruesit për vetëdijësim të sigurisë dhe privatësisë.

"Është e rëndësishme sepse është sfidë globale dhe shumë serioze. Në kohën e digjitalizimit, është një ndryshim që vjen me të panjohura, nëse e shohim aspektin e sigurisë dhe privatësisë në cilësinë e përdoruesit mendoj se teknologjia zhvillohet shpejt dhe për këtë arsye konferenca të tilla janë shumë të rëndësishme. Nga perspektiva e zhvillimit të teknologjisë", deklaroi ai.

Pjesë e paneleve të diskutimit ishin edhe Mergim Canhani nga Gjirafa, Kujtim Gashi nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, përfaqësues të Flash Strat – Line Tech, Holger Unterbrink, Kastriot Fetahaj, Ibrahim Kistak, Yasser Ali, Lek Zajmi.

Në ditën e dytë të konferencës, rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi theksoi se Kosova i plotëson kushtet që të jetë rol model në botë në trajtimin sigurisë kibernetike dhe privatësisë, pasi siç tha ai, vendi ka kapacitete dhe i ka të rinjtë inteligjentë që punojnë në këtë drejtim.

"Ka hapësirë ende për të bërë, por falë institucioneve dhe akademisë, siguria kibernetike tashmë ka shumë rëndësi për qytetarët, si dhe duhet të jetë gjithnjë e rëndësishme, ngaqë trendi i sulmeve është në rritje. Duhet të krijojmë partneritete me ata që kanë kapa-

citete, në mënyrë që qytetarët të jetojnë në ambient të sigurt. Kosova i ka të rinjtë që do të punojnë në këtë drejtim dhe duhet të krijohet koncepti për një popullatë të sigurt", potencoi rektori Hajrizi.

Tutje, Hajrizi shtoi se kjo konferencë duhet të shërbejë si forum për ekspertët e fushës, njerëzit nga academia, politika, shkenca, ku do të mund të takoheshin dhe të diskutonin lidhur me tema në interes, siç është siguria kibernetike.

Ndërkohë, edicioni i sivjetmë i konferencës është pasuruar me ardhjen e top hakerit me famë botërore, Benjamin Kunz Mejri. Ai tha ndër tjerash tha se digjitalizimi po prek të gjitha vendet, prandaj vlerësoi se është e rëndësishme bashkëpunimi në mes të njerëzve kompetent dhe tha se është e rëndësishme organizimi i konferencave të tilla. "Kosova është në atë pikë ku po lëviz dhe po rritet gjithnjë e më tepër, prandaj është e rëndësishme që të organizohen konferenca të tilla, sepse nëse njerëzit bëhen bashkë atëherë ata do të shpërndajnë eksperiencat e tyre. Jam shumë i lumtur që jam këtu për herë të parë në Kosovë dhe dua të ju them që jam shumë i interesuar që ta ndihmoj këtë vend, për shkak se posaçërisht aspekti i digjitalizimit për ne si hulumtues të sigurisë kibernetike na krijon një sistem të komunitetit", tha Benjamin Mejri.

Duke folur për shqetësimet që kanë qytetarët dhe brengosjen e tyre mbi kontrollin e të dhënave personale, përfaqësuesja e Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave personale në Maqedoni, Bilijana Volceska tha se është në rritje për qindja e njerëzve që po kërkojnë ndihmë profesionale, kjo për shkak të krimeve me profile të rreme në rrjetet sociale.

"Në autoritetet e mbrojtjes së të dhënave, afër 60 për qind e ankesave që pranojnë kanë të bëjnë për mediat sociale dhe rrjete të ndryshme ku njerëzit kërkojnë ndihmë nga ne për shkak të krimeve të profileve të rreme apo lajmeve të tjera, për shkak se dikush ka postuar fotografi apo video të tyre me informacion të ndjeshëm për ta. Ky është një numër në rritje, por ne ju ndihmojmë qytetarëve që ti fshijnë profilet e rreme. Mirëpo, gjetja e personave fajtor merë shumë kohë, por efekti i tyre tek individët është shumë i madh.

Drejtori i Departamentit Ligjor në Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Valon Kryeziu, tregoi se Kosova po punon vazhdimisht në zbatimin e rregullores evropiane për privatësinë e të dhënave.

"GDPR ka hyrë në fuqi vitin e kaluar dhe ka qenë një ndër kriteret për rrugëtimin e Kosovës për integrim evropian, në këtë drejtim është formuar një grup ndër-institucional për harmonizimin dhe nxjerrjen e ligjit konform rregullativave që ka paraparë rregullorja e re e Bashkimit Evropian. Është punuar në atë pjesë dhe kanë hyrë edhe aspekte tjera si mbrojtja e të dhënave personale, etj.", tha ai.

Përfaqësuesi i Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në Kosovë, Shpend Lutfiu, tha se duhet të veprohet më shumë në aspektin e sigurisë kibernetike. Sipas tij, njerëzit po ndihmohen në vetëdijësim e tyre, mirëpo duhet të punohet edhe në çështje teknike të sigurisë dhe privatësisë.

"Kemi qasje në ofrues të shërbimeve të inteligjencës lidhur me kërcënimet, me disa edhe memorandum mirëkuptimi, por unë inkurajoj komunitetin e IT-së të punojnë më shumë në këtë drejtim", tha ai.

Punimet me të gjeturat e tyre në aspektin e sigurisë kibernetike i kanë prezantuar Jean Pierlax, Mohammad Khreesha, Yassine Aboukir, Benjamin Kunz dhe Meridian Miftari.

Edicioni i katërt i Konferencës Ndërkombëtare për Siguri Kibernetike dhe Privatësi, ishte ngjarje që mirëpriti ekspertë dhe folës të shumtë qeveritarë dhe individual, të cilët diskutuan për sfidat dhe ofrimin e zgjidhjeve në fushën e sigurisë kibernetike. Pjesë e kësaj konference ishin mbi 400 pjesëmarrës, ku përgjatë dy ditëve dëgjuan diskutime për Rregulloren e re të BE-së për Sigurinë Kibernetike, GDPR, Shkeljet e Privatësisë, Privatësinë dhe Mediat Sociale, Hakimi etik, etj.

Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi përfaqësoi Kosovën në Asamblenë e Përgjithshme të IPMA-s

Prej korrikut Kosova me standarde të reja të menaxhimit të projekteve



Rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi ka përfaqësuar Kosovën në Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës Ndërkombëtare për Menaxhimin e Projekteve (IPMA), që është mbajtur në Kopenhagë.

Në ceremoninë e IPMA-së, rektori Hajrizi ka shpalosur të arriturat e Kosovës në ngritjen e kapaciteteve njerëzore në menaxhimin e suksesshëm të projekteve në të gjitha fushat e industrive dhe certifikim e tyre.

Më pas, rektori Hajrizi dhe presidenti i IPMA-së, Jesus Martinez Almeida, kanë nënshkruar kontratën e re në emër të organizatës KAM (International Professional Certification), me anë të së cilës aprovohen procedurat për zbatimin e certifikimit të personave në këtë fushë në Kosovë, tashmë sipas standardeve të reja të IPMA ICB4.

Me këtë rast, rektori i UBT-së, njëherësh edhe themelues dhe president i organizatës KAM, prof.dr. Edmond Hajrizi, ka thënë se standardet fokusohen në tri grupe të kompetencave: njerëz, praktika dhe perspektivë, teksa janë vendosura edhe kriteret për Agile Leadership.

“Këto standardeve do të fillojnë aplikimin prej muajit korrik të këtij viti, duke bërë që Kosova të hyjë në mesin e 71 vendeve të botës, si shtet që i plotëson dhe aprovon kriteret ndërkombëtare”, potencoi rektori i UBT-së, njëherësh edhe themelues dhe president i organizatës KAM, prof.dr. Edmond Hajrizi.

Rektori Hajrizi është angazhuar dhe ka krijuar organizatën KAM, përmes së cilës, Kosova në mesin e 71 vendeve të botës ka arritur të hyjë në IPMA, me qëllim të zbatimit dhe të kriterëve të reja ndërkombëtare

Zhvillimi i mëtejshëm i Qendrës së Përbashkët Transformuese Kërkimore

Szvent Istvan University i bashkohet UBT-së dhe BME-së

Aktivitetet dhe të arriturat e UBT-së dhe Budapest University of Technology and Economics (BME), si themelues dhe bashkëpunëtorë në kuadër të Joint Transformative Research Centre (Qendrës së Përbashkët Transformuese Kërkimore), e kanë shtyrë Szvent Istvan University (SZIU), që të bashkohet për të kontribuar në jetësimin e projekteve të reja të përbashkëta kërkimore.

Memorandumi i ri i mirëkuptimit është nënshkruar nga përfaqësuesit e të tri universiteteve, me ç’rast UBT është përfaqësuar nga rektori, prof. dr Edmond Hajrizi, teksa palët janë pajtuar për zhvillimin e mëtejshëm të qendrës, si dhe për realizim të aktiviteteve e projekteve të reja të interesit të

përbashkët.

TRC është themeluar me qëllim të gjenimit të ideve transformuese kërkimore dhe evaluimit e kualifikimit të iniciativave transformuese kërkimore, pastaj për krijimin dhe implementimin e programeve, për mbështetje metodologjike e programeve transformuese kërkimore për institucionet themeluese ose palët tjera, si dhe për pjesëmarrje në kërkimet akademike të institucioneve themeluese ose edhe palëve të treta, etj. Në thelb të arsyes së ekzistimit të TRC-së është garantimi i shpërndarjes së praktikave dhe komunikimit më të mirë përmes komuniteteve transformuese kërkimore, të cilat zhvillojnë programe inovative kërkimore.



Marrëveshje bashkëpunimi me institucione të Gjermanisë

UBT nënshkruan memorandum mirëkuptimi me shkollën profesionale “Design Factory International”



Rektori i UBT-së, prof dr Edmond Hajrizi dhe Jesta Brouns, udhëheqëse e shkollës profesionale, “Design Factory International”, në Hamburg të Gjermanisë, kanë nënshkruar memorandum mirëkuptimi, me qëllim të fillimit të bashkëpunimit ndërinstitucional.

Ky memorandum do të sjellë përfitime të shumta për të dy institucionet, e veçanërisht për studentët, të cilët do të kenë mundësi të përfitojnë nga programet e mobilitetit, që do të ofrohen për studentët e të dy institucioneve.

Palët janë pajtuar që përmes kësaj marrëveshje të fillojnë bashkëpunimin në shkëmbimin e informacioneve që kanë

të bëjnë me aktivitetet e fakulteteve dhe fushave tjera me interes, promovimi i aktiviteteve të përbashkëta, me theks të veçantë tek projektet e financuara ndërkombëtarisht, shkëmbimi i studentëve dhe stafit të të dy institucioneve për një semestër ose edhe periudha më të gjata kohore.

UBT ka nënshkruar më shumë se 300 marrëveshje bashkëpunimi me universitete dhe kolegje të njohura ndërkombëtare, me qëllim që prej tyre të përfitojnë studentët e UBT-së, por edhe te universiteteve partnere.

Marrëveshje bashkëpunimi me institucione të Gjermanisë

Gjiganti teknologjik, EON Reality zgjodhi UBT-në si partner për hapjen e qendrës së vetme në rajon për realitet virtual

Kompania më e madhe botërore për teknologji virtuale, EON Reality ka zgjedhur Kosovën dhe UBT-në, si partner implementues, që të bëjë investimin më të madh direkt në Kosovë që nga paslufta, njëherësh edhe dhe të vetmin në Ballkan, për hapjen e Qendrës për Realitet Virtual dhe të Shtuar.

Kjo qendër do të jetë burim i gjenerimit të produkteve virtuale, që do të ndryshojë rrënjësisht dhe përgjithmonë mënyrën e qasjes ndaj problemeve dhe zgjidhjen e tyre, teksa do të shndërrohet edhe në gjenerues të qindrave vendeve të punës dhe të shpalosjes së pasionit dhe talentit për të rinjtë nga Kosova dhe mbarë rajoni.

Tridhjetë (30) milionë dollarë është shuma që EON Reality do ta ndajë për ndërtimin e kësaj qendre, që do të shndërrohet në një laborator të krijimit dhe të jetësimit të metodave më inovative teknologjike, që do ndryshojnë përgjithmonë zgjidhjen e problemeve industriale, por veçanërisht do të fokusohet në ndryshimin e sistemit arsimor në Kosovë dhe më gjerë.

Përmes Qendrës për Realitet Virtual dhe të Shtuar, në sistemin arsimor të Kosovës do të instalohet sistemi arsimor i së ardhmes, ku gjeneratat e reja shumë shpejt do të fillojnë që të mësojnë duke praktikuar (Learning by Doing).

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi tha se investimi për hapjen e një qendre të tillë e dërgon Kosovën në një nivel tjetër të shfrytëzimit të teknologjisë dhe e vendos përkrahë shteteve më të zhvilluara të botës.

“Ky investim madhor në shtetin tonë do të mundësojë krijimin e një platforme për të rinjtë tanë, e cila deri dje ishin ëndrra jonë më e madhe, kurse tani gjeneratat e reja do të mësojnë me teknologjitë më të reja botërore, që ndikon në krijimin e kompetencave më të qëndrueshme dhe që do t’i përvetësojnë shumë më shpejt”, theksoi Hajrizi.

Ai e falënderoi EON Reality që ka besuar se UBT do ta jetësojë këtë qendër dhe do t’i dalë në ndihmë shoqërisë, teksa shprehu konsideratë edhe ndaj kësaj të fundit, për faktin se i ka mirëpritur me shumë lehtësi ndryshimet e tilla kaq rrënjësore teknologjike.

Presidenti i EON Reality, Dan Lejerskar, duke e shprehur interesimin e madh për të jetësuar këtë qendër, tregoi për të pranishmit të arriturat më të mëdha, bashkëpunëtorët dhe implementuesit e teknologjisë së realitetit virtual, si dhe të ardhmen që do ta sjellë realiteti virtual.

Ai tha se kompanitë më të mëdha botërore po e shfrytëzojnë realitetin vir-

tual për të krijuar produktet e tyre, për t’i minimizuar kostot dhe për t’i rritur fitimet. Sipas tij, një sistem i tillë do të instalohet përmes kësaj qendre edhe në Kosovë, dhe përmes Kosovës e UBT-së, edhe në vendet e tjera të rajonit.

“Do ta ndërtojmë këtë qendër për të zhvilluar dhe instaluar një mentalitet dhe sistem të ri të të mësuarit dhe punuarit në Kosovë. Zhvillimi i teknologjisë e ka ulur nevojën për forcë punëtore, por njëkohësisht është shtuar nevoja për njerëz që kanë shkathtësi teknologjike dhe që kanë njohuri në përshtatjen e inteligjencës artificiale me nevojat e njerëzve në kohët e sotme”, konstatoi Lejerskar.

Që prej vitit 2001, UBT ka qenë nismëtar për sjelljen e inovacioneve të fundit teknologjike në Kosovë. Me të gjitha arritjet e deritanishme, është zgjeruar rrjeti i bashkëpunëtorëve vendorë e ndërkombëtarë, të cilët falë UBT-së, Kosovën nuk e konsiderojnë më vetëm si shfrytëzues të vlerave dhe njohurive të të tjerëve, por edhe si shtet partner të barabartë në dhënien e kontributit për ngritjen e vlerave shkencore në botë.



Rektori Hajrizi merr pjesë në Konferencën Ndërkombëtare për Studimet Profesionale dhe Tregun e Punës

Në cilësinë e ekspertit të arsimit të lartë, rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi ka marrë pjesë në Konferencën e Dytë Ndërkombëtare “Studimet Profesionale dhe Tregu i Punës”, organizuar nga Fakulteti i Studimeve Profesionale, në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, në Durrës.

Në këtë konferencë, rektori Hajrizi ka prezantuar temën: “UBT Holistic Approach for Professional Education”, i cili ka folur për arsimin profesional në Kosovë, rolin e UBT-së dhe kontributin e dhënë si institucion në shkencë, për studime cilësore dhe për sistemin e studentëve në tregun e punës.

Rektori Hajrizi potencoi se stu-

dentët e UBT-së qasen lehtësisht në tregun vendor e ndërkombëtar të punës, ku sipas tij, mbi 98 për qind e tyre punësohen nëpër institucione publike e private qysh në vitin e parë të studimeve.

Tutje, ai ka folur edhe për partneritetin që UBT ka me mbi 300 universitete botërore, i cili theksoi se partneriteti rajonal dhe ndërkombëtar është i rëndësishëm për institucionet e arsimit të lartë.

Hajrizi tha se UBT dhe Universiteti “Aleksandër Moisiu”, do të vazhdojnë bashkëpunimin dhe të zhvillojnë projekte të përbashkëta ndërkombëtare, me qëllimin të shkëmbimit të përvojave dhe ofrimit të edukimit cilësor.



UBT përfaqëson Kosovën në konferencën për teknologji në Itali



Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi ka përfaqësuar Kosovën në ngjarjen më të madhe globale të teknologjisë dhe inovacionit, që është mbajtur në Bolonja të Italisë.

Rektori Hajrizi është ftuar si ekspert në këtë aktivitet për të diskutuar sfidat globale në këtë fushë, për zhvillimet teknologjike dhe zgjidhjet kreative në ofrimin e shërbimeve.

Më pas, Hajrizi ka takuar ekspertë të shumtë të teknologjisë nga e mbarë bota, me të cilët ka folur për mundësitë e sjelljes së investimeve të huaja në Kosovë. Ata kanë shprehur interesimin të kenë bashkëpunim ndërinstitucional me UBT-në, pasi siç thanë, është qendra më e madhe në Ballkan në fushën e teknologjisë dhe sistemeve të informacionit.

Gjatë vizitës dy ditore në Itali, ai është takuar edhe me zv.rektorin e Universitetit të Bolonjës, përfaqësuesit e kompanisë IBM dhe Toyota, përfaqësues të universiteteve nga Singapori, Taivani, Maroko, përfaqësues të UNIDOS, etj.

Sipas raportit të Agjencisë Statistike të Kosovës

UBT - punëdhënësi më i madh në arsimin e lartë privat

UBT vazhdon të jetë qendër e arsimit të lartë në Kosovë, i cili përveç që ofron programe unike studimi me cilësi të lartë, është institucioni i vetëm privat që ka rol aktiv në shërbim të shoqërisë ku përkrahë zvogëlimin e papunësisë në vend.

Përveç që kontribuon në zgjerimin e njohurive dhe edukimin e gjeneratave, UBT çdo vit punëson staf të ri akademik dhe administrativ. Së fundmi, sipas statistikave të Agjencisë Statistike të Kosovës, UBT del të jetë institucioni i parë i arsimit të lartë privat në vend për nga numri i stafit.

Aktualisht, në UBT punojnë dhe veprojnë rreth 750 staf akademik dhe administrativ. Ky numër është dyfishuar nga viti 2016, ku ka tejkaluar dukshëm institucionet tjera private të arsimit të lartë në Kosovë.

Në bazë të raportit të ASK-së, stafi i rregullt profesional në UBT, përbëhet nga 435 meshkuj dhe 138 femra, ndërkaq të angazhuar janë 77 meshkuj dhe 24 femra. Teksa, sipas këtij raporti, stafi administrativ në UBT, përbëhet nga 30 femra dhe 17 meshkuj.

Stafi i angazhuar në UBT, ka grada të larta shkollimi dhe janë të përgatitur për të ndarë përvojat dhe ekspertizat e tyre profesionale me studentët e të gjitha fakulteteve në UBT.

Vlen të theksohet se numri i stafit që angazhohet në UBT, vazhdon të rritet nga viti në vit, sikurse edhe numri i studentëve që regjistrohen çdo vit të ri akademik.

2017/2018						
AAB	197	241	80	94	22	-
AUK	9	10	8	6	23	26
Biznesi	:	:	:	:	:	:
Design Factori	:	:	:	:	:	:
Fama	21	89	1	80	10	-
Europian i Kosovës	:	:	:	:	:	:
Dukagjini	17	29	-	26	30	5
Gjilani	1	5	2	7	5	7
Humanistika	:	:	:	:	:	:
IBCM	3	7	1	2	10	7
Internacional	:	:	:	:	:	:
ISPE	8	13	2	35	13	10
Juridika	3	12	4	9	5	2
Pjeter Budi	5	6	2	9	6	7
QEAP Heimerer	57	41	21	29	14	8
Rezonanca	32	63	40	38	14	5
Rinvest	9	16	5	29	4	4
Tempulli	4	20	5	32	3	1
UBT	138	435	24	77	30	17
Universi	:	:	:	:	:	:
Akademia Evolucion	16	27	2	7	8	6
Dardania	17	41	15	32	9	7
ESLG	:	:	:	:	:	:
Iliria	:	:	:	:	:	:

Sipas raportit vjetor të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

UBT, institucioni privat me numrin më të madh të stafit akademik në Kosovë

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë, ka publikuar raportin vjetor të vlerësimit për vitin 2018, ku në bazë të këtij del që UBT është institucioni i parë i arsimit të lartë privat në Kosovë, me numrin më të madh të stafit akademik në proporcion me studentët. Në bazë të këtij raporti, UBT gjatë vitit 2018 ka angazhuar 437 profesorë, që i bie mesatarisht numri i studentëve për një profesor është 19 studentë.

Kjo praktikë e punës i ka bërë të veçanta studimet në UBT, pasi që studentëve po u ofrohet mundësia për arsim të individualizuar ose mësim i kombinuar në një mjedis interaktiv dhe inovativ.

Në UBT janë të angazhuar staf profesional që vijnë nga të gjitha trojet shqiptare, të cilët janë shkolluar nëpër universitetet më me reno-

botërore, numër që nga viti në vit vazhdon të rritet.

Në këtë mënyrë, UBT po ndjek edhe trendet bashkëkohore të arsimit të lartë dhe po sjell në Kosovë politika për arsim profesional, cilësor dhe të integruar me teknologjinë.

UBT, para 18 viteve, për herë të parë në Kosovë ka sjellë edhe programe unike të studimit bachelor e master, mbi 90 specializime, inkubatorë dhe qendra të ekselencës, e mbi 80 laboratorë shkencorë. Sot, UBT është lider në cilësinë arsimore dhe në inovacion, arsye për të cilat në UBT janë të regjistruar mbi 20 mijë studentë.



Proporcioni staf akademik-student në IAL 2017/2018				
No	Institucioni	Stafi	Student	Proporcio
1	Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"	896	40383	45
2	Kolegji UBT	437	8089	19
3	Kolegji AAB	385	14739	38
4	Kolegji i Shkencave Mjekësore Rezonanca	184	1700	9
5	Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"	166	2497	15
6	Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka"	161	8473	53
7	Kolegji Biznesi	117	m	m
8	Kolegji FAMA	116	3115	27
	Kolegji Heimerer	110	1510	14

Weller: Pavarësia e Kosovës nuk është e negociueshme

Në ligjëratën e tij para stafit akademik, studentëve të UBT-së dhe përfaqësuesve institucionalë, profesori Weller tha se statusi i Kosovës, përkatësisht pavarësia e saj nuk negociohet por se në procesin e normalizimit po diskutohet për ndërtimin e një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht obliguese që definojnë marrëdhëniet e ardhshme shtetërore Kosovë-Serbi

Profesori nga Universiteti i Kembrixhit, njëherësh Ekspert i Lartë për Ndërmjetësim i Kombeve të Bashkuara, Marc Weller, ka vizituar UBT-në, me ç'rast është pritur nga rektori prof.dr. Edmond Hajrizi, të cilët bashkërisht kanë diskutuar për aspektin juridik të çështjeve ose temave të rëndësishme shtetërore.

Me këtë rast, rektori Hajrizi theksoi se është qëllimi i UBT-së që të krijoj hapësirë për diskutim dhe mbledh ekspertë për të prezantuar analiza lidhur me proceset e së ardhmes Euro-Atlantike të Republikës së Kosovës.

Tutje, para shumë studentëve të UBT-së, profesorëve dhe mysafirëve nga institucionet shtetërore, profesori ndërkombëtar Weller mbajti një ligjëratë, nën rregullat e Chattam House, në kuadër të debatit me temën: "Dialogu Kosovë-Serbi: Sfidat dhe Rruga Përpa-

ra."

Weller potencoi se është e rëndësishme që të ketë një diskutim të mirëfilltë në shoqëri për procesin e normalizimit të marrëdhënies midis Kosovës dhe Serbisë, duke kërkuar që akademia të jetë më aktive dhe të ofroj kontributin e sajë.

Në ligjëratën e tij para stafit akademik, studentëve të UBT-së dhe përfaqësuesve institucional, profesori Weller sqaroi rëndësinë e kontekstit historik të trajtimit të Kosovës nga shtetet Evropiane. Ai tha se statusi i Kosovës, përkatësisht pavarësia e saj nuk negociohet por se në procesin e normalizimit po diskutohet për ndërtimin e një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht obliguese që definojnë marrëdhëniet e ardhshme shtetërore Kosovë-Serbi.



Eksperti i njohur ndërkombëtarisht vizitoi për herë të parë Kosovën

Noriaki Kano zgjodhi UBT-në për të shpjeguar Modelin Kano



Ligjëruesi dhe një ndër konsulentët më të njohur në botë në fushën e menaxhimit cilësor, Noriaki Kano, ka vizituar për herë të parë Kosovën, me ç'rast ka qëndruar në UBT, ku ka mbajtur ligjëratë për stafin dhe studentët e UBT-së.

Modeli i njohur i tij "Kano Model" ishte temë kryesore e ligjëratës së tij, si një praktikë unike e menaxhimit të cilësisë e njohur në mbarë botën për menaxhimin e kënaqshmërisë së klientëve.

Duke treguar mbi mënyrën e aplikimit të këtij modeli në të gjitha sferat e të menaxhimit, përfshirë këtu edhe menaxhimin e universiteteve, Kano sqaroi se skema e thjeshtë e rangimit të kënaqshmërisë sipas Modelit Kano bën diferencën midistributeve thelbësore dhe dalluese që lidhen me konceptet e cilësisë së klientit.

Përmes modelit të tij, profesori Kano sfidoi besimet konvencionale se përmirësimi i çdo atributi të produktit të një kompanie mund të çojë në rritjen e kënaqësisë së klientit. Ai beson se jo çdo atribut i performancës mund të rris nivelin e kënaqshmërisë së klientëve, duke e pasur në fokus nivelin e besnikërisë së tyre. Për rektorin e UBT-së, prof dr Edmond Hajrizi, prania në UBT e një eksperti të njohur në mbarë botën, është e arritur e madhe dhe një përvojë unike që do të mbetet e shkruar në historinë e UBT-së dhe të vendit.

Në shenjë mirënjohjeje për vlerësimin e tij ndaj UBT-së, rektori Hajrizi i dhuroi profesorit Noriaki Kano një dhuratë simbolike me elemente shtetërore të Kosovës.

Artisti i njohur nga Gjermania

Nir Alon ligjëron dhe realizon vepër artistike në UBT

Instalacione me materiale që janë nxjerrë nga përdorimi dhe ligjërata tematike e mbajtur nga artisti i njohur gjerman, Nir Alon, mbledhën në UBT dhjetëra studentë të Fakultetit të Dizajnit të Integruar, të cilët shfaqën interesim të jashtëzakonshëm për mënyrën e punës dhe veçoritë e veprave të këtij artisti, i cili sqaroi tërë punën e tij shumëvjeçare si artist.

Ai prezantoi para studentëve disa nga veprat e tij artistike më të njohura, teksa shpjegoi edhe materialet që përdorë, mesazhet që fshihen pas veprave të tij, si dhe inspirimin që buron nga përditshmëria.

"Gjithmonë kam dashur që në veprat e mia të bëj diçka që është e vështirë të realizohet. Kjo ishte një zgjedhje e

imja, e detyruar nga gjërat që nuk më kanë pëlqyer", tha Alon.

Ai i këshilloi studentët që të mendojnë më shumë për veten, se kush duan të bëhen, çfarë duan të arrijnë, çfarë duan të lënë pas vetes dhe si dëshirojnë që të mbahen mend nga të tjerët. Sipas tij, vetëm në këtë formë, ata do të bëhen të veçantë.

Alon ka krijuar disa vepra artistike në UBT, për të cilat ka shfrytëzuar materiale që nuk përdoren më.

Nir Alon në të shumtën e rasteve zhvillon skulpturat e tij nga artikujt e jetës së përditshme, si dyshemetë, dollapët, llambat, kabllot, dhe rrjedhimisht edhe instalacionet janë të vendosura drejtpërdrejt në vendin e ekspozitës.



Në UBT i zhvilloi punimet konferenca “Free Market Road Show”

Diskutohen ngecjet dhe të arriturat e shteteve në 30 vitet e fundit

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, duke theksuar rëndësinë e madhe të lirisë, tha se as UBT, si nikoqir i kësaj konference botërore në Kosovë, nuk do të themelohej asnjëherë nëse nuk do të ekzistonte mundësia e lëvizjes së lirë dhe e shkëmbimit të praktikave të mira ndërshtetërore

Konferenca e përvitshme “Free Market Road Show”, ka mbledhur në UBT dhjetëra politikanë, profesorë dhe ekspertë vendorë e ndërkombëtarë të fushës së ekonomisë dhe tregtisë, të cilët trajtuan çështjen e lirisë së tregut dhe të shteteve 30 vite pas rënies së Murit të Berlinit, sfidat me të cilat po përballen shtetet në ndërtimin e lirisë së tregut, si dhe hapat që duhet të ndërmarrë Kosova për të ndërtuar lirinë.

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, duke theksuar rëndësinë e madhe të lirisë, tha se as UBT, si nikoqir i kësaj konference botërore në Kosovë, nuk do të themelohej asnjëherë nëse nuk do të ekzistonte mundësia e lëvizjes së lirë dhe e shkëmbimit të praktikave të mira ndërshtetërore.

“Të gjitha të arriturat e UBT-së kanë ardhur vetëm sepse kemi liri, kemi të drejtë për të vepruar dhe për të krijuar institucione ndërmarrësie, si dhe bashkëpunime që kanë mundësuar shkëmbim të dijeve përtej kufijve shtetërorë, përndryshe do të mbeteshim të izoluar dhe të pazhvilluar”, vlerësoi Hajrizi.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri tregoi hapat që kanë ndërmarrë ministria të cilën ai e udhëheqë për të larguar barrierat ligjore për zhvillim të tregtisë së lirë, por edhe sfidat më të cilat Kosova është përballur dhe po vazhdon të përballlet në tejkalimin e fazës së tranzicionit.

“Kapacitetet e pamjaftueshme, mungesa e zbatimit të ligjit dhe paqartësitë e rrymave të mendimit, si pasojë e prezencës së shumë shkollave të mendimit, që nga periudha e UNMIK-ut, EULEX-it dhe brenda vetë institucioneve tona, i kanë kontribuar zgjatjes së tranzicionit”, theksoi ministri Tahiri.

Ai deklaroi se Ministria e Drejtësisë ka filluar implementimin e agjendës “Drejtësia 2020”, përmes të cilës synohet që t’i jepet fund tranzicionit në sistemin e drejtësisë, e me këtë, sipas tij, edhe të rritet niveli i besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

Më temën “Liria në botë 30 vite pas rënies së murit”, anëtari i Qendrës Austriake për Ekonomi, Federico Fernandez trajtoi rastin e Venezuelës, si një shtet që ka dështuar në bërjen e politikave tregtare, kurse ekspertët, John Chisholm dhe Thomas Bachheimer, të cilët treguan hapat konkretë që duhet ndërmarrë për ta bërë Kosovën një vend më të mirë dhe më të lirë për të gjithë, por edhe lindjen dhe ndryshimet që ka pësuar sundimi i ligjit ndër vite dhe në situata të ndryshme me të cilat është përballur bota.

Në sesionin përmbyllës të kësaj konference, njohësit e çështjeve ekonomike,



Armend Muja, Adri Nurellari dhe Bardhyl Salihu, në fjalimet e tyre kanë trajtuar çështjet e përparimit dhe ngecjeve të shteteve, të shkaktuara nga tregtia e lirë, si dhe pasojat me të cilat është përballur Kosova nga vendimet e fundit ekonomike, pastaj edhe reformat që duhet bërë, përfshirë forcimin e sundimit të ligjit, luftimin e krimit dhe korrupsionit, mbrojtjen e pronës private, reformimi i sistemit tatimor dhe zbatimi i marrëveshjeve mes kompanive dhe individëve. Free Market Road Show filloi në vitin 2008 dhe çdo vit mbledh ekonomistë të njohur, politikanë udhëheqës të shquar të biznesit, të cilët bëhen bashkë për të diskutuar probleme aktuale ekonomike dhe për të ofruar zgjidhje të mundshme në një sërë vendesh në Evropë dhe në Kaukaz.

Në edicionin e pestë të konferencës “BUA 2019”, që u mbajt në Selanik të Greqisë

UBT në mesin e 60 universiteteve nënshkruese të statutit të BUA-s për regjistrim në organet e BE-së



UBT ka qenë i vetmi institucion i arsimit të lartë privat nga Kosova që ka përfaqësuar vendin dhe ka marrë pjesë në nënshkrimin e statutit për regjistrimin e Asociacionit të Universiteteve Ballkanike në Bashkimin Evropian, si organizatë e institucioneve të arsimit të lartë.

Pjesë e këtij nënshkrimi ishin rektorë të 60 universiteteve nga Ballkani, që ishin edhe pjesëmarrës në edicionin e pestë të konferencës “BUA 2019”, që u mbajt në Selanik të Greqisë

Për të realizuar këtë, u propozuan edhe ndryshimet në statutin e organizatës, në mënyrë që të mundësohej ky proces dhe të rritej efikasiteti

i saj. Në tërë diskutimin e ekspertëve, rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi dha kontribut përmbajtësor në ndryshimet statutoare.

Në përmbyllje të diskutimit, rektorët prezentë të Asociacionit të Universiteteve të Ballkanit nënshkruan Statutin e ri të Asociacionit, i cili u dërgua në Organet e Bashkimin Evropian për regjistrim.

UBT është anëtar me të drejta të plota në Asociacionin e Universiteteve Ballkanike, që po shërben si një platformë për rrjetëzim ndërinstitucional dhe fuqizim të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Konferenca Ndërkombëtare e Universiteteve Evropiane në Poloni

UBT përfaqësoi Kosovën në Konferencën ndërkombëtare për projektet e mobiliteteve të Erasmus

Në vazhdim të pjesëmarrjes në aktivitetet më të rëndësishme ndërkombëtare për zhvillimin e universiteteve, UBT është ftuar të marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare të Universiteteve Evropiane, në Poloni, për krijimin e marrëveshjeve, me qëllim të realizimit të projekteve të mobilitetit ndërmjet universiteteve në kuadër të projektit Erasmus.

Në këtë konferencë, Kosova dhe UBT janë përfaqësuar nga prodekani i Inxhinierisë së Ndërtimit, prof. dr. Visar Krelani.

Konferenca u organizua nga zyra e Erasmus në shtetin e Polonisë dhe nga Ministria e Edukimit e këtij shteti.

Në kuadër të konferencës është prezantuar secili shtet pjesëmarrës, ku me statistika kanë definuar numrin e studentëve në këto shtete, numrin e universiteteve, profesorëve, diplomave të dyfishta, numrin e marrëveshjeve

ndërkombëtare, etj. Rëndësi të veçantë i është dhënë mënyrës së komunikimit të universiteteve, duke konsideruar kontaktet ndërmjet profesorëve, fakulteteve dhe universiteteve, për sukses të përbashkët në realizimin e projekteve të përbashkëta evropiane. Tutje, u diskutuan edhe tema të tjera të rëndësishme përfshirë njohjen akademike ndërmjet universiteteve në rastet e mobilitetit dhe dokumentet që duhet nënshkruar me rastin e mobilitetit nga ana e universitetit dërgues dhe universitetit mikpritës, teksa janë shpjeguar edhe aspektet kryesore që duhet marrë parasysh me rastin e mobiliteteve.

Për të aplikuar informatat e marra u krijuan edhe grupe punuese në të cilat u diskutuan problematikat e përmendura dhe u bë prezantimi i përvojave të universiteteve të ndryshme në këto aspekte.

Në këto grupe punuese prof. Visar Krelani ishte edhe

raportues i grupit, i cili shpjegoi përvojat e UBT-së dhe të grupit për çështjet e diskutuara në grupin përkatës.

Përpos paraqitjes së rëndësisë që ka bashkëpunimi ndëruniversitar, edhe përfaqësuesit e universiteteve nga shtetet e ndryshme shprehën interesimin e tyre që të rrisin bashkëpunimin me Kosovën dhe në veçanti me UBT-në, si mundësi edhe për fitim të projekteve Erasmus-it.



Një delegacion nga Akademia e Edukimit dhe Trajnimit "Auxila" në vizitë në UBT

Gjermanët të interesuar për studentët e UBT-së

Një delegacion nga Akademia e Edukimit dhe Trajnimit "Auxila", në Gjermani, i përbërë nga Jürgen Debus dhe Ute Schaufler, ka qëndruar në UBT, ku janë takuar me përfaqësuesit e Fakulteteve të Mjekësisë në UBT, me qëllim të krijimit të mundësisë për t'i punësuar studentët në institucionet shëndetësore gjermane.

Ata janë mahnitur me njohuritë e studentëve në aspektin praktik dhe teorik dhe theksuan se UBT është i vetmi institucion në Kosovë i cili përgatit profesionalisht të rinjtë në fushën e infermierisë, stomatolog-

jisë, farmacisë etj.

Tutje, ata theksuan se këta të rinj janë kompetentë për të ofruar shërbime si profesionistë në kujdesin shëndetësor, pasi siç thanë, studentët e UBT-së tashmë kanë zhvilluar praktikën profesionale dhe janë të gatshëm për tregun e punës.

UBT ka të ndërtuar qendrën e inovacionit për mjekësi me infrastrukturë dhe mbi 100 laboratorë shkencor për të gjitha fushat e shëndetësisë: Infermieri, Stomatologji, Mjekësi e Përgjithshme, Farmaci, Interno, Pediatri etj.



Ekspertë nga agjencia "Artigum" në UBT

Studentët e Infermierisë në UBT, caku i parë për punësim i organizatës nga Gjermania



Niveli i lartë i përgatitjes së studentëve të Infermierisë në UBT, ka tërhequr vëmendjen dhe interesimin e agjencisë së njohur gjermane të punësimit, "ARTIGUM", që pret të punësojë dhe së shpejti të marrë në praktikë profesionale studentët e Infermierisë, të cilët do të punojnë nëpër klinikat dhe spitalet e Gjermanisë.

Në takimin që pati me rektorin e UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi dhe me dekanin e Fakultetit të Infermierisë, dr. Fitim Alidema, drejtori i ARTIGUM, Cristian Parashiv, tha se bashkëpunimi me UBT-në do të jetë i pari në shtetin e Kosovës dhe prej tij shumë shpejt do të përfitojnë një numër i madh i studentëve të Infermierisë në UBT.

Rektori Hajrizi dhe dekanı Alidema e njoftuan drejtorin e ARTIGUM me përgatitjen e lartë profesionale të studentëve të UBT-së, si dhe me hapësirën e laboratorët e pajisur me të gjitha elementet e nevojshme për përgatitjen e infermierëve të rinj.

Përpos nënshkrimit të disa marrëveshjeve të njëpasnjëshme, përmes të cilave studentët e Infermierisë do të kenë mundësi të punësohen e të përfundojnë praktikën profesionale në Gjermani, UBT po ofron edhe kurse profesionale të gjuhës gjermane, në mënyrë që studentët të jenë plotësisht të përgatitur për tregun gjerman të punës.

Fushatë sensibilizuese në Javën Evropiane kundër Kancerit të Qafës së Mitrës

Çdo vit, rreth 60 gra preken nga kanceri i mitrës në Kosovë

Me qëllim të ndërgjegjësimit për parandalimin ose identifikimin e hershëm të kancerit të qafës së mitrës, Fakulteti i Infermierisë dhe Grupi i Ekspertëve të Shëndetësisë në UBT, kanë organizuar fushatë sensibilizuese dhe kanë mbajtur tryezë diskutimi për të shënuar Javën Evropiane kundër Kancerit të Qafës së Mitrës. Me këtë rast, pjesëmarrësit janë njoftuar profesionalisht lidhur me shkaktarët e sëmundjes, simptomat dhe masat parandaluese.

Dafina Gexha nga Grupi i Ekspertëve të Shëndetësisë në UBT, ka theksuar se çdo vit në Kosovë diagnostifikohen 60 gra me kancer të qafës së mitrës, por sipas saj, është sëmundje që mund të parandalohet.

Tutje, ajo bëri të ditur se faktorët kryesorë të kësaj sëmundje është pirja e duhanit, numri i madh i shtatzënive, infeksioni i HIV-it etj.

"Në disa statistika botërore rreth 18 milionë njerëz në botë sëmurën nga kanceri. Kanceret që i atakojnë më shumë gratë është kanceri i gjirit. Por, në Kosovë çdo vit diagnostifikohen rreth 60 gra me kancer të qafës së mitrës. Në botë çdo ditë, 2 gra humbin jetën për shkak të kancerit të qafës së mitrës. Kanceri i gjirit zbulohet pak më herët ndërsa tek kanceri i qafës së mitrës ka tendencë të neglizhohet prej grave", potencoi Gexha.

Ndërkaq, Merita Kasumi nga Grupi i Ekspertëve të Shëndetësisë në UBT, tha se është e nevojshme që gratë të aplikojnë më shumë Pap Testin, me qëllim të zbulimit të hershëm të këtij lloji të kancerit apo edhe sëmundjeve tjera.

"PAP testi është një metodë që kërkon të shkojë tek gjinekologu dhe duhet merren disa qeliza në qafën e mitrës të cilat dërgohen në institutin e patologjisë dhe bëhet analiza e tyre. Në qoftë se kemi shenja që kanë fil-

luar ndryshimet e qelizave, gjinekologu e përcakton se në sa kohë duhet bëhet PAP testi. Ky test tani mund të realizohet edhe në qendra familjare", theksoi ajo.

Ligjëruesja në UBT, Violeta Zefi, deklaroi se ndër faktorët e rrezikut që gratë preken nga kanceri në mitër është edhe infeksioni HIV.

Sipas saj, në Kosovë ka raste të shumta që janë të prekur me sëmundjen në fjalë apo me infeksionin HIVAids.

"Kosova ka 119 raste me HIV Aids. Ka shumë faktorë që ndikojnë në rritjen e virusit HIV tek meshkujt dhe femrat. Moshat më të prekura me këtë lloj infeksioni i atakojnë moshës 15 deri në 24 vjeç pasi kjo moshë ka një jetë më aktive seksuale", tregoi ajo.

Gjatë këtij diskutimi u tha se zbulimi i hershëm i kancerit të qafës së mitrës është thelbësor për rritjen e shanseve të shërimit dhe se parandalimi është analiza citologjike ku redukton vdekshmërinë nga sëmundja.



Gara "Data Science Hackathon"

Qindra të rinj nga Kosova po marrin pjesë në garën "Data Science Hackathon"

Qindra të rinj entuziast dhe të talentuar në fushën e teknologjisë, po marrin pjesë në garën më të madhe në vend "Data Science Hackathon", ku është organizuar si rezultat i bashkëpunimit mes akademisë dhe industrisë, konkretisht nga UBT dhe Raiffeisen Bank.

Të bashkuar në grupe prej 2 deri në 5 kandidatë, të frymëzuar dhe me ide inovative, ata bashkërisht po punojnë për të ofruar zgjidhje kreative për problemet me të dhëna dhe punën me big data.

Në hapjen e kësaj gare, rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi tha se institucioni gjithnjë do të përkrahë ngjarje të tilla në të cilat prezantohen koncepte të rëndësishme, siç është mësimi eksperimental.

Ai tha se falë këtyre aktiviteteve të rinjtë motivohen, gjenerojnë dhe shfaqin talentin e tyre.

"Kjo është një garë e cila po organizohet për herë të parë në Kosovë, që për fokus ka identifikim e talentëve të rinj ose inovatorët e së ardhmes. UBT ka edhe shkollën më të madhe të IT-së në Ballkan, andaj, sigurisht që do të jemi në hap me prurjet e reja teknologjike, e do të punojmë bashkërisht me të rinjtë, me partnerët tanë që të zhvillojmë temat që vërtet janë me rëndësi, si Data Science", potencoi rektori Hajrizi.

Ndërkaq, anëtari i Bordit Menaxhues në Raiffeisen Bank, Shukri Mustafa, tha se fokusi i garës është përfshirja e studentëve në gjetjen e mënyrave se si të digjitalizohen bankat tradicionale.

Sipas tij, bankat tanimë duhet të ofrojnë shërbime të standardizuara dhe duhet të jenë të dizajnuara në mënyrë digjitale. "Organizimi i garës në fjalë ka të bëjë me grumbullimin e të dhënave, pasi është një pasuri e madhe kur ke të dhëna të shumta të klientëve. Përveç shfrytëzimit të të dhënave, duhet të bëhet edhe analizimi i pjesës së rrezikshmërisë që u kanoset klientëve dhe sigurisht duhet të nxjerrën analiza të tilla nga kjo garë, analiza që dëshirojmë ti shfrytëzojmë në punën e bankës tonë", theksoi ai.


Garuesit i vizitoi shefja departamentit të riskut në bankën Raiffeisen, Anita Kovacic, si dhe kryetari i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija.

Data Science Hackathon do të zhvillojë punimet edhe nesër më 24 mars, ndërkaq në bazë të rezultateve të treguara, juria profesionale do të shpallë edhe tri grupet më të suksesshme. Vendi i parë do të shpërblehet me 1 mijë e 500 euro, vendi i dytë me 1 mijë euro dhe vendi i tretë me 500 euro. Gjithashtu do të ndahen edhe shpërblime të tjera, si pajisje të shumta teknologjike.



Pas një sulmi të simuluar

Ueb-faqja e UBT-së suksesshëm përballon testimin e hakerëve për shkyçje nga sistemi



për të ofruar zgjidhje kreative për problemet me të dhëna dhe punën me big data.

Në hapjen e kësaj gare, rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi tha se institucioni gjithnjë do të përkrahë ngjarje të tilla në të cilat prezantohen koncepte të rëndësishme, siç është mësimi eksperimental.

Ai tha se falë këtyre aktiviteteve të rinjtë motivohen, gjenerojnë dhe shfaqin talentin e tyre.

"Kjo është një garë e cila po organizohet për herë të parë në Kosovë, që për fokus ka identifikim e talentëve të rinj ose inovatorët e së ardhmes. UBT ka edhe shkollën më të madhe të IT-së në Ballkan, andaj, sigurisht që do të jemi në hap me prurjet e reja teknologjike, e do të punojmë bashkërisht me të rinjtë, me partnerët tanë që të zhvillojmë temat që vërtet janë me rëndësi, si Data Science", potencoi rektori Hajrizi.

Ndërkaq, anëtari i Bordit Menaxhues në Raiffeisen Bank, Shukri Mustafa, tha se fokusi i garës është përfshirja e studentëve në gjetjen e mënyrave se si të digjitalizohen bankat tradicionale.

Sipas tij, bankat tanimë duhet të ofrojnë shërbime të standardizuara dhe duhet të jenë të dizajnuara në mënyrë digjitale. "Organizimi i garës në fjalë ka të bëjë me grumbullimin e të dhënave, pasi është një pasuri e madhe kur ke të dhëna të shumta të klientëve. Përveç shfrytëzimit të të dhënave, duhet të bëhet edhe analizimi i pjesës së rrezikshmërisë që u kanoset klientëve dhe sigurisht duhet të nxjerrën analiza të tilla nga kjo garë, analiza që dëshirojmë ti shfrytëzojmë në punën e bankës tonë", theksoi ai.

Garuesit i vizitoi shefja departamentit të riskut në bankën Raiffeisen, Anita Kovacic, si dhe kryetari i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija.

Data Science Hackathon do të zhvillojë punimet edhe nesër më 24 mars, ndërkaq në bazë të rezultateve të treguara, juria profesionale do të shpallë edhe tri grupet më të suksesshme. Vendi i parë do të shpërblehet me 1 mijë e 500 euro, vendi i dytë me 1 mijë euro dhe vendi i tretë me 500 euro. Gjithashtu do të ndahen edhe shpërblime të tjera, si pajisje të shumta teknologjike.

Gjithashtu do të ndahen edhe shpërblime të tjera, si pajisje të shumta teknologjike.

Në Ditën e Vajzave në ICT

UBT trajnon rreth 200 të reja të Kosovës për siguri kibernetike

Qindra të rinj entuziast dhe të talentuar në fushën e teknologjisë, po marrin pjesë në garën më të madhe në vend "Data Science Hackathon", ku është organizuar si rezultat i bashkëpunimit mes akademisë dhe industrisë, konkretisht nga UBT dhe Raiffeisen Bank.

Të bashkuar në grupe prej 2 deri në 5 kandidatë, të frymëzuar dhe me ide inovative, ata bashkërisht po punojnë për të ofruar zgjidhje kreative për problemet me të dhëna dhe punën me big data.

Në hapjen e kësaj gare, rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi tha se institucioni gjithnjë do të përkrahë ngjarje të tilla në të cilat prezantohen koncepte të rëndësishme, siç është mësimi eksperimental.

Ai tha se falë këtyre aktiviteteve të rinjtë motivohen, gjenerojnë dhe shfaqin talentin e tyre.

"Kjo është një garë e cila po organizohet për herë të parë në Kosovë, që për fokus ka identifikim e talentëve të rinj ose inovatorët e së ardhmes. UBT ka edhe shkollën më të madhe të IT-së në Ballkan, andaj, sigurisht që do të jemi në hap me prurjet e reja teknologjike, e do të punojmë bashkërisht me të rinjtë, me partnerët tanë që të zhvillojmë temat që vërtet janë me rëndësi, si Data Science", potencoi rektori Hajrizi.

Ndërkaq, anëtari i Bordit Menaxhues në Raiffeisen Bank, Shukri Mustafa, tha se fokusi i garës është përfshirja e studentëve në gjetjen e mënyrave se si të digjitalizohen bankat tradicionale.

Sipas tij, bankat tanimë duhet të ofrojnë shërbime të standardizuara dhe duhet të jenë të dizajnuara në mënyrë digjitale. "Organizimi i garës në fjalë ka të bëjë me grumbullimin e të dhënave, pasi është një pasuri e madhe kur ke të dhëna të shumta të klientëve. Përveç shfrytëzimit të të dhënave, duhet të bëhet edhe analizimi i pjesës së rrezikshmërisë që u kanoset klientëve dhe sigurisht duhet të nxjerrën analiza të tilla nga kjo garë, analiza që dëshirojmë ti shfrytëzojmë në punën e bankës tonë", theksoi ai.

Garuesit i vizitoi shefja departamentit të riskut në bankën Raiffeisen, Anita Kovacic, si dhe kryetari i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija.

Data Science Hackathon do të zhvillojë punimet edhe nesër më 24 mars, ndërkaq në bazë të rezultateve të treguara, juria profesionale do të shpallë edhe tri grupet më të suksesshme. Vendi i parë do të shpërblehet me 1 mijë e 500 euro, vendi i dytë me 1 mijë euro dhe vendi i tretë me 500 euro. Gjithashtu do të ndahen edhe shpërblime të tjera, si pajisje të shumta teknologjike.

Gjithashtu do të ndahen edhe shpërblime të tjera, si pajisje të shumta teknologjike.

Gjithashtu do të ndahen edhe shpërblime të tjera, si pajisje të shumta teknologjike.

feisen Bank, Shukri Mustafa, tha se fokusi i garës është përfshirja e studentëve në gjetjen e mënyrave se si të digjitalizohen bankat tradicionale.

Sipas tij, bankat tanimë duhet të ofrojnë shërbime të standardizuara dhe duhet të jenë të dizajnuara në mënyrë digjitale. "Organizimi i garës në fjalë ka të bëjë me grumbullimin e të dhënave, pasi është një pasuri e madhe kur ke të dhëna të shumta të klientëve. Përveç shfrytëzimit të të dhënave, duhet të bëhet edhe analizimi i pjesës së rrezikshmërisë që u kanoset klientëve dhe sigurisht duhet të nxjerrën analiza të tilla nga kjo garë, analiza që dëshirojmë ti shfrytëzojmë në punën e bankës tonë", theksoi ai.

Garuesit i vizitoi shefja departamentit të riskut në bankën Raiffeisen, Anita Kovacic, si dhe kryetari i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Petrit Balija.

Data Science Hackathon do të zhvillojë punimet edhe nesër më 24 mars, ndërkaq në bazë të rezultateve të treguara, juria profesionale do të shpallë edhe tri grupet më të suksesshme. Vendi i parë do të shpërblehet me 1 mijë e 500 euro, vendi i dytë me 1 mijë euro dhe vendi i tretë me 500 euro. Gjithashtu do të ndahen edhe shpërblime të tjera, si pajisje të shumta teknologjike.

Gjithashtu do të ndahen edhe shpërblime të tjera, si pajisje të shumta teknologjike.

Gjithashtu do të ndahen edhe shpërblime të tjera, si pajisje të shumta teknologjike.

Gjithashtu do të ndahen edhe shpërblime të tjera, si pajisje të shumta teknologjike.

Gjithashtu do të ndahen edhe shpërblime të tjera, si pajisje të shumta teknologjike.

Gjithashtu do të ndahen edhe shpërblime të tjera, si pajisje të shumta teknologjike.



Në Kosovë u mbajt mbledhja e Asamblesë të Përgjithshme të Organizatës për Cilësi në Evropë

Për herë të parë në Kosovë u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës për Cilësi në Evropë, ku nikoqir i saj është organizata "Quality Kosova", nën udhëheqjen e presidentit, prof.dr. Edmond Hajrizi.

Takimi i Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës për Cilësi në Evropë mbledhi në Prishtinë përfaqësues nga të gjitha vendet e Evropës, të cilët përfaqësojnë organizatat e tyre nacionale për menaxhimin e cilësisë, standardeve dhe certifikimeve, profesionistë dhe ekspertë të dalluar nga industri të ndryshme me renome botërore.

Në takim, ndër tjerash, është diskutuar për mbështetjen dhe angazhimin shoqëror që duhet dhënë arsimit të lartë, njëherësh pjesëmarrësit kanë shkëmbyer përvojat e tyre për sigurimin e cilësisë. Gjithashtu, në takim u tha se duhet nxitur studentët dhe profesorët për të punuar në hulumtime shkencore, inovacion, si dhe u theksua se duhet të përgatiten gjeneratat për karrierë dhe të kenë rol aktiv

në shoqëri.

Pas mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës për Cilësi në Evropë, përfaqësuesit e vendeve evropiane kanë vizituar Kampusin Inovativ të UBT-së në Lipjan. Ata janë mahnitur me UBT-në me gamën e gjerë të programeve dhe infrastrukturën që ofron, teksa thanë se UBT ka arritje të jashtëzakonshme në arenën ndërkombëtare, arritje në hulumtime, inovacion dhe mësimdhënie. Ata vlerësuan se UBT duhet të jetë model për gjitha institucionet arsimore në vend dhe Evropë, për qasjen akademike dhe mundësitë që u jep studentëve në veprimtarinë intelektuale. "Quality Kosova", u themelua në vitin 2006, me iniciativë të rektorit të UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ku është anëtare e Organizatës Evropiane për Cilësi, dhe bashkërisht promovojnë standardet më të mira të cilësisë dhe aspekteve me rëndësi të jetës në Evropë dhe më gjerë.



Kosova për herë të parë do të përfaqësohet në garën e Microsoft-it në SHBA



Artin Ahmeti, Elita Hajrizi, Edonis Hebibi dhe Elta Bajrami, janë talentët kosovarë që do ta përfaqësojnë shtetin e Kosovës në Kampionatin Botëror të Microsoft Office Specialist "MOS", që sivjet do të mbahet në SHBA.

Të rinjtë fillimisht fituan garën e Microsoft-it në niv-

el vendi, të cilët demonstruan aftësitë e tyre superiore në aplikacionet e Microsoft-it, në Word, Exel dhe PowerPoint. Ata janë shpallur kampionë shtetëror në bazë të pikëve të fituara nga testet unike që janë zhvilluar në këtë garë të organizuar nga UBT dhe organizata botërore Certiadria, dhe automatikisht fituan të drejtën e përfaqësimit të vendit në nivel global.

Në SHBA, të rinjtë kosovarë do të hyjnë në garë për titullin e kampionit të botës, pjesë e së cilës do të jenë kandidatë nga shumë shtete anë mbarë botës, teksa do të garojnë për tri kategoritë e Microsoft-it.

UBT në çdo formë i ka mbështetur këta të rinj dhe është duke i përgatitur për të përfaqësuar sa më mirë Kosovën në arenën ndërkombëtare. Falë kontributit dhe angazhimit të institucionit të arsimit të lartë, të UBT-së, këtë vit është hera e parë që në nivel vendi organizohet gara e Microsoft-it, në të cilën garuan mbi 300 pjesëmarrës, teksa vetëm 30

prej tyre arritën deri në fazën finale.

Për gjithë pjesëmarrësit, UBT dhe Microsoft ka ndarë certifikata që janë të vlefshme kudo në botë.

Dhjetë finalistët e Garës "MOS" në nivel vendi janë:

Microsoft Word 2016

Elita Hajrizi, nxënëse e shkollës "Xhevdet Doda" Elbion Redenica, nxënëse e shkollës "Elena Gjika" Elta Bajrami, nxënëse e shkollës "Sami Frashëri" Ylber Galica, nxënëse në "Mehmet Akif"

Microsoft Exel 2016

Edonis Hebibi, student i UBT-së Neriton Pacarizi, student i UBT-së Jona Ndrecaj, Shkolla "Hajdar Dushi"

Microsoft PowerPoint 2016

Artin Ahmeti, nxënëse në "Mehmet Akif" Erza Krasniqi, nxënëse në shkollën "Elena Gjika" Poema Berisha, studente e UBT-së

UBT – Institucioni që ofron trajnime të shumta profesionale

Besnik Skenderi - Drejtor për Produkte Profesionale dhe Zhvillimore në UBT, Besnik Skenderi.

Në kuadër të UBT-së, Departamenti i Shkollave Profesionale është duke organizuar trajnime profesionale dhe të përshtatura për studentët dhe për tregun e jashtëm. Si trajnime të reja që jemi duke i mbajtur janë trajnimet nga fusha e teknologjisë informative, menaxhimi i përgjithshëm, gjuhët e huaja dhe jemi duke ofruar trajnime të përshtatura për sektorin e biznesit. Këtë vit kemi mbajtur trajnime për:

ArcGis

Asistent Administrativ

Cyber Security Operations

Gjuhë Angleze

Gjuhë Gjermane

Hulumtimet Shkencore dhe Analiza e të dhënave me SPSS

IT Essentials

Marketing Digjital

Menaxhimi i burimeve njerëzore

Menaxhimin e Projekteve

MS Excel të Avancuar

MS Project

Përgatitje për TOEFL

Trajnim dhe certifikim për IPMA

Pjesëmarrësit në trajnime kanë qenë nga industria dhe ata kanë vlerësuar shumë lartë profesionalizmin e trajnerëve dhe ligjëruesve dhe kanë theksuar se me njohuritë e fituara në trajnime puna e tyre është bërë më e lehtë.

Me qëllim të ngritjes të kualitetit të trajnimeve Shkolla Profesionale e UBT ka i mbanë trajnimet duke u bazuar në plan programet e aprovuara nga kompanitë e njohura ndërkombëtare që ofrojnë certifikime si Microsoft, CISCO, COMP-TIA+, CERTIPORT, PearsonVue, IPMA, ORACLE. Për më tepër ligjëruesit tonë janë trajnerë të certifikuar ndërkombëtarësh nga CISCO, MICROSOFT, GOOGLE, Learning Tree dhe kanë përvojë të gjatë në ofrimi e trajnimeve.

Gjatë kësaj kohe kemi organizuar edhe gara të ndryshme në bashkëpunim me parterët tona. Muajin e kaluar e kemi pas garën Data Science Hakathon që e kemi organizuar me Raiffaisen Bank dhe kemi pas mbi 120 pjesëmarrës. Ndërsa aktualisht jemi të proces të zhvillimit të Kampionatit për Microsoft Office User Specialist dhe këtë garë jemi duke e organizuar së bashku me Certiadrian.

Ekipi i i Shkollës Profesionale mbetet i përkushtuar që të vazhdojë me shërbime profesionale dhe të kontribuoj drejt përbushjes së vizionit dhe misionit të UBT-së.

Ekspozita Ndërkombëtare e Artit në Bienalen e Venedikut

Profesori në UBT, Alban Muja përfaqëson Kosovën në ngjarjen botërore të artit pamor

Në Venecia, konkretisht në Ekspozitën Ndërkombëtare të Artit në Bienalen e Venedikut, është hapur edhe Pavijoni i Kosovës, që po përfaqësohet nga profesori i artit në UBT, Alban Muja.

Muja është përzgjedhur të përfaqësojë vendin me projektin “Albumi Familjar”, punim artistik multimedial që ka të bëjë me fëmijët që janë fotografuar nga mediat e njohura në atë kohë si refugjatë.

Artisti në fjalë ka realizuar video me ata fëmijë 20 vjet pas me qëllim të përkujtimin të sfidave me të cilat janë ballafaquar refugjatët në vitin 1999, si dhe sfidat e refugjatëve të sotëm.

Me qëllim që edhe Kosova të realizojë suksesshëm pavijonin me videoinstalacionin e profesorit dhe artistit kosovar, UBT ka mbështetur në çdo aspekt dhe ka sponsorizuar pjesëmarrjen e artistit në këtë bienale.

Ndërkaq, në hapje Pavijonin e ka vizituar edhe kryeparlamentari, Kadri Veseli, i cili ka thënë se në prag të 20-vjetorit të çlirimit, zëri i Kosovës për të kërkuar drejtësi po dëgjohej në Bienalen e Venedikut përmes Alban Mujës.

“Në rrugën tonë të pakthyeshme për të kërkuar drejtësi për viktimat e luftës, një ndihmë të jashtëzakonshme do ta japin edhe Ministria e Kulturës dhe artistët,

nëpërmjet paraqitjeve të tyre brenda dhe jashtë vendit”, tha Veseli.

Edicioni i 58-të i Bienales së Venedikut do të hapet për publikun me datë 11 maj dhe do të jetë i hapur deri më 24 nëntor 2019.



Profesori i UBT-së, Hysen Ahmeti ligjëroi për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës

Në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet UBT-së dhe Universitetit Politeknik të Tiranës, profesori në Fakultetin e Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës, Hysen Ahmeti ka mbajtur ligjëratë tematike për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës. “Aplikimi i programeve softuerike në gjeoteknikën inxhinierike” ishte tema e ligjëruar nga profesori Ahmeti, gjatë të cilës i pranishëm në ligjëratë ishte edhe dekani i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, prof. dr. Neritan Shkodrani me bashkëpunëtorë nga fusha përkatëse.

Qëllimi dhe rëndësia e kësaj ligjërate ishte aplikimi i programeve softuerike në zgjidhjen e problemeve në fushën e gjeoteknikës, duke bërë një korrelacion të programeve: Surfer16, Strater5, Autocad 3D civil 2017 dhe Geo5, teksa përpos anës teorike, prezantimi është bërë edhe nga ana praktike, përkatësisht është bërë ilustrimi i programeve me një shembull konkret, duke aplikuar Eurocodet (EC-7, EC-8) për zgjidhjen e problemeve inxhinierike me faktorin e sigurisë së lejuar sipas standardeve gjeoteknike.

Dafina Aliu mori pjesë në Akademinë Mesdhetare të Debatit, në Kroaci

Studentja e vitit të parë në Fakultetin Shkencat Politike në UBT, Dafina Aliu, ka marrë pjesë në Akademinë Mesdhetare të Debatit që është organizuar në Split të Kroacisë.

Në këtë akademi, ajo pati mundësinë të marrë njohuri nga trajnerë të njohur ndërkombëtarë rreth teknikave të avancuara të debatit, mënyrat e argumentimit, si dhe zhvillimin e mendimit kritik.

Dafina ishte pjesëmarrëse edhe në turnamentin, ku ajo së bashku me ekipin

shënoi sukses dhe u renditën në mesin e 10 ekipeve më të mira të akademisë. Akademia Mesdhetare e Debatit është aktiviteti i parë i këtij lloji në të cilën përfaqësohet edhe Kosova. Këtë vit, klubet e debatit në të cilat bën pjesë edhe studentja Dafina Aliu, do të marrin pjesë edhe në disa gara tjera përgatitore, me qëllim për t'u përgatitur për Kampionatin Evropian të Debatit, që sivjet mbahet në Athinë të Greqisë.

Ish-studentja Dafina Isufi po i vijon studimet në Universitetin Shtetëror “Johannes Kepler”, në Austri

Ish-studentja e Fakultetit Juridik, Dafina Isufi është njëra nga shumë studentë që institucioni u ofroi jo vetëm studime cilësore, por edhe punësim. Megjithatë, pas marrjes së njohurive teorike dhe atyre praktike gjatë përvojës disamujore të punësimit në UBT, ajo vendosi që studimet e nivelit master t'i vazhdojë në Universitetin Shtetëror “Johannes Kepler”, në Linz të Austrisë.

Dafina tha se të studiuarit e drejtësisë nuk është një profesion i lehtë, por, sipas saj, UBT e ka bërë shumë më të lehtë këtë rrugëtim profesional.

“Të studiosh drejtësinë nuk është gjë e lehtë, mirëpo UBT me profesorët profe-

sionistë dhe me strategjinë unike, studentëve u mundësohet që gjërat e mësuara t'i prekin në përditshmëri, e kjo është e tëra që i duhet një student për të triumfuar gjatë studimeve”, u shpreh ajo.

Përpos përvojës së punës të fituar në UBT, Dafina ka punuar edhe si zyrtare ligjore në Raiffeisen Bank, ku deri tek punësimi ka ardhur pas rekomandimit të UBT-së, gjegjësisht Qendrës së Karrierës.

Pas studimeve në Kosovë e UBT, si dhe përvojave të punës, ajo pret të kthehet në vendlindje për të dhënë kontributin e saj në fushën e drejtësisë

Remzi Sylejmani nga Ministria e Financave ka ligjëruar për studentët e UBT-së mbi investimet kapitale

Marrja e informacioneve nga tregu i punës dhe bashkërendimi i tyre me procesin akademik, po ndikon që UBT të krijojë hapësirë për ligjëratat tematike nga përfaqësues të institucioneve udhëheqëse të vendit, të cilët sjellin një dimension të ri të temave që trajtohen.

Në vazhden e ligjëratarave të tilla, – Udhëheqësi i Divizionit për raportim koordinim dhe politika buxhetore në Ministrinë e Financave, Remzi Sylejmani, ka mbajtur ligjëratë tematike për studentët e vitit të dytë të Fakultetit të Inxhinierisë së Energjisë.

Në kuadër të temës “Planifikimi, menaxhimi dhe monitorimi i investimeve kapitale”, ai u shpjegoi studentëve mbi hapat dhe procedurat përgjatë gjithë këtyre proceseve, duke përmendur edhe sfidat me të cilat përballen gjatë planifikimit, menaxhimit dhe monitorimit të investimeve kapitale.

Ligjëratat tematike në kuadër të Fakultetit të Inxhinierisë së Energjisë po realizohen me qëllim që studentëve t'ju ofrohet një pamje e qartë mbi kërkesat dhe nevojat e tregut aktual të punës.

Dita Ndërkombëtare e Mbrojtjes së të Dhënave Personale

Qytetarët dhe institucionet në Kosovë të rrezikuara nga keqpërdorimi i sistemit të të dhënave

28 janari, Dita Ndërkombëtare e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, e njohur edhe si Dita Ndërkombëtare e Privatësisë, shënohet si datë ku ekspertë të fushës organizojnë edhe fushata ndërgjegjësuere për t'i informuar qytetarët lidhur me të drejtat e tyre në mbrojtjen e të dhënave personale

Zhvillimi i hovshëm i epokës digjitale ka bërë që të transformojë jetën e njerëzimit dhe të shtojë numrin e përdoruesve të internetit, epokë e cila po paraqet edhe sfida të shumta në ruajtjen sigurisë dhe privatësisë.

Për këtë arsye 28 janari, Dita Ndërkombëtare e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, e njohur edhe si Dita Ndërkombëtare e Privatësisë, shënohet si datë ku ekspertë të fushës organizojnë edhe fushata ndërgjegjësuere për t'i informuar qytetarët lidhur me të drejtat e tyre në mbrojtjen e të dhënave personale.

Me këtë rast, UBT në bashkëpunim me komitetin Cyber Security and Privacy mbajtën trajnimin që ka të bëjë me mbrojtjen e të dhënave personale, shkeljen e privatësisë, si dhe masat që duhet të merren në rast se keqpërdorohen të dhënat.

Mentor Hoxhaj nga Cyber Security and Privacy, përmes shembujve praktik tregoi se duhet të ndërgjegjësohemi në këtë aspekt ngaqë zhvillimi teknologjik ka bërë që sot çdo komunikim në mbarë botë, në çdo formë, në çdo kohë mund të monitorohet.

Hoxhaj theksoi se operatorët telefonikë në Kosovë, veç policisë dhe shërbimeve inteligjente, kanë qasje në gjitha informatat e klientëve të tyre. Kjo, sipas tij, përbën edhe shkelje ligjore.

"Policia e Kosovës ka autoritet që të vendosi kamera në hapësira publike. Në atë kohë të dhënat të cilat janë ruajtur kanë qasje numri i telefonit, numri i cili ka thirr dhe koha e thirrjes. Ndërsa tash kemi mbi 40 të dhëna të cilat ruhen në momentin kur thërrasim dikë. Posta i ka dhëna linçet policisë dhe të ua jap autoritetin atyre që ti përgjojnë thirrjet. Në bazë të ligjit Ipko dhe Vala nuk do duhej të dinin se kush po përgjohet. Kemi dy dhoma të përgjimit, ajo e Inteligjencës dhe Policisë. Çdo klient i shërbimit të Vala mundet të përgjohet nga Policia e Kosovës", potencoi Hoxhaj.

Në kohën kur në botë, organet e ndryshme po bëjnë



përpjeke për të rritur ndërgjegjësimin për të drejtat e mbrojtjes së të dhënave, në Kosovë, Mentor Hoxhaj potencoi se vetë zyra e Kryeministrit të Kosovës dhe komunat e vendit nuk janë të mbrojtura në sistemin e të dhënave. Sipas tij, kjo mund të rrezikojnë edhe manipulimin e të dhënave të ndryshme.

"Gjithnjë është dikush që është duke mbledhur informacione mbi ju. Zyra e kryeministrit dhe Komuna e Prishtinës janë të rrezikuara nga hakerët pasi që ata nuk janë mjaftueshëm të mbrojtur", tha ai.

Tutje, Hoxhaj ka thënë se si rezultat i ngjarjeve që rezultuan me probleme të privatësisë, vitin e kaluar

është miratuar Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave e Bashkimit Evropian (GDPR), ku mbron të drejtat dhe liritë e personave lidhur me të dhënat personale të tyre.

Ndërkaq, për të treguar se si të ruhet privatësia, se cilat janë mundësitë në këtë drejtim, se si duhet të rregullohen parametrat e llogarive në aplikacione, se si të bëhet pastrimi i të dhënave online, hulumtuesit në komitetin Cyber Security and Privacy, Endrit Vula, Benjamin Gecaj dhe Andin Kryeziu, kanë treguar praktikisht zgjidhjet e mundshme dhe dhanë këshilla të përgjithshme në këtë drejtim.

Për herë të parë në Kosovë

Në UBT u mbajt simpoziumi i parë për qytetet e mençura

Çështja e qyteteve të mençura tashmë është bërë një temë globale, por për herë të parë një simpoziум me një temë të tillë është organizuar nga UBT.

Pjesëmarrës në këtë organizim ishin profesorë të ndryshëm nga Austria, kryetarë

komunash, drejtorë urbanizimi të komunave të ndryshme, si dhe profesorë e studentë të Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor.

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, duke treguar mbi rëndësinë e jetësimin të ideve mbi qytetet e mençura, tha se UBT për këtë qëllim ka themeluar qendrën "UBT Urban Lab", si qendër për hulumtime urbane.

"Është e rëndësishme që në këtë periudhë të rregullojmë qytetet tona, në mënyrë që të ketë ndikim në rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve, prandaj edhe fokusi i qendrës tonë, por edhe këtij simpoziumi janë palët e interesit që kanë ndikim në implementimin e propozimeve dhe zgjidhjeve tona", vlerësoi ai.

Kryetari i Komunës së Vushtrisë, Xhafer Tahiri theksoi se kjo temë është e rëndësishme dhe e domosdoshme për ndërtimin e qyteteve moderne.

"Vushtrria tani është në fazën e modernizimit dhe sfida jonë themelore është që, në njërin anë të ruajmë atë që është trashëgimi kulturore, kurse në anën tjetër të zhvillojmë qytetin drejt modernizimit, ose të paktën t'i vendosim binarët e modernizimit në të ardhmen", potencoi Tahiri.

Potencialin e Kosovës për zhvillimin e qyteteve të mençura e përkrahi edhe kryetari i Komunës së Junikut, Agron Kuçi, i cili tha se nisja e tillë e ardhur nga UBT nuk është befasi për të, duke qenë se institucioni gjithmonë ka prirë proceset e tilla inovative.

"Është e domosdoshme që si Kosovë të kyçemi në proceset e reja teknologjike, përfshirë edhe qytetet e mençura. Faktori njeri është i mjaftueshëm dhe po plotësohet me zhvillime të reja, por mendoj që nëse ekziston edhe gatishmëria e institucioneve qeverisëse, do të ishte e arritshme", konstatoi Kuçi.

Pas fjalimeve hyrëse, simpoziumi ka vazhduar me punëtori, të cilat i ndoqën studentët dhe profesorët e pranishëm, të ndarë në grupe.

Punëtorja "Dizajnimi i qyteteve të mençura dhe menaxhimi i arsimit" u mbajt nga rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, i cili transformimin e teknologjisë dhe konvergencën, si funksione që duhet të bashkëveprojnë mes vete për të pasur sukses.



Delegacioni i Universitetit "Aleksandër Moisiu" vizitoi UBT-në

Flitet për bashkëpunimin në kuadër të projektit DIMTV



Dita Ndërkombëtare e Radios mbledhi në UBT dhjetëra ekspertë dhe gazetarë shumëvjeçarë, të cilët diskutuan mbi historinë, transformimin, sfidat aktuale, si dhe të ardhmen që e pret radion, si një ndër mediumet që më së shumti i ka qendruar kohës.

Të gjitha këto çështje u diskutuan për nder të kësaj dite në konferencën me titull: "Radio sot dhe nesër në Kosovë", që u organizua nga Instituti i Mediave i Kosovës dhe UBT.

Në emër të UBT-së, rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi vlerësoi se edhe përkundër transformimit që ka pësuar ndër vite, radio mbetet ende media më e afërt me publikun.

"Radio ka pësuar ndryshime të mëdha, megjithatë duke parë trendët botërorë të përdorimit të radios, mendoj që fokusimi i radios sot duhet të jetë tek ndërtimi i paqes dhe i tolerancës. Prandaj, radio do të vazhdojë funksionimin, por me koncept të ndryshuar dhe të përshtatur për audiencat e ditëve të sotme", tha Hajrizi.

Në mesin e shumë vështirëve që i janë paraqitur radios si media, kryetari i Institutit të Medias në Kosovë, Fazli Veliu, përmendi disa prej tyre që po e rëndojnë veprimtarinë e tyre në Kosovë, veçanërisht radiove lokale.

"Radio në Kosovë është në gjendje aspak të favorshme, e këtë gjendje e ka rënduar edhe më shumë taksa vjetore prej 360 eurove, të cilën duhet ta paguajnë radiot.

Kjo situatë duhet të ndryshojë, andaj i bëj thirrje KPM-së që ta heqin kjo taksë që po i ngarkon radiot financiarisht", theksoi Veliu.

Njohësi i mediave elektronike, Shaban Arifaj sqaroi se pavarësisht disa mendimeve kritike, radio vazhdon të jetë një ndër burimet kryesore të informacionit dhe të zbavitjes.

Në Universitetin e Shkencave Teknike, në Novi Sad

Profesori Blerton Abazi përfaqëson UBT-në në punëtorinë e projektit BESTSDI

Profesori i UBT-së, Blerton Abazi ka marrë pjesë në punëtorinë e projektit BESTSDI, ku është mbajtur në Universitetin e Shkencave Teknike, në Novi Sad.

Ai ka përfaqësuar UBT-në në mesin e shumë institucioneve akademike nga Belgjika, Gjermania, Bosnja e Hercegovina, Shqipëria, Mali i Zi dhe Serbia, me të cilët kanë bashkëbiseduar lidhur me implementimin e përmbajtjes së re në kurrikulat universitare.

Në këtë takim, profesori Abazi bëri të ditur se UBT ka filluar të integrojë programin SDI në kurrikulat dhe syllabuset, konkretisht në programet për sisteme të informacionit, fushën e ndërtimit, shkencat e të dhënave etj.

Tutje, ai tregoi se UBT ka filluar edhe me implementimin e kurseve Life Long Learning, që ka të bëjë me mësimin gjatë gjithë jetës.

BESTSDI është projekt që financohet nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit Erasmus+, si dhe ka të bëjë me ngritjen e kapaciteteve në fushën e arsimit të lartë. Në kuadër të këtij projekti do të krijohen kurrikula të reja për infrastrukturën e të dhënave hapësinore, ndërkaq pjesë e projektit janë vendet e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë edhe partnerë nga Bashkimi Evropian.



Specialisti i Radiologjisë në Zvicër

Dr. Flamur Mushica ligjëron për studentët e Infermierisë



Specialisti i Radiologjisë, dr. Flamur Mushica, njëherësh mjek kryesor në Klinikën e Radiologjisë në spitalin "Sro Langenthal", në Kantonin e Bernit në Zvicër, ka mbajtur telekonferencë për studentët e Fakultetit të Infermierisë në UBT.

Duke folur për sistemin e shëndetësisë, dr. Mushica konkretisht ka thënë se roli i radiologëve dhe infermierëve është i rëndësishëm edhe në njoftimin dhe sensibilizimin e popullatës për kancerin e gjirit.

Ai tha se stafi mjekësor mund të ndihmojnë në njohjen e masave që duhet të ndërmerren, për rëndësinë e kontrolleve dhe vizitave të vazhdueshme mjekësore.

Dr. Mushica ka thënë se ky lloj i kancerit është më i përhapur në Zvicër sesa në Kosovë, por potencoi se stafi përkatës mjekësor mund të ndihmojë në zbulimin e hershëm të sëmundjes, teksa porositi radiologët dhe infermierët e rinj për trajtim profesional të të prekurve më këtë sëmundje.

Stafi i UBT-së bëri homazhe para varreve të familjes Jashari

Një delegacion i UBT-së, i udhëhequr nga drejtori për Çështje Akademike, prof. dr. Muhamet Ahmeti, ka vizituar kompleksin memorial "Adem Jashari", për të rikujtuar veprën sublimë të kësaj familjeje, që i dha vulën luftës për liri të qytetarëve të Kosovës.

Stafi i UBT-së bëri homazhe para varreve të anëtarëve të familjes Jashari, si dhe vizituan shtëpitë ku janë zhvilluar luftimet që zgjatën tri ditë.

Me rastin e shënimit të kësaj date historike, rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi tha se këto ditë kanë shërbyer për vetëdijësim të botës për atë se çfarë po ndodhte në Kosovë, por në të njëjtën kohë, ka dhënë mesazhin e unifikimit të popullit shqiptar për të luftuar për lirinë dhe të ardhmen premtuese të

gjeneratave të cilat kishin nevojë të rriteshin në liri. "Një familje dha gjithçka që pati që ne sot të frymëjmë lirshëm në tokën tonë, të edukojmë gjeneratën të reja të studentëve, prandaj i përulemi veprës së tyre, e cila po shërben si rrugë e trasuar për ne dhe gjatë gjithë këtyre viteve na ka shërbyer si shembull i dashurisë dhe forcës me të cilën duhet ta duam atdheun", u shpreh Hajrizi.

Disa muaj më parë, UBT ka dërguar mysafirët ndërkombëtarë për vizitë tek kompleksi memorial, "Adem Jashari", me qëllim që t'i njoftojë me historinë e familjes Jashari, që pazgjidhshmërisht lidhet me historinë e çlirimit të Kosovës



Në Ditën Ndërkombëtare të Radios

Ekspertët diskutojnë për problemet dhe të ardhmen e radios në Kosovë

Njohësi i mediave elektronike, Shaban Arifaj sqaroi se pavarësisht disa mendimeve kritike, radio vazhdon të jetë një ndër burimet kryesore të informacionit dhe të zbavitjes. “Është menduar se pas viteve të ‘70-ta, me intensifikimin e punës së qendrave televizive, do të dobësohej ndikimi i mediave jvizuale, pra radiove, por megjithatë, është parë se radio ka mbetur një ndër burimet kryesore të informacionit”, tha ai



Dita Ndërkombëtare e Radios mbledhi në UBT dhjetëra ekspertë dhe gazetarë shumëvjeçarë, të cilët diskutuan mbi historinë, transformimin, sfidat aktuale, si dhe të ardhmen që e pret radion, si një ndër mediumet që më së shumti i ka qëndruar kohës.

Të gjitha këto çështje u diskutuan për nder të kësaj dite në konferencën me titull: “Radio sot dhe nesër në Kosovë”, që u organizua nga Instituti i Mediave i Kosovës dhe UBT.

Në emër të UBT-së, rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi vlerësoi se edhe përkundër transformimit që ka pësuar ndër vite, radio mbetet ende media më e afërt me publikun.

“Radio ka pësuar ndryshime të mëdha, megjithatë duke parë trendet botërore të përdorimit të radios, mendoj që fokusimi i radios sot duhet të jetë tek ndërtimi i paqes dhe i tolerancës. Prandaj, radio do të vazhdojë funksionimin, por me koncept të ndryshuar dhe të përshtatur për audiencat e ditëve të sotme”, tha Hajrizi.

Në mesin e shumë vështirëve që i janë paraqitur radios si media, kryetari i Institutit të Medias në Kosovë, Fazli Veliu, përmendi disa prej tyre që po e rëndojnë veprimtarinë e tyre në Kosovë, veçanërisht radiove lokale.

“Radio në Kosovë është në gjendje aspak të favorshme, e këtë gjendje e ka rën-

duar edhe më shumë taksa vjetore prej 360 eurove, të cilën duhet ta paguajnë radiot. Kjo situatë duhet të ndryshojë, andaj i bëj thirrje KPM-së që ta heqin kjo taksë që po i ngarkon radiot financiarisht”, theksoi Veliu.

Njohësi i mediave elektronike, Shaban Arifaj sqaroi se pavarësisht disa mendimeve kritike, radio vazhdon të jetë një ndër burimet kryesore të informacionit dhe të zbavitjes.

“Është menduar se pas viteve të ‘70-ta, me intensifikimin e punës së qendrave televizive, do të dobësohej ndikimi i mediave jvizuale, pra radiove, por megjithatë, është parë se radio ka mbetur një ndër burimet kryesore të informacionit”, tha ai.

Ish-kryetari i bordit të KPM-së, Adnan Merovci ka paraqitur gjendjen aktuale të radiove në Kosovë, teksa dha edhe shpjegim sa i përket taksës vjetore të vendosur ndaj radiove lokale.

“Taksa e licencës është çështje ligjore, pasi ligji parasheh këtë taksë. Interesi i shtetit nuk është në këtë taksë, por është në informim. Këtu është edhe pasuria, vlera, fitimi, prandaj ligjërisht duhet të ketë një taksë”, ka thënë Merovci.

Pronari i Radio Malishevës, Habib Zogaj, tregoi përvojën e tij personale, fillimisht si korrespondent i Radio Evropa e Lirë, e pastaj si themelues i radios lokale që është duke e udhëhequr edhe tani.

“Kur të gjitha mediat i kishte në dorë pushtuesi dhe kur i mbylli ato, radio Evropa e Lirë vazhdoi të funksiononte, por me shumë vështirësi dhe atë duke e ndryshuar lokacionin e vet në çdo vit.

Konferenca u mbyll me një diskutim të hapur me audiencën, që e zgjeroi tematikën edhe në çështje dhe problematika të tjera, me të cilat po përballen aktualisht radiot në Kosovë, si dhe ofruan edhe disa zgjidhje për mënyrat se si mund të rregullohen problemet aktuale, në mënyrë që ato mos të mbesin të tilla edhe në të ardhmen.



Me programet unike të studimit

UBT ndihmon studentët për t'u shndërruar në ndërmarrës të suksesshëm



Shifrat e larta të ish-studentëve dhe studentëve të UBT-së, të cilët janë të punësuar në Kosovë dhe nëpër vende të ndryshme të botës, tregojnë motivimin dhe përgatitjen e lartë gjatë studimeve, konform kërkesave aktuale të tregut të punës. Programet unike dhe momentalisht më të nevojshmet që ofron UBT, krijojnë mundësi që studentët e UBT-së të jenë më të kërkuarit dhe më të përgatiturit, madje edhe në pozita pune të cilat janë fare pak të njohura në Kosovë.

Nga studentët e UBT-së kanë dalë punimet, projektet dhe produktet më inovative, të prodhuara ndonjëherë në Kosovë, të cilat kanë qenë një befasi e mirë edhe për partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë të UBT-së dhe Kosovës.

Po këta studentë kanë ndihmuar në procesin e digitalizimit të fabrikave që kanë punuar me mekanizëm të vjetruar, kanë ndërtuar robotë dhe pajisje të tjera

të pazhvilluara ndonjëherë në Kosovë, madje duke e përfaqësuar Kosovën dhe duke fituar vendet e para edhe në gara të ndryshme nëpër botë.

Të gjitha këto përvoja, shumë prej studentëve të UBT-së i kanë shfrytëzuar për të krijuar ndërmarrjet e veta inovative, shumica prej të cilave janë të parat e atij lloji në Kosovë.

Nga studentët dhe ish-studentët e UBT-së kanë dalë edhe shkollat e para digjitale në Kosovë, fabrika për prodhimin e paneleve solare, qendrat për trajnimin e programerëve dhe IT-ve të ardhshëm të Kosovës, si dhe shumë produkte të tjera të veçanta dhe inovative.

Kjo ka ndikuar që studentët e UBT-së të jenë tejet të suksesshëm dhe të kërkuar në tregun e punës, si dhe të shndërrohen vetë në ndërmarrës, të cilët brenda vetëm pak vitesh punësojnë dhjetëra persona të tjerë në ndërmarrjet e tyre.

UBT organizoi ceremoni për nder të 11-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës

Përçohet mesazhi që të punohet për ngritjen e imazhit të vendit

Organizimi nisi me videon promovuese për Kosovën, e cila është përgatitur nga Media Group-i i UBT-së, ku u prezantua rrugëtimi i Kosovës deri tek pavarësia, si dhe kontributi i UBT-së për zhvillimin, promovimin dhe përfaqësimin e denjë të Kosovës kudo në botë



Më 17 shkurt bëhen 11 vjet nga shpallja e Pavarësisë së Kosovës dhe UBT e shënon këtë ditë si më të rëndësishmen në kalendarin e festave historike. Për t'i dhënë madhësinë që e meriton, UBT për nder të kësaj feste shtetërore ka organizuar një ceremoni në të cilën morën pjesë studentë e profesorë të UBT-së, si dhe të ftuar nga universitete partnere.

Organizimi nisi me videon promovuese për Kosovën, e cila është përgatitur nga Media Group-i i UBT-së, ku u prezantua rrugëtimi i Kosovës deri tek pavarësia, si dhe kontributi i UBT-së për zhvillimin, promovimin dhe përfaqësimin e denjë të Kosovës kudo në botë.

Nën emocionet e kësaj videoje, rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi

kujtoi rrugëtimin e Kosovës dhe nivelin e lartë të përgjegjësisë që UBT e pati përgjatë gjithë këtyre viteve, me qëllim që Kosovës t'i krijonte imazh sa më pozitiv në botë.

“Motivimi për të cilin është themeluar UBT është ndikimi që një institucion akademik duhej dhënë për ndërtimin e shtetit tonë. UBT është nder dhe krenari për Kosovën. Ne kemi punuar me shpirt dhe me plot energji pozitive që imazhi i Kosovës të përmirësohet, e do të vazhdojmë të punojmë edhe më shumë që shtetin tonë ta përfaqësojmë denjësisht dhe të rinjtë tanë të ndjehen me fat dhe krenarë që janë nga Kosova”, tha Hajrizi.

Ai përmendi edhe nivelin e lartë të kompetencave që të rinjtë kosovarë i kanë formuar përgjatë viteve të studimit në UBT, teksa përmendi edhe 189 studentë që janë bursistë vetëm gjatë vitit të kaluar akademik.

“UBT po krijon kuadrot më profesionale të vendit, dhe gjithsesi që në tërë këtë rrugëtim studentët tanë nuk kanë qenë dhe nuk janë të vetëm, kjo sepse ne u kemi kursyer familjeve kosovare rreth 1 milion e 400 mijë euro përmes ofrimit të bursave për fëmijët e tyre dhe për studentët e Kosovës”, tregoi ai.

Drejtori për Çështje Akademike në UBT, prof. dr Muhamet Ahmeti përmendi sakrificat nëpër të cilat ka kaluar populli i Kosovës për të jetësuar ëndrrën e çdo gjenerate, që është pavarësia e vendit.

“Populli i Kosovës ka vuajtur shumë për të arritur sot deri në këtë ditë, andaj gjithmonë është momenti që të kujtojmë qytetarët më të mirë të këtij vendi, të cilët kanë flijuar edhe veten e tyre për lirinë e vendit”, vlerësoi Ahmeti.

Për nder të po kësaj dite, në emër të UBT-së, rektori Hajrizi ndau edhe Çmimin “Excellence Leadership Award” për ekspertin e cilësisë, Andreas Dalluege, me qëllim që të nderohet kontributi dhe performanca e tij si lider në zhvillimin e cilësisë në edukim, biznes, teknologji dhe inovacion, duke veçuar ndihmën që po i jep UBT-së në këtë rrugëtim.

I nderuar për marrjen e këtij Çmimi, Dalluege potencoi se tash ndjehet edhe më i obliguar që të ndihmojë UBT-në dhe Kosovën në arritjen e shkallës më të lartë të cilësisë në të gjitha fushat.

UBT feston dhe organizon çdo vit ceremoni për nder të Pavarësisë së Kosovës, që shërben si një ditë reflektimi mbi të arriturat dhe kontributin e UBT-së në ngritjen e cilësisë akademike,

Mirënjohje për kontributin e jashtëzakonshëm në mbrojtjen e qytetarëve të Kosovës

Shoqata Miqtë e Amerikës dhe UBT i dërgojnë veshjet tradicionale shqiptare ish-presidentit të SHBA-ve, George W. Bush

Në shenjë mirënjohjeje për kontributin e jashtëzakonshëm në mbrojtjen e qytetarëve të Kosovës dhe për përkrahjen e dhënë gjatë procesit të shtet-ndërtimit, Shoqata Miqtë e Amerikës dhe UBT do të dërgojnë veshjet tradicionale shqiptare për ish-presidentin e SHBA-ve, George W. Bush dhe bashkëshorten e tij, Laura Bush.

Me këtë rast, kryetari i Shoqatës Miqtë e Amerikës, Agim Rexhepi tha se me një veprim të tillë dëshirojnë t'i tregojnë ish-presidentit Bush se populli i Kosovës nuk e ka harruar kontributin e tij të madh për çështjen e Kosovës.

“Populli i Kosovës është përjetësisht falënderues, mirënjohës dhe nuk do të harrojë asnjëherë veprimet që ka bërë shteti amerikan, e në veçanti, presidenti George W. Bush”, potencoi Rexhepi. Ndërkaq, rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, si donator i veshjeve tradicionale që do t'i dërgohen ish-presidentit Bush, theksoi se UBT gjithmonë do të jetë në përkrahje nismave të tilla, të cilat kanë të bëjnë me vlerësim të kontributit të njerëzve që kanë bërë shumë për vendin tonë.


“Falë SHBA-ve ne kemi pasur mundësi që të fitojmë lirinë, të shpallim pavarësinë dhe dërgimi i kësaj dhurate është gjesti më i vogël që mund të bëjmë për të falënderuar përkrahësit më të mëdhenj të shtetit tonë”, tha Hajrizi.

Gjatë ditëve në vijim, UBT dhe Shoqata Miqtë e Amerikës do të ndërmarrin edhe aktivitete të tjera të përbashkëta, të cilat do të kenë për qëllim njohjen e kontributit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si zëri më i fuqishëm për mbrojtjen e qytetarëve të Kosovës para dhe pas luftës.



Në Ditën e Tokës

UBT i bashkohet nismës botërore për mbjelljen e drurëve



Në Ditën Botërore të Tokës, dhjetëra studentë dhe pjesë të stafit të UBT-së, i janë bashkuar nismës botërore, #plantatree, duke mbjellur disa drunj dhe lule në oborrin e Kampusin Inovativ, në Lipjan. Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi tha se nuk duhet harruar asnjëherë ta vendosim ruajtjen e ambientit ku jetojmë në plan të parë, sepse Toka është planeti

i vetëm që na ofron të gjitha kushtet e mundësitë për jetë.

“Është koha e ndërtimeve të larta dhe të shumta, por asnjëherë nuk duhet të harrojmë të jemi miq të natyrës, kjo duke mbjellë sa më shumë gjelbërim dhe duke shfrytëzuar sa më shumë materiale që riciklohen lehtësisht”, vlerësoi Hajrizi.

Tryezë diskutimi

Në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, nga UBT përçohet mesazhi për bashkim në luftim të pabarazisë gjinore

Për nder të 8 Marsit – Ditës Ndërkombëtare të Gruas, në UBT është organizuar tryezë diskutimi me titull: “Sfidat dhe tejkalmimi i tyre për arritjen e fuqizimit të vajzave dhe grave në Kosovë”, në të cilën akademike nga UBT dhe anëtare të shoqërisë civile paraqitën qëndrimet e tyre mbi sfidat me të cilat përballen gratë për shkak të gjinisë, si dhe hapat që duhet ndërmarrë për tejkalmimin dhe fuqizimin e pozitës së gruas në shoqërinë kosovare.

Menaxherja në Zyrën e Financave në UBT, Fisnete Hajrizi tha se UBT është munduar të instalojë politikën e forcimit të pozitës së gruas përmes ofrimit të edukimit cilësor dhe fuqizimit ekonomik të tyre. “Si UBT gjithmonë i kemi kushtuar rëndësi të madhe angazhimit të gruas në organizatë dhe si rezultat i këtij përkushtimi, ne sot fatmirësisht rezultojmë të jemi institucioni i parë me numrin më të madh të grave të punësuar në rajon, dhe atë, të gjitha në pozita udhëheqëse”, tha ajo, teksa uroi që modelin e UBT-së ta marrin edhe institucionet tjera.

Udhëheqësja e panelit të diskutimit, prof. dr. Jorida Xhafaj, që mban pozitën e dekanes së Fakultetit Juridik, tha se bazë për krijimin e një shoqërie të qëndrueshme është fuqizimi ekonomik i grave dhe se prej këtij lloji fuqizimi gratë janë në gjendje që automatikisht të jenë aktive në vendimmarrje.

“E drejta në pronësi do të thotë e drejtë për të pasur zë, është shteg për fuqizim, integritet dhe aktivizim, por sfida në këtë proces mentaliteti dhe pengesat në rrafshin kulturor në shoqëri, që i bënë gratë të heqin dorë nga pasuria që u takon me ligj”, shpjegoi ajo.

Doktoresha shumëvjeçare, njëherësh ehe ligjëruese në UBT, Syheda Latifi-Hoxha përmes një prezantimi sqaroi rolin e gruas profesioniste në shëndetin e nënave dhe fëmijëve në Kosovë dhe në botë.

Ajo bëri krahasimi ndërmjet shkallës së vdekshmërisë së nënave gjatë procesit të shtatzënisë, lindjes, si dhe të periudhës pas lindjes.

“Nuk jemi në gjendje alarmante, por shpresoj që mbijetesa e grave dhe fëmijëve të jetë e madhe dhe që bashkë të mposhtim vdekjen kur ajo është e parandalueshme. Kurse, sot dua të jap edhe mesazhin që gratë kudo të fuqizohen duke e përdorur si argument dijen, seriozitetin dhe rezultatin në punë”, potencoi ajo. Përfaqësuesja e organizatës “Institute of Women for Empowerment”, Arbenita Tërdevci tha se UBT është duke bërë një punë të jashtëzakonshme në vetëdijësimin e komunitetit për rëndësinë e fuqizimit të grave, teksa vlerësoi se sikur të gjitha institucionet të vepronin sikur UBT-ja, deri tani nuk do të kishim nevojë për kuota gjinore askund.

“Gratë kanë ende vështirësi që të shkollohen, të gjejnë një vend pune dhe të



zënë vend në një shoqëri që nuk i gjykon për zgjedhjet e tyre. Të gjitha këto janë sfida të vështira për t'u kaluar, por që mund të tejkaloen vetëm duke u bërë bashkë, e duke e vetëdijësuar komunitetin mbi rëndësinë e të jetuarit në një shoqëri të barabartë” potencoi ajo.

Tërdevci shpalosi edhe platformën dhe projektet e organizatës “Institute of Women for Empowerment”, që synon të ulë pabarazinë gjinore në internet, përmes publikimit të historive të grave të suksesshme shqiptare, duke qenë se shumica dërrmuese e përmbajtjeve në internet janë të shkruara për burrat. Menaxherja e biznesit social, “Sa Punë”, Altinë Nika shpalosi punën që bëhet në kuadër të këtij projekti dhe në tërësi në kuadër të organizatës “The Ideas Partnership”.

“Ne kemi krijuar një biznes social që i ka punësuar gratë e komunitetit rom, kurse mjetet nga produktet e shitura shkojnë për këto gra dhe për shkollimin e fëmijëve të tyre. Prandaj, vetëm me produkte kaq të thjeshta, por të bukura, ne mund të fuqizojmë gratë”, tregoi ajo.

Në fund, Nika hapi edhe mini-panairin e produkteve të Sa Punë, ku secili nga pjesëmarrësit pati mundësi të fuqizonte këto gra përmes blerjes së produkteve, teksa UBT si institucion e ndihmoi këtë biznes social përmes blerjes së dhuratave për të gjithë stafin e gjinisë femërore.

UBT dhe Raiffaisen Bank hapin laboratorin më inovativ të teknologjisë në Kosovë



Në Kampusin Inovativ të UBT-së, në Lipjan, është përruruar laboratorin e teknologjisë, i cili është krijuar nga UBT dhe Raiffaisen Bank, e që do të përdoret për përgatitje profesionale të studentëve dhe stafit të IT-së së bankës.

Ky laborator është i pajisur me mjetet më të sofistikuar, si dhe do të shërbejë si hapësirë për inovacion dhe teknologji, ku në të studentët do të mund të realizojnë projekte dhe të zhvillojnë punën praktike.

Me këtë rast, rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi ka theksuar se institucioni posedon laboratorët e vet në të gjitha fushat e studimit, ku u mundësojnë studentëve realizimin e projekteve dhe anën praktike të ligjëratave.

Hajrizi tha se laboratorin e teknologjisë mund të përdoret edhe për trajnime, punëtori ose hulumtime të përbashkëta ndër-institucionale.

“Lidhja mes industrisë dhe akademisë gjithnjë është e nevojshme, dhe ka qenë një qasje proaktive e bankës që ka ndihmuar në krijimin e qendrës apo laboratorit të teknologjisë. Është një bashkëpunim për të cilin jemi shumë të kënaqur pasi që studentët do të përfitojnë shumë në kompetencat profesionale. Studentët do të përgatiten profesionalisht dhe duke u bazuar në kërkesat e tregut të punës”, potencoi rektori Hajrizi.

Ndërkaq, anëtari i Bordit Menaxhues të Raiffaisen Bank, Shukri Mustafa, tha se institucioni që ai përfaqëson, po përkrah studentët përmes projekteve të tilla me qëllim të aftësisë profesionale të tyre.

“Përrurimi i këtij laboratorin është si rezultat i një bashkëpunimi të frytshëm me UBT-në. Në fakt, studentët do të kenë mundësinë të shohin se si funksionojnë sistemet tona, si dhe do të përgatiten për të ushtruar profesionin e IT-së edhe në bankë”, tha Mustafa.

UBT posedon mbi 60 laboratorë shkencorë që janë të pasur me pajisje moderne të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, e që funksionojnë në bazë të standardeve Evropiane.

Udhëheqësi i Sistemit të Rrjetit Sizmik të Kosovës ligjëron para studentëve të UBT-së

Trajtohet harta sizmike e Kosovës

Udhëheqësi i sektorit për sizmikë në Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, Shemsi Mustafa ka mbajtur ligjëratë tematike për studentët e nivelit master dhe për stafin akademik të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastruktura, me ç'rast ka trajtuar temën me titull: "Harta sizmike e territorit të Kosovës, roli dhe rëndësia e sizmicitetit në projektimin e objekteve ndërtimore"

Mustafa bëri një prezantim përmbledhës në lidhje me aspektet sizmike, hartën, mikrorajonizimin sizmik dhe çështjet tjera të rëndësishme që duhet konsideruar në fazën e përgatitjes së projekteve ndërtimore, gjithmonë duke vënë theks të veçantë në parametrat e nevojshëm sizmik, të cilët çdo inxhinier

ndërtimi duhet t'i analizojë me kujdes dhe t'i marrë parasysh gjatë projektimit të objekteve inxhinierike.

Gjatë kësaj ligjërate tematike studentët patën rast të njihen edhe me disa zhvillime të reja kërkimore-shkencore që kishin të bënin me sizmicitetin, e në veçanti me sistemet e monitorimit dhe pajisjet që përdoren për këtë qëllim.

Pas përfundimit të ligjëratës, studentët një varg pyetjesh mbi hartën sizmike të Kosovës, saktësinë e saj, mikrosizmicitetin, sa ka informacione në lidhje me sizmicitetin e qyteteve të Kosovës, sa ka mundësi të bashkëpunohet me sektorin e sizmicitetit për të realizuar projekte dhe tema të përbashkëta në këtë drejtim, etj.



Përfaqësuesit në UBT, presin në takim pune zyrtarë të Odës së Afarizmit të Kosovës



Përfaqësuesit në UBT, Nehat Dobritiqi dhe Bejtush Ademi, kanë pritur në takim pune përfaqësuesit e Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK), Diamant Elshani dhe Qendresa Ibrahimiti.

Gjatë këtij takimi kanë diskutuar mundësitë e bashkëpunimit në kuadër të projektit Erasmus + mes OAK-së dhe UBT-së, njëherësh u theksua rëndësia e bashkëpunimit mes të dy palëve në projekte të përbashkëta apo në realizimin e praktikave të ndryshme

të studentëve tek bizneset.

Po ashtu, u tha se kjo mënyrë vlerësohet të jetë e duhura sepse përveç aspektit teorik do të inkorporohet edhe të mësuarit praktik, duke pasur mundësi që të jenë më të përgatitur për tregun e punës.

Palët u pajtuan që në të ardhmen e afërt që të fillojë ky bashkëpunim me anë të nënshkrimit të një memorandumit të mirëkuptimit.

Shpallen lexuesit më të mirë

UBT ka shënuar Ditën Botërore të Librit duke zgjedhur tre titujt më të lexuar nga studentët gjatë këtij viti akademik. Bazat themelore të Infermierisë – Grup autorësh, Java Programming – Ralph Bravaco dhe Shai Simonson, si dhe Elektroteknika – Lutfi Bina, janë tre titujt që kanë qenë më të preferuarit për lexim nga studentët e UBT-së, me qëllim të plotësimit të nevojave të tyre për marrje të njohurive profesionale. Ndërkaq, ditë më parë, nga Biblioteka e UBT-së janë shpallur edhe lexueset e vitit, që në bazë të numrit të librave të lexuar, dolën të jenë studentja e Infermierisë, Ermira Jahiu dhe studentja e Mekatronikës, Vatër Adela Hyseni. Për të shënuar këtë ditë, një fluks i madh i studentëve vizituan Bibliotekën e UBT-së dhe morën për të lexuar librat e tyre të preferuar.

Duke pasur parasysh fushat e larmishme të studimit në UBT, biblioteka fizike është pasuruar me rreth 250 mijë libra të ndryshëm dhe me mbi 52 mijë tituj, duke qenë kështu biblioteka më e madhe fizike në Kosovë dhe rajon.



Në Ferizaj

Profesorët dhe studentët e UBT-së hapën ekspozitën "Dizajnimi i Sheshit"

Dhjetëra punime të profesorëve dhe studentëve të Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, janë prezantuar në hapjen e ekspozitës Open Space/Dizajnimi i Sheshit, në qytetin e Ferizajt.

Në këto punime është paraqitur në mënyrë artistike urbanizimi i këtij qyteti, me ç'rast në hapjen e ekspozitës mori pjesë edhe kryetari i Ferizajt, Agim Aliu.

Aliu potencoi se si kryetar do të punojë që të rinjtë e kësaj komune të kenë mundësi që të zhvillojnë kreativitetin e tyre, si dhe të punojnë në zhvillimin dhe urbanizimin e qytetit.

Ndërkaq, dekani i Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, në UBT, Lulzim Beqiri

theksoi se institucioni, veç tjerash, punon dhe zhvillon projekte që janë në nevojë të shoqërisë.

Ai theksoi se UBT ka studentë dhe staf mjaft të përgatitur sa që bashkërisht ideojnë punime kualitative urbane-arkitektonike, që mund të implementohen edhe në praktike.

Punimet janë punuar nga profesori Skender Kosumi, asistentët e UBT-së Gresa Ramosaj, Rineta Jashari, Sadije Kelmendi, Vigan Perani, në bashkëpunim edhe me studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, në UBT. Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, në UBT.



UBT dhe QKMF shënojnë ditën Botërore të Shëndetit Oral

Fakulteti i Stomatologjisë në UBT në bashkëpunim me Poliklinikën e Stomatologjisë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë, më anë të disa aktiviteteve simbolike kanë shënuar Ditën Botërore të Shëndetit Oral.

Me këtë rast, profesionistët e stomatologjisë në UBT dhe QKMF kanë vizituar kopshtet e Prishtinës, të cilët kanë zhvilluar diskutime me fëmijët për rëndësinë e higjienës orale dhe për përkujdesjen e dhëmbëve që nga moshat e hershme.

Kjo ditë u shënuar me moton "Gojë e shëndetshme, trup i shëndetshëm", teksa aktivitetet janë mbështetur nga

Lakalut.

Dita Botërore e Shëndetit të Oral e vendosur nga Federata Dentare Botërore (FDI), organizohet çdo vit më datë 20 mars. Kjo ditë synon të rrisë ndërgjegjësimin, si dhe të tregojë rëndësinë e madhe që ka shëndeti oral në shëndetin e përgjithshëm dhe mirëqenien.



Fakulteti i Shkencave Politike

Të rinjtë nga Kosova e nga Serbia diskutojnë për sfidat e bashkëpunimit



Me qëllim të eliminimit të paragjyimeve nacionaliste dhe krijimit të lidhjeve mes të rinjve nga Kosova dhe Serbia, me ftesë të Forumit Euroatlantik të Fakultetit të Shkencave Politike në UBT, Kosovën e vizituan anëtarë të shumtë të Këshillit Atlantik të Serbisë. Të rinjtë serbë morën pjesë në aktivitetet e organizuara nga UBT, teksa mbajtën edhe një bashkëbisedim me studentët e UBT-së, që në fokus ishin çështjet që i prekin të dyja shoqëritë.

Pjesë e panelit të këtij diskutimi ishin dekani i Fakultetit të Shkencave Politike në UBT, dr. Arian Starova, Presidenti i Asociacionit Euro-Atlantik të Kosovës, Besfort Rrecaj, si dhe Presidenti i Këshillit Atlantik të Serbisë, Vladan Zhivuloviç.

Penelistët përçuan mesazhin që gjeneratat e reja duhet të mos bien pre e politikës dhe duhet të bashkëpunojnë me të gjitha komunitetet pa dallim, duke u shprehur se të rinjtë e të dyja vendeve

nuk duhet të kenë paragjyime, por duhet të punojnë dhe kontribuojnë për të ardhmen evropiane të tyre.

Ndërkaq, të rinjtë njëzëri thanë se janë të interesuar që vendet prej nga ata vijnë të kenë marrëdhënie miqësore. Ata thanë se shtetet si Kosova e Serbia, duhet krijojnë raporte si vende fqinje dhe duhet të punojnë në zhvillim të qëndrueshëm. Tutje, ata biseduan edhe për idenë se një marrëveshje përfundimtare ndërmjet të dy vendeve që do të kishte përfunduar me njohjen e ndërsjellë, do të ishte në dobi të të dy vendeve.

Të rinjtë serbë, të shoqëruar nga studentët e UBT-së, vizituan KFOR-in në Kosovë, ku u pritën nga komandanti, Gjeneral Majro Lorenzo D'Addario. Gjenerali D'Addario ka theksuar rolin që këta të rinj e kanë në ndërtimin e një ardhmeje pa paragjyime të së kaluarës. Grupi i të rinjve nga Serbia, përveç Prishtinës, vizituan edhe disa monumente historike në Kosovë.

Studentët e Fakultetit Juridik, pjesë e projektit të BE-së për përgatitje profesionale të juristëve të ardhshëm

Albin Murati, Besmira Reçica, Gentiana Ajeti dhe Florid Shabani, janë studentët e Fakultetit Juridik të UBT-së, të cilët u zgjodhën nga Oda e Avokatëve të Kosovës për të marrë pjesë në Projektin e financuar nga BE, "Mbështetje Profesionale të Lira Ligjore dhe Odës së Avokatëve".

Në kuadër të këtij projekti është mbajtur një seancë gjyqësore e modifikuar, në të cilën studentët e Fakultetit Juridik dhe praktikantët në OAK, të interesuar në profesionin e avokatëve, kanë luajtur rolin e përfaqësuesve në një seancë gjyqësore, sikurse të ishin në një seancë të vërtetë.

Ky ushtrim ishte i rëndësishëm në zhvillimin e të menduarit kritik dhe në ngritjen e aftësive të vendimmarrjes, si dhe ishte mjet i cili u ofroi pjesëmarrësve një përvojë praktike me profesionin e avokatëve, por edhe të disa funksioneve të tjera të cilat kryhen në gjykatë.



Studentët e UBT-së marrin pjesë në një seancë gjyqësore të vërtetë

Studentët e vitit të tretë të Fakultetit Juridik, në UBT, kanë realizuar vizitë studimore në Gjykatën Themelore, në Prishtinë, me ç'rast edhe e ndoqën nga afër një seancë gjyqësore të udhëhequr nga gjykatësi, Hamdi Ibrahim.

Një vizitë e tillë është bërë pas realizimit të disa seancave simuluese nga studentët e po të njëjtit fakultet, ndërkaq vizita e fundit u bë me qëllim që studentët të marrin njohuritë themelore mbi format dhe mbarëvajtjen e një seance të vërtetë gjykimi. Studentët e Fakultetit Juridik realizojnë vizita të tilla studimore, por edhe marrin pjesë në gara të ndryshme brenda dhe jashtë Kosovës, me qëllim që të bashkërendojnë edhe në praktikë njohuritë e tyre profesionale.



Aktivitetet e Fakultetit të Juridikut UBT

Studentët e Fakultetit Juridik përfunduan gjykimin simulues me vlerësim të lartë

Studentët e Fakultetit Juridik në UBT, pas teorisë së mësuar përgjatë një semestri, kanë mbajtur një gjykim të simuluar, në mënyrë që të bashkërendoheshin mësimet teorike me ato praktike.

Gjatë kësaj periudhe, profesori i lëndës "Klinikë ligjore", Florim Shefqeti punoi me studentët në mënyrë që ata të jenë sa më të përgatitur për këtë simulim.

Gjatë performancës së gjykimit, ata simuluan një rast krimi, ku studentët do të paraqiteshin në rolet e trupit gjykues, prokurorëve dhe avokatëve.

Të pranishëm në këtë organizim ishin edhe shumë profesorë të këtij drejtimi, të cilët përcollën ngjarjen nga afër dhe vlerësuan punën e studentëve të tyre.

Prof. dr. Jorida Xhafaj, dekane e Fakultetit Juridik, i përgëzoi studentët dhe i këshilloi ata të mos ndalin punën dhe hapat drejt suksesit.

"I përgëzoj studentët për këtë angazhim dhe korrektësi, vetëm me punë dhe përkushtim arrihen rezultatet dhe suksesi. Studentët janë ardhmja e këtij vendi, andaj uroj që puna që po bëhet të vlerësohet", tha Xhafaj. Profesori i lëndës "Klinikë Ligjore", Florim Shefqeti u nda shumë i kënaqur me punën e studentëve, teksa potencoi se studentët tani janë të përgatitur të ushtrojnë profesionin për të cilin po studiojnë.

"Tërë ajo çfarë studentët paraqitën sot është puna e bërë gjatë një semestri, e tëra është produkt i tyre. Unë ndjem jashtëzakonisht mirë që shoh një punë të suksesshme, dhe para së gjithash, vullnet tek studentët për atë çfarë po studiojnë", theksoi ai.

Studentët e Fakultetit Juridik edhe më herët kanë realizuar seanca të tilla simulimi, me ç'rast ofruan zgjidhje e ndanë drejtësi për konteste të ndryshme gjyqësore.



Studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT

Studentët e Arkitekturës realizojnë mbi 100 projekte zhvillimore për vendlindjet e tyre



Me qëllim për të ndihmuar zhvillimin urbanistik në vendet prej nga vijnë dhe për të krijuar ambiente të bukura e inovative, studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, kanë realizuar mbi 100 projekte zhvillimore me peizazhe urbane dhe gjelbërim.

Këto punime studentët i kanë zhvilluar nën mentorimin e profesorit Nexhat Balaj, në kuadër të lëndës Menaxhimi i Mjedisit dhe Peizazhit.

Në projektimin e këtyre planeve zhvillimore, arkitektët e rinj përdorën elemente të arkitekturës bashkëkohore, si dhe kanë aplikuar metoda inovative për vendet si: Ulqini, Presheva, Tetova dhe qytete të Kosovës.

Studentët janë shprehur se në këtë mënyrë mund të kontribuojnë për vendlindjet e tyre, duke ideuar ambiente kreative me arkitekturë bashkëkohore. Sipas tyre, meritë të veçantë kanë edhe ligjëruesit në UBT, pasi, siç thanë, po ju ndihmojnë në aspektin praktik dhe në përfitimin e njohurive adekuate në këtë fushë.

Studentët e Arkitekturës realizojnë projekt ideor për parkun e Gjakovës

Studentët e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Elsa Kameri, Elira Hadergjonaj dhe Arlind Bakija, kanë realizuar një projekt ideor për komunën e Gjakovës, konkretisht kanë dizajnuar parkun e këtij qyteti.

Ky projekt është punuar në bashkëpunim me profesorin e UBT-së, Nexhat Balaj, ndërkaq qëllimi kryesor i këtij projekti, sipas studentëve, është rigjallërimi i parkut dhe mbrojtja e mjedisit në këtë komunë.

Karakteristikë kryesore e këtij plani zhvillimor është numri i madh i bimëve që studentët kanë vendosur të përdorin, bimë të cilat vlerësohet ti mbijetojnë çdo sezoni në këtë hapësirë bashkëkohore.

Projekti për parkun e Gjakovës është punuar nga studentët në kuadër të detyrave semestrare, të cilët në punimet e tyre paraqitën plane që për veçori kanë peizazhin dhe gjelbërimin urban.



Studiot e Dizajnit të Integruar, ambiente që zhvillojnë kreativitetin, hulumtimin dhe dizajnimin

UBT njihet në të gjithë rajonin si një qendër e përsosmërisë arsimore, një vend ku një brez i ri i dizajnerëve të ardhshëm po fillon karrierën e tyre, e kjo arrihet duke vënë studentët në qendër të praktikës sonë të të mësuarit "Kudo, në çdo kohë".

Studiot e këtij programi janë të pajisur me të gjitha mjetet dhe pajisjet që ju duhen studentëve të të gjitha specializimeve, përfshirë dizajnin e tekstilit dhe modës, dizajn grafik dhe të komunikimit, dizajnin e produkteve, si dhe atë të ndërtesave dhe mobilimit.

Në mënyrë që studentët të përfitojnë maksimalisht nga këndvështrimi unik që marrin ndaj industrisë dhe ndaj kontekstit të saj historik, nëpër laboratorët e Dizajnit të Integruar dhe nga profesorët që udhëheqin praktikën, praktikohet një qasje e personalizuar dhe shumë fleksibile për dobëni e studentëve të secilit specializim.

Si rrjedhojë, studentëve u ofrohen objekte të specializuara, pajisje,

mjete dhe burime nëpër studiot e punës, që gjenden në kampusin kryesor të UBT-së, në Lipjan.

Sa i përket studios së modës, ajo është e pajisur me katër makina profesionale qepëse, një overlock industrial me 4 fije, hekur industrial, tavolinë me vakum, si dhe një staf teknik të mrekullueshëm që i mëson studentët se si të përdorin makinat në fjalë në mënyrë të sigurt dhe profesionale; por edhe që të bëhen mjeshtrë në punë dore.

Objektet e UBT dhe kurrikula e përpiluar nga profesorët, janë dizajnuar për të përgatitur studentët tanë për një karrierë në secilin specializim.

Nëse ata janë të interesuar në karrierë të dizajnit ose edhe fillimin e biznesit të tyre, ambienti i mësim, si dhe atmosfera në studio, krijon një kulturë që mbështet kureshtjen, hulumtimin dhe dizajnimin.

Nivelet bachelor e master të Fakultetit të Ndërtimtarisë, të akredituara dhe të vlerësuara për cilësi

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit në UBT, është program i akredituar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim, ku është një ndër fakultetet më të suksesshme në rajon në përgatitjen e inxhinierëve të ardhshëm.

Ky fakultet ka një numër të madh të studentëve, megjithatë qindra të tjerë kanë vendosur të jenë pjesë e suksesit të garantuar duke ju bashkuar UBT-së, si rezultat i cilësisë dhe mundësive të shumta që i ofron institucioni.

Ata vendosën t'i transferojnë studimet nga kolegjet dhe universitetet tjera, pasi UBT ofron infrastrukturë dhe laboratorët me pajisje të teknologjisë së fundit, siç është Laboratori për Testimin e Materialeve.

Fakulteti Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastrukturë mbështetet në praktika të avancuara studimi, teksa në këtë program ligjërojnë profesorë në specializimet më unike në vend dhe rajon, specializimet në Menaxhim dhe Teknologji

Ndërtimore, Struktura, Infrastrukturë, Gjeomekanikë, Hidroteknikë e Materialeve, duke ndërlikur pjesën teorike dhe atë praktike.

Në këtë mënyrë, UBT që nga themelimi i këtij fakulteti ka nxjerrë kuadro dhe vazhdon të përmbush edhe kërkesat e tregut të punës në sektorin e ndërtimit në Kosovë, ku në bazë të statistikave të fundit rreth 95% e studentëve janë të kyçur në tregun vendor, ndërkaq qindra të tjerë janë pjesë e tregut ndërkombëtar të punës. Në mënyrë profesionale ata po japin kontribut dhe po zhvillojnë projekte të të gjitha llojeve të objekteve ndërtimore.

Të gjithë studentët që dëshirojnë dhe synojnë të transferohen në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit në UBT, këtë mund ta bëjnë deri më 28 shkurt, fillimisht duke plotësuar formularin për aplikim. Aplikimi bëhet në zyrën e administratës në UBT, ndërkaq nuk kërkohet leje paraprake nga kolegji ku ata kanë studiuar.

Rektori Hajrizi priti në takim Këshillin e Studentëve – Diskutuan për të arriturat dhe sfidat e ardhshme

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi ka pritur në takim Këshillin e Studentëve, me ç'rast së bashku diskutuan për arritjet e semestrit të kaluar, kërkesat dhe nevojat e studentëve të të gjitha fakulteteve. Ky takim pati si qëllim kryesor gjetjen e mënyrave për përmirësimin dhe avancimin e mëtejshëm të studentëve në fushat e ndryshme.

Në fjalimin e mbajtur për studentët, rektori, prof. dr. Edmond Hajrizi tha se UBT është duke punuar vazhdimisht që t'ju ofrojë studentëve kushte edhe më

të përshtatshme për mësim dhe hapësira që do të jenë tërësisht në dispozicion të tyre.

“Krahas kampuseve, laboratorëve dhe hapësirave të tjera për studim, UBT është në ndërtim e sipër të objektit të ri në Lipjan, i cili do të jetë 27 mijë metra katrorë, në të cilin do të ofrohen kushte më të mira dhe laboratorët më të sofistikuar për praktikë”, tregoi ai.

Drejtori për Çështje Akademike, prof. dr. Muhamet Ahmeti, i cili theksoi se ky takim është organizuar për të diskutuar për semestrin veror,

në mënyrë që studentët të japin sugjerimet e tyre dhe të jenë pjesë e vendimmarrjes.

“Ne do të mundohemi që orarin dhe kushtet që i ofron UBT, t'i përshtatim me nevojat tuaja, prandaj edhe në këtë semestër jemi shumë të interesuar që studentët tanë të jenë pjesë e vendimmarrjes”, konstatoi ai.

Studentët pjesëmarrës në mbledhje, që përfaqësuan të gjitha fakultetet ekzistuese në UBT paraqitën të arriturat, sfidat me të cilat janë përballur, si dhe kërkesat e tyre për semestrin veror.



Studenti Lirim Mula zgjidhet kryetar i Këshillit Studentor në UBT



Me qëllim të përfaqësimit sa më të mirë të studentëve, organizimin e projekteve të ndryshme studentore dhe jo vetëm, sot në UBT janë mbajtur zgjedhjet për përzgjedhjen e përfaqësuesve të studentëve në udhëheqje dhe vendimmarrje në UBT.

Procesi është realizuar nën monitorimin e drejtorit për Çështje Akademike në UBT, Muhamet Ahmeti dhe sekretarit të UBT-së, Artan Tahiri, të cilën potencuan se

procesi ishte transparent dhe kandidatët u zgjodhën nga kryetarët e grupeve të të gjitha fakulteteve.

Me këtë rast, me shumicë të votave, studenti i Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Infrastrukturës, Lirim Mula është zgjedhur kryetar i Këshillit Studentor në UBT, Gentian Bibaj u zgjodh nënkryetar, Shkelqim Musiqi është zgjedhur sekretar, Elirjeta Beka u zgjodh përfaqësuese e studentëve në Komisionin e Ankesave,

Gerte Berisha u zgjodh përfaqësuese e studentëve në Komisionin për Cilësi në UBT, Blert Podvorica u zgjodh përfaqësues në Komisionin Disiplinor, ndërkaq Saranda Krasniqi u zgjodh përfaqësuese e studentëve në Këshillin Akademik të UBT-së.

Kryetari dhe përfaqësuesit do të kenë mandatin 1 vjeçar, të cilët përgjatë këtyre muajve ata do të marrin pjesë në aktivitetet e ndryshme.

Biblioteka e UBT-së, e pasuruar me 250 mijë libra dhe mbi 52 mijë tituj

UBT i ka kushtuar rëndësi të madhe krijimit të një hapësire, e cila i ndihmon stafin dhe studentët që të gjejnë në një vend të vetëm të gjithë titujt për të cilët kanë nevojë, dhe atë, në bibliotekën brenda Kampusit Inovativ të UBT-së, në Lipjan.

Duke pasur parasysh fushat e larmishme të studimit në UBT, biblioteka fizike është pasuruar me rreth 250 mijë libra të ndryshëm dhe me mbi 52 mijë tituj. Përveç bibliotekave në Prishtinë, Lipjan dhe në Ferizaj, UBT ofron qasje të pakufizuar edhe

në bibliotekat elektronike. Deri tani, UBT është e anëtarësuar në tri biblioteka të njohura elektronike, përfshirë EBSCO-n, SAGE Journals dhe J-Store.

UBT furnizohet me libra të rinj një herë në vit, ku në secilin vit bibliotekës i shtohen rreth 15 mijë-20 mijë tituj. Gjatë dy viteve të fundit është sjellë pjesa më e madhe e librave, kur edhe janë shtuar shumë tituj të kërkuar nga stafi dhe studentët.

Biblioteka ka edhe ambientin komod për lexim, me një hapësirë prej 240 m², që u mundëson stu-

dentëve lexim të qetë.

Studentët e institucionit kanë mundësi të pajisen me libra nga të gjitha drejtimet të cilat UBT i ofron, por edhe me enciklopedi dhe fjalorë të ndryshëm. Shumica e librave në bibliotekën e UBT-së janë në gjuhën shqipe, angleze, një përqindje e vogël në gjuhën gjermane dhe në atë serbe.

Vetëm në dy vitet e fundit, UBT ka shtuar deri në 60 mijë tituj të ndryshëm, si dhe ka krijuar qasje të drejtpërdrejtë në e-libra dhe artikuj shkencorë e akademikë.



Studentët e UBT-së morën pjesë në garën më të madhe të fakulteteve të drejtësisë në botë, Willem C. Vis Moot Court



Studentët e Fakultetit Juridik, në UBT, morën pjesë në Garën Ndërkombëtare të Arbitrazhit, “Willem C. Vis Moot Court”, e cila po mbahet në Vjenë të Austrisë.

Studentët përfaqësuan UBT-në në këtë garë prestigjioze janë: Zana Sopjani, Qëndresa Beka, Pylljon Nura, Merisa Abdullahu, Valentin Qarrolli, Erza Alishani dhe Drilona Grajcevc.

Para garës në Vjenë, studentët e

Fakultetit Juridik ishin pjesëmarrës në Vis Pre Moot, që u mbajt në Lubjanë të Sllovenisë, më 8-12 prill, në të cilën morën pjesë studentët të universiteteve më të njohura në Evropë.

Gara “Willem C. Vis Moot Court” ka filluar me 12 prill, në Vjenë të Austrisë, dhe gjatë saj, studentët e UBT-së po përballen me universitete prestigjioze nga mbarë bota.

Gjatë Garës Ndërkombëtare të

Arbitrazhit, ekipe nga 400 universitete nga e gjithë bota po konkurrojnë kundër njëri-tjetrit në një seri të seancave dëgjimore, të cilat përcillen nga arbitër të cilët janë juristë dhe pjesëmarrës të edicioneve të kaluara të garës së arbitrazhit. Përveç kësaj, kjo Garë Ndërkombëtare e Arbitrazhit lehtëson një shkëmbim ndërkulturor mes studentëve të drejtësisë nga të gjitha vendet e botës.

Vetëm gjatë semestrit të fundit

Katërbëdhjetë studentë të Fakultetit Media dhe Komunikim janë sistemuar në tregun e punës

UBT deri tani ka nxjerr në tregun e punës gjashtë gjenerata studentësh në Fakultetin e Medias dhe Komunikimit, shumica prej të cilëve tashmë janë sistemuar në tregun e punës.

E vetëm gjatë semestrit të fundit, 14 studentë që janë punësuar e po përfundojnë punë praktike nëpër media të ndryshme vendore.

Këta studentë, nëpër vendet e tyre të punës e të praktikës, po i shpalosin njohuritë dhe kompetencat e tyre si gazetarë, fotografë, kameramanë, montazherë, zyrtarë për informim dhe zyrtarë të PR-it.

I tërë ky sukses i studentëve të Fakultetit Media dhe Komunikim vjen si rezultat i punës intensive praktike, që është kryer gjatë viteve të studimit në UBT, si dhe falë pasionit të vetë studentëve për profesionin që kanë zgjedhur.

Po të njëjtin sukses në tregun e punës e kanë pasur edhe studentët e gjeneratave të mëhershme të këtij fakulteti, shumica prej të cilëve tashmë kanë siguruar vende stabile pune.



Plisi, koncept i formës së punimeve të prezantuara në ekspozitën e Dizajnit të Integruar



Dhjetëra punime unike artistike janë prezantuar në ekspozitën njëditore të studentëve të vitit të parë të Dizajnit të Integruar, realizimi i të cilave është mbështetur kryesisht në motive kombëtare.

Ekspozita do të qëndrojë e hapur gjatë ditës së sotme në kampusin e UBT-së në Lipjan, Prizren dhe Ferizaj.

Gjatë procesit të realizimit, studentët mësuhan se si të bëjnë shfrytëzimin e materialeve, kryerjen e hulumtimeve, shfrytëzimin e hapësirës dhe bashkëpunimin mes studentëve.

Veçantia e ekspozitës qëndron tek fakti se si koncept i formës është shfrytëzuar plisi, teksa prej tij kanë pasur ide tejet të veçanta të studentëve, që bashkëdyzuan historinë e lashtë shqiptare, por njëkohësisht duke shfrytëzuar plisin edhe si motiv për realizim të veprave moderne.

Ekspozita është realizuar në kuadër të lëndës "Materialet e dizajnit", nën udhëheqjen e ligjëruesit në UBT, Gazmend Ejupi, teksa kuratorë kanë qenë studentët e Dizajnit të Integruar.

Puna praktike në UBT, indikator i suksesit të studentëve në tregun e punës

UBT ofron studime cilësore për të gjitha fushat e studimit dhe përmes tyre i ofron tregut të rinj të përgatitur dhe të pasionuar pas profesionit të tyre.

Kjo arrihet përmes ciklit të ligjërave e ushtrimeve, të cilat mbahen nga akademikë dhe ekspertë të dëshmuar në tregun e punës.

E tërë teoria zbatohet në laboratorët e UBT-së, të cilët janë të pajisur me të gjitha mjetet dhe aparaturat e nevojshme, që shfrytëzohen nga studentët për jetësim të projekteve. Kjo mënyrë e të mësuarit ndihmon studentët që të

përforcojnë njohuritë e tyre praktike dhe të aftësohen profesionalisht. Praktika e realizuar gjatë viteve të studimeve ndikon që studentët e UBT-së të dalin të përgatitur për tregun e punës, dhe për më tepër, të shndërrohen dhe në njerëzit më të kërkuar në tregun vendor dhe ndërkombëtar të punës.

Bashkërendimi i teorisë dhe praktikës është indikator më i vlefshëm që dëshmon suksesin e studentëve të UBT-së në tregun e punës, si dhe nivelin e lartë të përkushtimit të institucionit ndaj përgatitjes profesionale të studentëve të vet.



Studentët e Infermierisë bëjnë matjen e presionit të gjakut në Ditën Ndërkombëtare të Hipertensionit

Dhjetëra qytetarë të rastit, përfshirë të gjitha moshat, kanë pasur mundësinë të marrin sot këshilla shëndetësore dhe të bëjnë matjen e shtypjes së gjakut nga studentët e Fakultetit të Infermierisë në UBT, në kuadër të aktiviteteve që infermierët e rinj i kanë organizuar për ndër të Ditës Ndërkombëtare të Hipertensionit.

Aktivitetet janë mbajtur në parkun e Gërmisë dhe në Qendrën Kulturore Sociale për të Moshuar, në Prishtinë, në bashkëpunim me Grupin për Edukim dhe Promovim Shëndetësor në UBT, si dhe Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, me ç'rast janë shpërndarë edhe fletëpalosje me përmbajtje sensibi-

lizimi dhe informimit.

Po ashtu, ekipi e përbërë nga profesorë dhe studentë të Fakultetit të Infermierisë në UBT, ofruan edhe shërbime të matjes së glikemisë, peshës, si dhe parametrat e saturimit dhe pulsit. Ata dhanë edhe informacione të detajuara mbi rëndësinë e një ushqyerje korrekte, për aktivitete fizike dhe mbajtjes së kontakteve të rregullta me mjekun e familjes.

Këto aktivitete kishin për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për shkaqet dhe pasojat e presionit të lartë të gjakut, inkurajimin për të rritur kontrollin dhe për të ndjekur këshillat e profesionistëve të kujdesit shëndetësor.

Fakulteti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT

Studentët dhe profesorët e Shkencave të Ushqimit realizojnë hulumtim shkencor

Studentët e vitit të tretë të Fakultetit Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT, Fjolla Vllasaliu dhe Arditi Hoti, në bashkëpunim me profesorët Valon Durguti, Fisnik Laha dhe Fidan Feka, kanë realizuar një hulumtim shkencor që ka të bëjë me përcaktimin e elementeve toksike ose siç njihen si metale të rënda tek disa lloje të peshqve.

Në kuadër të këtij hulumtimi është përcaktuar shkalla e rrezikut potencial të intoksikimit të njeriut me metalet përkatëse, kjo për faktin se

ato shfaqin afinitet bioakumulues në inde dhe paraqesin rrezik potencial për shëndetin e njeriut.

Në këtë studim janë analizuar lloje të peshqve si krapë, trofta dhe levreku, teksa janë përdorur metoda krahasuese dhe teknika analitike me anë të së cilave janë përcaktuar metalet e rënda sidomos në aspektin sasior.

Rezultatet e hulumtimit janë tejet interesante dhe pritet të publikohen në njëri prej revistave shkencore ndërkombëtare.



Fakulteti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë organizon panairin e parë të produkteve ushqimore



Produkte të ndryshme të qumështit, drithëra, disa lloje të bukës dhe ëmbëlsirave, fruta, perime, e shumë produkte të tjera, u prezantuan në panairin e parë të industrisë ushqimore, në të cilin janë ekspozuar produkte të përgatitura në laboratorët e UBT-së nga studentët e Fakultetit të Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë.

Studentët ekspozuan shumë produkte para një numri të madh të interesuarish, të cilët pos që provuan ushqimet, morën edhe informacione të dobishme mbi përfitimet që vijnë nga përdorimi i ushqimit organik dhe të shëndetshëm.

I tërë ky aktivitet ka qenë nismë e studentëve dhe profesorëve e asistentëve të fakultetit, Namik Durmishi, Lorikë Salihu, Endra Luzha dhe Mimoza Dragaqina.

Ky panair është i një dimensionimi me ndryshe pasi që të gjitha produktet janë prodhuar në laboratorë me parametra të duhur fiziko-kimikë, si dhe për faktin që të gjithë përbërësit e përdorur ishin produkte vendore.

Këtë panair e vizitoi edhe rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, i cili i përgëzoi studentët dhe profesorët për produktet dhe punën cilësore.

Studentët e Shkencave të Ushqimit vizituan fabrikën për përpunimin e mishit “Calabria” në Gjilan

Studentët e vitit të parë të Fakultetit Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT, kanë realizuar vizitë studimore në fabrikën për përpunimin e mishit “Calabria” në komunën e Gjilanit.

Vizita është realizuar në kuadër të lëndës Hyrje në Shkencat e Ushqimit, nën shoqërimin e profesorëve përkatës.

Ata u pritën nga pronari i fabrikës Xhelal Selimi, i cili u ka shpjeguar studentëve për lëndën e parë në industrinë e mishit, si dhe për prodhimin e produkteve tjera nga mishi.

Ai potencoi se kapaciteti i plotë i prodhimit ditor është therja e mbi 700 krerë gjedhë, teksa sipas tij, produktet e përpunuara janë të cilësisë së lartë. Tutje, ai tha se në të ardhmen do ketë bashkëpunim mes fabrikës dhe UBT-së, në fushat që janë në interes për dyja palët.



Studentët e Shkencave të Ushqimit vizituan fabrikën për përpunimin e mishit “Calabria” në Gjilan



UBT po u ofron kushte shumë të favorshme studentëve të Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë për t'i shndërruar në praktikë teorinë praktikë të fituara gjatë studimeve.

Në laboratorët e sofistikuar të këtij fakulteti në vijimësi po kryhen të gjitha detyrat praktike mbi konceptin e krijimit të ushqimeve të shëndetshme, por edhe të ushqyerit shëndetshëm.

Pas shumë produktesh ushqimore të shëndetshme të përgatitura nëpër laboratorë, së fundmi studentët e vitit të tretë të këtij fakulteti kanë përgatitur dy produkte të reja, fruta të tharë dhe produkt xhelatinoz nga frutat, si pro-


dukt i dalë nga pektina, që nxirret nga frutat dhe përdoret për xhelatizimin e reçelrave të ndryshëm.

Produktet po përgatiten në kuadër të lëndës “Teknologjia e Produkteve me Origjinë Bimore”, me ligjëruesit, Namik Durmishi dhe Lorikë Salihu.

Falë këtyre praktikave, studentët mësuuan që konsumatorëve t’ju ofrojnë produktet e tyre të preferuara në të gjitha stinët e vitit.

Teknologjet e rinj arritën që të prodhojnë një produkt të këndshëm dhe, sipas analizave të studentëve të Nutricionit, me të gjitha vlerat ushqyese të ruajtura.

Fotoreportazh



Zgjedh më të mirin,
që të bëhesh më i miri

Fotoreportazh



UBT
FAKULTETI
SHKENCAT E USHQIMIT

Virtyt Kryeziu:

“Nëse dëshiron të hash, vazhdo të ngjitesh. Frutat janë në maje të pemës. Shtrij duart dhe vazhdo edhe më tutje. Suksesi është në maje, vazhdo”.



UBT
FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE
DHE INXHINIERI

Diar Hyseni:

“Drejtimi që zgjodha më dha mundësinë të fitoj përvojë dhe të pasuroj diapazonin tim të njohurive, e përmes kësaj të zhvillohem përtej pritshmërive që kam pasur”.



UBT
FAKULTETI
SISTEMET E INFORMACIONIT

Liridona Sylja:

“Kam zgjedhur UBT-në, për të realizuar atë çfarë kam ëndërruar”.



UBT
FAKULTETI
ARKITEKTURËS DHE
PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Veton Daka:

“Architecture Program was a dream that I always had and UBT...”



UBT
FAKULTETI I
NDËRTIMTARISË DHE
INFRASTRUKTURËS

Loni Lennart Elezi:

“Shoh që ambiciet e mia janë në relacion të drejtë me mundësitë që m'i ofron UBT dhe pa mëdyshje e zgjodha...”



UBT
FAKULTETI
SISTEMET E INFORMACIONIT

Poema Berisha:

“Nëse do të zgjedhësh mes dy fushave kryesore, si biznesi dhe teknologjia, atëherë zgjedhja më e mirë për studime janë sistemet e informacionit”.

Zgjedh më të mirin,
që të bëhesh më i miri

25 mijë maturantë po përfitojnë këshillime në karrierë nga Qendra e Karrierës në UBT

Qendra e Karrierës në UBT po qëndron afër maturantëve kosovarë tash e disa muaj, me qëllim që t'i këshillojë drejt marrjes së vendimeve të duhura në lidhje me zhvillimin profesional.

Përpos vizitave të shumta që janë bërë nga vetë maturantët nëpër kampuset e UBT-së në mbarë Kosovën, stafi i UBT-së po lëvizë nëpër qytete dhe shkolla të ndryshme, për të ofruar orientim në karrierë për të rinjtë kosovarë, tek të cilët është parë vendosmëri dhe entuziazëm i madh për të filluar studimet në UBT.

Vizita e fundit është bërë në Shkollën e Mesme Elektroteknike, "Gjin Gazulli", në Vushtrri, me ç'rast qindra maturantë të kësaj komune janë njoftuar me mundësitë për shkollim dhe zgjedhje të profesioneve të duhura. Njëkohësisht, ata u njoftuan edhe me mundësitë, hapësirat dhe laboratorët që UBT i ofron për studentët e fushës së elektroteknikës, me qëllim që studentët të bashkërendojnë njohuritë teorike e praktike, si proces jetik për punësim.



Studentët e Arkitekturës analizuan zhvillimin historik të Prizrenit

Studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor kanë realizuar vizitë studimore në objektet historike të Prizrenit, me fokus në ndërtesat historike, si pjesë e pandarë e zhvillimit arkitekturor të këtij qyteti.

Në kuadër të vizitës, krahas njoftimit të sistemit strukturor, stilistik dhe ndikimit të ndërtesave në formimin urban të qytetit, studentët patën mundësi të mar-

rin informata shtesë edhe nga predikuesit fetarë mbi historikun e zhvillimit dhe ruajtjes së objekteve.

Studentët vizituan kishën katolike "Zonja Ndhimëtare", Kishën e Shën Gjergjit, Kishën Ortodokse, xhaminë e Sinan Pashës në Prizren, Hamamin e Gazi Mehmet Pashës dhe Muzeun Arkeologjik.

Studentët e Arkitekturës vizitojnë Fabrikën e Bukës, në Ferizaj

Në kuadër të lëndës "Studio Dizajn 3", studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, realizuan vizitë studimore në Fabrikën e Bukës, që ndodhet në qytetin e Ferizajt.

Vizita u bë nën shoqërimin e profesorit të lëndës, Kujtim Elezi, i cili theksoi se vizita në një fabrikë të kësaj natyre është e një rëndësie të veçantë.

Studentët u njoftuan me të gjitha detajet e njësive funksionale të fabrikës, përfshirë aspektin organizativ, procesin e prodhimit dhe afatizimet kohore për

procesin e punës. Po ashtu, patën rastin të vizitojnë pjesën e sillosit të drithërave dhe miellit, ku e panë nga afër procesin e prodhimit dhe funksionalizimin e kësaj fabrike.

Fakulteti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, vazhdimisht po organizon vizita të karakterit studimor, me qëllim të ndërlidhjes së teorisë dhe praktikës, si dhe me qëllim që studentët të përfitojnë njohuri e përvoja profesionale.

Studentët e Arkitekturës marrin informacione mbi përpunimin e metaleve në fabrikën "ZINKUNIE"

Studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor kanë realizuar vizitë studimore në fabrikën "ZINKUNIE", në Prizren, në të cilën morën informacione mbi procesin e përpunimit të metaleve. Vizita është realizuar në kuadër të lëndës "Studio Dizajn 3".

Studentët, krahas njoftimit të parimeve të dizajnit për sipërfaqe ekonomike-industriale, u njoftuan dhe me mënyrën e prodhimit të detaleve të përcak-

tuara nga arkitektët. Ndërkaq, përfaqësuesit e kësaj fabrike shprehën gatishmëri të plotë edhe për fillim të bashkëpunimit me UBT-në.

ZINKUNIE është fabrikë që merret me përpunimin e bakrit, zinkut dhe elementeve tjera të metalit. Kompania në fillim ka pasur bazën në Holandë, kurse tani funksionon e pavarur, me produkte të destinuar për Evropë dhe Azi.

Udhëheqësit e Skenderajt dhe arkitektët vendorë, të impresionuar me projekt-propozimet urbanistike të studentëve të UBT-së

Studentët e vitit të tretë të Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor kanë prezantuar projektet e tyre ideore urbanistike për Komunën e Skenderajt, të cilat kanë qenë punë e një semestri të tërë, e kryer nën mentorimin e ligjëruesit në UBT, dr. Binak Beqaj dhe asistentit, Modest Gashi.

Konceptet dhe idetë e studentëve për një zonë urbane të caktuar nga komuna, i dëgjuan kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, përfaqësues të Drejtorisë së Urbanizmit nga kjo komunë, si dhe ekspertë dhe arkitektë vendorë, të cilët e vlerësuan lartë punën e kryer nga studentët.

Studentët e Arkitekturës, të ndarë në pesë grupe, përgatitën pesë projekt-propozime urbanistike, të cilat, sipas arkitektëve të pranishëm që e vlerësuan punën e studentëve, i kanë tejkaluar pritshmëritë e tyre me nivelin e lartë të realizimit profesional dhe guximin për të sjellë ndryshime.

Kryetari i Komunës së Skenderajt, duke i përgëzuar studentët për kreativitetin dhe angazhimin për ta bërë Skenderajtnë një qytet më të kompletuar në aspektin urban, tha se do të bëjë të pamundurën që këto projekte t'i jetësojë.

Profesori i lëndës "Planifikimi Urban", dr. Binak Beqaj tregoi se e gjithë puna e studentëve është bërë në baza vullnetare, teksa, sipas tij, puna e tillë është tejet e rëndësishme pasi që paraqet simbolikën e ndërlidhjes ndërmjet akademisë dhe institucioneve.

Studentët e Arkitekturës në UBT, tash e disa vite janë duke realizuar projekt-propozime për komuna të ndryshme të Kosovës dhe shumë prej tyre edhe janë realizuar.

Aktivitete të studentëve

Studentët e Sistemeve të Informacionit vizitojnë kompaninë “Katrori ICT”

Në shoqërimin e profesorit Blerton Abazi, studentët e Fakultetit Sistemet e Informacionit në UBT, kanë vizituar kompaninë e zhvillimit softuerik “Katrori ICT”, që njëherësh merret edhe me implementimin e teknologjive për biznes. Vizita është realizuar në kuadër të lëndës Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit, ku janë njoftuar nga afër me sistemet CRM, ERP, implementimin e sistemeve dhe me proceset e biznesit.

Me këtë rast drejtori operacional i kësaj kompanisë, Fatos Fondaj, i njoftoi studentët me aktivitet që i zhvillojnë, sfidat me të cilat ballafaqohen gjatë punës. Studentët shfaqën interesimin e tyre dhe zhvilluan bashkëbisedim për aspekte teknike dhe biznesore të ndërlidhura me formën e zhvillimit të sistemeve, procesin e rekrutimit etj.

Fakulteti i Sistemeve të Informacionit në UBT, është program që u mundëson studentëve të fitojnë njohuri për aspekte të rëndësishme të sistemeve të informacionit, për dizajnin, organizimin dhe menaxhimin e sistemeve të informacionit.



Studentët e Infermierisë apelojnë qytetarët që të mos konsumojnë duhan

Pirja duhanit shkakton sëmundjen e mushkërive dhe llojet e ndryshme të kancerit, por pavarësisht këtyre fakteve në Kosovë vazhdon të jetë i lartë numri i atyre që e konsumojnë duhanin.

Duke qenë kështu, me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit kundër prijës së duhanit, studentët e Fakultetit të Infermierisë në UBT, zhvilluan aktivitete simbolike në sheshet kryesore të qytetit të Prishtinës.

Kalimtarët e rastit u apeluar nga studentët e UBT-së për lënien e duhanit, teksa simbolikisht atyre u është ofruar nga një mollë me moton jeto shëndetshëm.

Po ashtu, studentët nën shoqërimin e profesorëve kanë shpërndarë edhe fletëpalosje me përmbajtje informimi dhe sensibilizimi.

Aktivitetet janë realizuar për nder të Ditës Ndërkombëtare të Duhanit, mbështetur nga grupi për Edukim dhe Promovim Shëndetësor në UBT.

Dita Botërore kundër Duhanit është shpallur si ditë nga vendet anëtare të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, ku në vitin 1987, këto vende, u përpoqën të sensibilizojnë opinionin mbi dëmet dhe rreziqet e duhanit dhe të inkurajojnë reduktimin e prodhimit dhe konsumit të duhanit.

Studentët e Juridikut vizituan Autoritetin Kosovar të Konkurrencës

Studentët e Fakultetit të Juridikut vizituan Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, me çrast u pritën nga deputeti Korab Sejdiu, njëherësh edhe profesor në UBT, si dhe nga kryetari i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, Valon Prestreshi.

Gjatë kësaj vizite, studentët u njoftuan nga afër me punën e autoritetit, me kornizën ligjore që e rregullon këtë fushë, me fushëveprimtarinë, me bashkëpunimet ndërkombëtare, si dhe me procedurat e trajtimit të lëndëve nga ana e

Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Ata u treguan studentëve për sfidat e Autoritetit, teksa folën edhe për shtyllat kryesore të konkurrencës, marrëveshjet e ndaluara, abuzimin me pozitën dominuese dhe për përqendrimet dhe bashkimet e ndërmarrjeve.

Në fund të vizitës, studentët kishin mundësi që të parashitnin pyetjet e tyre mbi çështjen se si funksionon Autoriteti Kosovar i Konkurrencës.

Studentët e Infermierisë shënojnë Ditën Ndërkombëtare të Hipertensionit në shumë qytete të Kosovës

Hipertensioni i pakontrolluar është i përhapur, paraqet simptoma dhe përbën një faktor të rrezikut për sëmundje të ndryshme. Duke qenë kështu, me qëllim të ndërgjegjësimit të njerëzve, për nder të Ditës Ndërkombëtare të Hipertensionit, studentët e Fakultetit të Infermierisë në UBT organizuan aktivitete simbolike në qytetin e Prishtinës, Gjilanit, Ferizajt, Prizrenit, Pejës.

Aktivitetet janë mbajtur në sheshet kryesore të qyteteve, ku kalimtarët e rastit

patën mundësinë të marrin këshilla shëndetësore dhe shërbime falas, si matja e shtypjes së gjakut. Po ashtu, studentët kanë shpërndarë edhe fletëpalosje me përmbajtje informimi dhe sensibilizimi.

Këto aktivitete janë mbështetur nga grupi për Edukim dhe Promovim Shëndetësor në UBT, nga të cilat përfituan qindra qytetarë të moshave të ndryshme.

UBT përkrahu garën “Innovation And Problem Solving”, të Ambasadës së Finlandës në Kosovë

“Doodling at Pjeter Bogdani” i nxënësve të po kësaj shkolle, është projekti fitues i garës “Innovation and Problem Solving”, të organizuar nga Ambasada e Finlandës në Kosovë, përkrahur edhe nga UBT.

Ekipi fitues është një grup i të rinjve entuziastë, të cilët duan që, duke zbuluar muret me dizajne të ndryshme, shkollën e tyre ta shndërrojnë në një ambient më të këndshëm për të gjithë nxënësit.

“Doodling at Pjeter Bogdani”, bashkë me me katër projektet e tjera të të rinjve kosovarë, “Solving the landfill problem in Kosovo by building a waste-to-energy plant”, “Better Me – Mental Health Application”, “Proposal for Traffic Lights in

Peja” dhe “Vertical Gardens”, u vlerësuan nga një juri profesionale, pjesë e të cilës ishte rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi.

Rektori Hajrizi u shpreh i lumtur që tek të rinjtë kosovarë po zhvillohet çdoherë e më shumë fryma e inovacionit dhe e sjelljes së gjërave të reja, teksa i vlerësoi edhe projektet pjesëmarrëse në këtë garë, duke i këshilluar të rinjtë që të punojnë edhe më shumë në konkretizimin e ideve të tyre.

UBT është vazhdimisht përkrahë institucioneve vendore e ndërkombëtare, për të nxitur zhvillimin e inovacionit në vendin tonë, por edhe për t’i përkrahur drejtpërdrejt të rinjtë entuziastë në projektet e tyre.

Rrëfime Suksesi

Studenti kosovar, Emin Emini ndërton dhe programon pasqyrën e mençur

Në Pjetërshat të Gjakovës ka filluar ndërtimi i Qendrës për edukim joformal për të rinjtë, si dhe qendër rekreative për fëmijë "Regreeneration", projekt i cili është hartuar dhe projektuar nga ish-studentja e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, Jeta Bejtullahu, e cila tash e pesë vite ka themeluar studion e saj projektuese "FormaDDM".

Në këtë projekt kapital të ndihmuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ish-studentja ka qenë arkitektja kryesore ku ka zhvilluar konceptin përmes tri komponentëve: ambienti, komuniteti i të rinjve dhe aktivitetet rekreative.

Bejtullahu ka thënë se ka projektuar një hapësirë multifunktionale që ofron kushte të mira për zhvillimin e aktiviteteve të të rinjve dhe edukimin e tyre të mëtejme.

"Projekti është hartuar duke u bazuar në bashkëveprimin e mjedisit natyror, ku përfshinë sipërfaqe të hapur për aktivitete rekreative në natyrë dhe sipërfaqe gjelbëruese, të tilla si: fushë sporti mikse, fushë volejboli në rërë,

mini-golf, shtigje për ecje dhe për vrapim, trajnim për gjuajtje me shigjeta, hapësirë për kamping, amfiteatër i hapur, mur për ngjitje, hortikulturë (bletari, shtëpi të gjelbërta, kopshtari) dhe mjedisit të ndërtuar, i cili përfshinë edhe 3 pavijone të fjetjes (akomodim)", ka treguar Bejtullahu.


Kjo qendër do të shndërrohet në një kamp i modelit amerikan, teksa karakterizohet me hapësira të veçanta për organizimin e trajnimeve të ndryshme me qëllim të aftësisimit të rinisë në ndërmarrësi, inovacion, sport etj.

Gjatë studimeve në UBT, Jeta Bejtullahu ka qenë përfituese e disa bursave nga programi i mobilitetit CEEPUS në Universitetin Teknik në Ceki, në Universitetin Politeknik të Shubenikut, në Kroaci, si dhe në Universitetin Teknik të Krakovës, në Poloni.

Në vitin 2017, së bashku me Ilirjana Haxhij morën çmimin laureate nga "Future Architecture Platform" me projektin "Redevelopment of social housing infrastructure in Gjakova", ku u renditën në pozitën e katërt nga dhjetë projektet më të mira.



Studenti Uvejs Sermaxhaj i angazhuar në departamentin e Shkollave Profesionale në UBT



UBT është një ndër institucionet e vetme arsimore në Kosovë, ku vazhdimisht i ka përkrahur studentët e vet, njëherësh u ka ofruar edhe mundësinë që ata të angazhohen përbrenda institucionit dhe të punojnë përkrahë ekspertëve të fushave përkatëse. Këtë mundësi e ka fituar edhe student i Fakultetit Menaxhmet, Biznes dhe Ekonomi në UBT, Uvejs Sermaxhaj. Ai aktualisht vijon studimet në vitin e tretë, por njëherësh është i angazhuar në departamentin e Shkollave Profesionale në UBT.

Sermaxhaj potencoi se po përfiton përvojë në aspektin profesional, si dhe tregoi se ndjehet shumë i lumtur që është bërë pjesë e UBT-së.

"Gjatë tre viteve të studimit në UBT kam parë se çfarë pune e mrekullueshme bëhet në këtë institucion dhe sigurisht që dëshiroja të jap edhe unë kontributin tim. Kjo u bë e mundur falë stafit akademik të cilët na kanë përgatitur të ngritemi profesionalisht dhe të bëhemi të gatshëm për tregun e punës. Me të vërtetë ndihem krenar që jam pjesë e UBT", theksoi Sermaxhaj.

Duke folur për të ardhmen, ai tha se planifikon t'i vazhdojë edhe studimet e nivelit master në UBT, kjo me qëllim të përfitimit të njohurive tjera teorike.

Studentët e Infermierisë po mbajnë praktikën në QKMF-të e Prishtinës

Studentët e vitit të parë të Fakultetit të Infermierisë në UBT, kanë filluar ta mbajnë praktikën profesionale në Qendrat e Mjekësisë Familjare në Prishtinë.

Praktika do të zgjasë deri në fund të semestrit veror, teksa studentët do të përfitojnë njohuri teorike dhe do të fitojnë shkathtësi praktike në shërbimet e mjekësisë primare.

Praktika në fjalë po zhvillohet si rezultat i marrëveshjeve të bashkëpunimit që UBT ka nënshkruar me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, si dhe në komunat tjera të Kosovës.



Studenti i UBT-së, mësimdhënës në Gjimnazin "Zenel Hajdini", në Gjiilan



Studenti i nivelit master në Fakultetin e Shkencave kompjuterike dhe Inxhinierisë, Armir Bejtullahu po i shfrytëzon njohuritë dhe shkathtësitë e fituara gjatë studimeve në UBT, për t'i përçarur të njëjtat tek gjeneratat e reja.

Ai tashmë është angazhuar si mësimdhënës i Teknologjisë Informative në Gjimnazin e Shkencave Shoqërore, "Zenel Hajdini", në Gjiilan.

Pos kësaj, që nga viti i kaluar ai është edhe anëtar i Bordit të Drejtorëve në ndërmarrjen publike lokale, "TREGU" sh.a.

Armiri thotë se të gjitha këto suksese i ka arritur me shumë punë dhe përkushtim për profesionin e tij.

"Me punë dhe përkushtim për studimet, dhe gjithashtu, puna me profesorë të njohur dhe të suksesshëm të fushave përkatëse, kam arritur të kem rezultate të mëdha në studime, dhe gjithashtu, t'i përmbyllë ato në afat të rregullt kohor, por edhe të sistemohem në tregun e punës", theksoi ai.

Rrëfime sukcesi

Ish-studentja e UBT-së, shkencëtarja dhe asistentja e parë kosovare në Universitetin e Belgjikës

Ferdiana Hoti është 23 vjeçare nga qyteti i Gjilanit, një shkencëtare që premtion shumë dhe një shembull sukcesi dhe inkurajimi për të rinjtë kosovarë.

E lidhur fort me punën dhe profesionin, ajo po kontribuon në mënyrën më të mirë për shoqërinë dhe promovon Kosovën kudo në botë përmes arritjeve dhe hulumtimeve të saj shkencore.

Ajo kishte pasion shkencat shoqërore, për çka vendosi që rrugëtimin e saj akademik ta fillojë në Fakultetin e Shkencave Politike në UBT. Më pas aplikoi në programin Erasmusë, ku fitoi bursë njëvjeçare për të vazhduar studimet në Universitetin e Salzburgut, në Austri.

Pas diplomimit, ajo filloi studimet master në Universitetin e Antwerpenit në Belgjikë, ku përveç studimeve, falë njohurive dhe eksperiencave të marra, Ferdiana ka arritur të bëhet edhe asistentja e parë kosovare në po të njëjtin universitet.

“Gjithmonë do kemi raste dështimesh, mirëpo në vend që t’i përdorim këto dështime si mur për të izoluar veten, duhet t’i përdorim si shkallë drejt arritjes së qëllimit tonë. Rrethojeni veten me njerëz që ju shtyjnë përpara dhe që besojnë në aftësitë tuaja. Asnjë vizion nuk është i paarritshëm dhe limitet e vetme që ekzistojnë janë ato që ju ia vendosni vetes”, i këshilloi ajo të rinjtë kosovarë. Aktualisht, Ferdiana është studente e doktoraturës në Akademinë më të madhe shkencore në Evropë, “SCK-CEN”, ku është duke doktoruar për mënyrat e komunikimit të pasigurive që janë pranishme në situatat me rreziqe radiologjike. Teksa, është duke hulumtuar tema që lidhen me mënyrën se si mund të integrohen shkencat shoqërore dhe interesat e publikut në çdo disiplinë, në bashkëpunim në Institutin Shkencor për Energji Nukleare.

Përveç këtyre angazhimeve, ajo udhëton dhe merr pjesë në konferenca të shumta shkencore, ku së fundmi prezantoi hulumtimin e saj në Universitetin e Oxfordit, në Angli. Ndërkohë, me qëllim të përkrahjes së grave në shkencë, Ferdiana është duke organizuar një konferencë në Barcelonë, që ka për qëllim krijimin e hapësirës për prezantimin e rezultateve shkencore të shkencëtareve të reja.



Studentja e UBT-së, arkitekte në Zvicër



Janë të shumtë studentët e UBT-së, të cilët kanë kaluar kufijtë kombëtarë dhe ekspertizën e profesionalizmin e tyre tashmë po e dërgojnë nëpër kompani të ndryshme ndërkombëtare.

Një e tillë është Edona Klaiqi, e cila ka përfunduar studimet bachelor e master në UBT, porse momentalisht veprimtarinë e saj profesionale e ka përqendruar në Zvicër, ku është duke punuar në kompaninë “Aziriarchitekten”, me seli në qytetin e Baselit. Ajo është arkitekte përgjegjëse për përfundimin e projekteve ideore kryesore, zbatuese, enterier dizajne, urbanistike, si dhe të gjitha llojet e projekteve që i përkasin kërkesave të kompanisë për të cilën ajo punon.

Edona thotë se studimet e kryera në UBT i kanë ndihmuar në përmbushjen e synimeve për ngritje në karrierë, që është dëshmuar edhe me punësim.

“Për mua, zgjedhja e UBT-së ka qene një ndër zgjedhjet më të mira që kam bërë në jetë, duke marrë parasysh kuadrin e profesorëve, mënyrën e studimit, aftësinë dhe vetëbesimin që e fiton secili student gjatë studimeve, duke e ndjerë veten të lirë për të shprehur opinionet”, vlerësoi ajo.

Edona është kyçur në tregun e punës qysh para gjashtë vitesh, sa ishte në studime të nivelit bachelor, teksa ka punuar për kompani të ndryshme vendore.

Studenti i Arkitekturës, Mergim Kukaj, i punësuar në kompaninë “Al Trade”

Mergim Kukaj ka studiuar në Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, në UBT, dhe tashmë është punësuar në kompaninë e ndërtimit dhe tregtisë me materiale ndërtimore, “Al Trade”, në Prishtinë.

Përveç që mban pozitën e arkitektit, studenti Kukaj mbikëqyrë objekte të ndryshme dhe menaxhon projekte e plane të shumta banesore.

“UBT më ka ofruar mundësi të shumta, sidomos praktikën që e kemi mbajtur në vitin e fundit të studimeve, ku falë kësaj praktike unë fitova mundësinë të punësohem në këtë kompani”, theksoi ai.

Tutje, ai tha se veçori e UBT-së është se realizon me përpikëri pjesën e punës praktike, teksa shtoi se institucioni organizon edhe trajnime e konferenca të shumta që janë në dobi të studentëve të vet. Gjithashtu, ai potencoi se UBT mban çdo vit Akademinë Verore të Fakultetit të Arkitekturës, në të cilën pjesëmarrësit kanë mundësinë të marrin përvoja profesionale nga arkitektë vendorë dhe ndërkombëtarë.



Rrëfime sukcesi

Profesoresha në UBT, Luljeta Minxhozi zgjidhet zv.guvernatore e Bankës së Shqipërisë

Profesoresha e nivelit master në UBT, Luljeta Minxhozi është zgjedhur zëvendësguvernatore e parë e Bankës së Shqipërisë, kjo pas propozimit të guvernatorit, Gent Sejko.

Emërimi i saj është bërë nga Këshilli Mbikëqyrës, teksa Minxhozi ishte propozuar për të shërbyer në këtë funksion dhe për të dhënë kontribut profesional.

Rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, me këtë rast ka uruar Minxhozin për marrjen e këtij posti dhe beson në përkushtimin dhe profesionalizmin e saj.

Kontributi i Minxhozit në Bankën Botërore të Shqipërisë, sipas rektorit Hajrizi, është i nevojshëm, pasi siç tha, do të ndihmojë në funksionimin e bankës.

Profesoresha në UBT, Luljeta Minxhozi është e diplomuar në degën Ekonomi Politike, më pas gradën Doktor Shkence e ka fituar në vitin 1996, ndërkaq titullin shkencor Profesor i Asociuar e morri në vitin 1999.



Studenti Benart Shala mori pjesë në Matchmaking Conference, në Slloveni



Studenti i Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Benart Shala, ka marrë pjesë në Matchmaking Conference, si pjesë e Creative Exchange 2019, që u mbajt në Lubjanë të Sllovenisë dhe ku morën pjesë dhjetëra arkitektë profesionistë e studentë premtues të arkitekturës.

Në këtë konferencë, Benarti prezantoi projektin e tij "Arkitektura përmes Efektit të Fluturës - Muzeu i Arkitekturës në Lisbonë", që ngjalli interesim të jashtëzakonshëm tek pjesëmarrësit, e veçanërisht tek dy organizata, të cilat shprehën interes për bashkëpunim konkret me të.

Pas këtij prezantimi, ai ka marrë ftesë që të bashkohet edhe në Tirana Design Week, ku do të përgatisë planprogramin, si dhe do të mbajë një punëtori me studentë të shumtë të interesuar, për të bërë instilacione të ngjashme. Kujtojmë se Benarti me këtë projekt hyri në garën ndërkombëtare, "Future Architecture", pjesë e së cilës ishin mbi 350 projekte të arkitektëve të rinj nga 70 shtete të ndryshme të botës, prej ku projekti i tij arriti të shpallej si projekti më i votuar nga publiku dhe mblodhi gjithsej 1201 vota, më shumë sesa çdo garues tjetër i botës.

Projekti i studentes Vildane Maliqi, përkrahet nga Qeveria e Austrisë dhe programi

Në mesin e shumë studentëve nga e mbarë bota, Qeveria e Austrisë dhe programi ndërkombëtar OEAD, kanë shpërblyer me bursë studenten e UBT-së, Vildane Maliqi, me projektin e saj hulumtues me temë: "Urban Planning in Vienna, good practices. Adaption of landscape architecture laws and articles in Kosovo".

Hulumtimi në fjalë ka të bëjë me praktikën më të mira urbane në shtetin austriak, si dhe adaptimin e ligjeve arkitekturore në shtetin e Kosovës. Ky hulumtim do të jetë krahasues, teksa të gjeturat në terren mund të përdoren në planifikimin urban në vend.

Projekti në fjalë do të mbështetet në çdo aspekt nga institucionet e urbanizmit në Vjenë, ku ata i kanë ofruar studentes infrastrukturë dhe mundësi për qasje në informata dhe bibliotekat e Austrisë.

Vildanja është një nga qindra të rinj kosovarë, ku përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit që UBT ka me mbi 300 universitete partnere në botë, ka realizuar ëndrrën e saj për të studiuar në shtete të ndryshme evropiane.



Studentja e Juridikut, Festa Zajmi, fituese e garës së OAK-ut për esenë më të mirë



Studentja e vitit të dytë në Fakultetin Juridik, në UBT, Festa Zajmi ka fituar vendin e parë në garën për esenë më të mirë për vitin 2019, që u organizua nga Komiteti për Çështje Gjinore, në kuadër të Odës së Avokatëve të Kosovës.


Tema me të cilën Festa e fitoi vendin e parë ishte "Sfidat ligjore tek nënat vetushqyese", teksa çmimin e mori më 8 mars, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, në një ceremoni të mbajtur në Shkodër të Shqipërisë.

Certifikata për të u nda nga kryetari i OAK-së, Osman Havolli dhe nga kryetarja e Komitetit për Çështje Gjinore, Edita Kusari.

Pjesë e kësaj gare me esetë e tyre ishin studentet e Juridikut nga të gjitha institucionet arsimore private dhe publike në Kosovë.

Rrëfime suksesi

Punimi i studentit të UBT-së do të shfaqet në Kino ARMATA



Studenti i UBT-së, Benart Shala arriti të merrte famë ndërkombëtare me projektin e tij “Arkitektura përmes Efektit të Fluturës”, kurse tash i njëjti projekt do të shfaqet si një film i shkurtër në Kino ARMATA, të hënën e javës së ardhshme, me fillim nga ora 19:00, ku edhe të gjithë të interesuarit do të kenë mundësi të shohin idenë e tij jashtëzakonisht unike. Qëllimi kryesor i këtij filmi të shkurtër është reflektimi i aspektit eksperimental të efektit flutur në hapësirën lokale. Ideja e përfshirjes së efektit flutur është një vullnet i lirë që i shtyn arkitektët më shumë në hartimin e diçkaje që mund të dallohet nga arkitektura e së tashmes dhe e së kaluarës.

Përfundimi i këtij projekti lidhet me arkitekturën e ardhshme, ashtu që ajo të jetë i projektuar në një mënyrë që përdoruesi të ketë një perceptim unik të arkitekturës.

Benarti me këtë projekt hyri në garën ndërkombëtare, “Future Architecture”, pjesë e së cilës ishin mbi 350 projekte të arkitektëve të rinj nga 70 shtete të ndryshme të botës, prej ku projekti i tij arriti të shpallej si projekti më i votuar nga publiku dhe mbledhi gjithsej 1201 vota, më shumë sesa çdo garues tjetër i botës. Si rezultat i këtij suksesi, ai do ta përfaqësojë Kosovën në Matchmaking Conference, si pjesë e Creative Exchange 2019, që do të mbahet më 13-15 shkurt, në Lubjanë të Sllovenisë.

Ish-studenti Kastriot Gashi, inxhinier i softuerit në OSBE dhe trajner në kompaninë Abidat

Kastriot Gashi i ka përfunduar studimet bachelor e master në Fakultetin e Shkencave kompjuterike dhe Inxhinierisë, në UBT, por ky nuk është suksesi i tij i vetëm që ka ndikuar në ngritjen e tij profesionale.

Ai tash e disa kohë është pjesë e stafit të OSBE-së, ku është duke punuar si inxhinier i softuerit, si dhe është i angazhuar me orar të shkurtër si trajner i Oracle në kompaninë “Abidat”, me seli në Nuremberg të Gjermanisë.

Kastrioti vlerësoi se UBT ofron mundësi të shumta për ngritje profesionale për studentët të cilët vërtetë e duan profesionin e tyre.

“Programet e studimit në UBT janë shumë të dobishme në aspektin profesional sepse përkojnë me trendet bashkëkohore dhe studenti ka mundësi të zhvillojë aftësi që janë të aplikueshme në jetën profesionale. Po ashtu, studentët që shfaqin interesim për zhvillimin e tyre akademik, kanë mundësi të mirë që të përgatiten mjaftueshëm përgjatë studimeve”, theksoi ai.

Përgjatë përvojave që ka marrë në UBT gjatë dhe pas studimeve, Kastrioti e veçon Konferencën Ndërkombëtare në Shkenca Kompjuterike dhe Komunikim, ku edhe kishte prezantuar një punim shkencor.



Studentja Ruhada Emini e punësuar në kompaninë “Bottomline Technologies”



Një delegacion i Universitetit Linnaeus, nga Suedia, i përbërë nga profesorë të fushave të ndryshme, si dhe staf administrativ, po qëndrojnë në Kosovë, konkretisht në UBT, të cilët po realizojnë vizitë në kuadër të planifikimeve të projekteve Erasmus+ KA1 dhe KA2.

Fillimisht, ata janë takuar me rektorin e UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, ku kanë diskutuar për zgjerimin e bashkëpunimi ndërinstitucional, bashkëpunim i cili ka filluar qysh para katër viteve në sferën e hulumtimeve dhe edukimit.

Përpos bashkëbisedimit, ata diskutuan për gjenerimin e projekteve përfshirë në shkëmbim të stafit, të studentëve dhe krijimin e qendrave hulumtuese.

Tutje, ata vizituan edhe laboratorët që gjenden në objektet e UBT-së, si dhe pajisjet e sofistikuar moderne që i shfrytëzojnë studentët e të gjitha fushave, për kryerjen e punës praktike. Po ashtu, ata janë takuar dhe kanë bashkëbiseduar me zyrtarë e profesorë të UBT-së, lidhur me projektet inovative të cilat implementohen nga institucioni dhe rezultatet e arritura.

Studenti Agon Daci, SEO specialist në kompaninë “Tactica”

Studenti i nivelit bachelor në Fakultetin Shkencat Kompjuterike dhe Inxhinieri, në UBT, Agon Daci, tash e disa muaj është punësuar në kompaninë “Tactica”, me seli në New Jersey të SHBA-ve dhe në Kosovë.

Ai mban pozitën SEO Specialist, si dhe merret me shërbime të marketingut digjital, konkretisht ofron konsulencë për SEO, bën auditimin e uebsite-ve, keyword research dhe link building.

Këto shërbime, studentit Daci i ofron kryesisht për klientët ndërkombëtarë.

“Njohuritë që kam marrë përgjatë tri viteve të studimeve në UBT, kanë qenë shumë të dobishme për ngritjen time profesionale dhe kanë qenë urë lidhëse në mes meje dhe tregut profesional të punës”, tha Daci

Ai theksoi se për dallim nga institucionet tjera arsimore, UBT gjithnjë dhe në çdo aspekt i mbështet studentët e vet, u ofron kushte studimi, inovacion dhe cilësi në mësimdhënie.



Rrëfime sukcesi

Studenti i MBE-së, Argjend Rashiti analist kreditor në “Finca” dhe kontabilist në kompaninë “Gazi”



Argjend Rashiti është student i Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, i cili suksesshëm është pozicionuar në tregun vendor të punës.

Ai aktualisht është duke punuar si analist kreditor në institucionin financiar amerikan “Finca”, ku merret me analizimin e kredive, përgatit dokumente për kredituesit, monitoron kreditë etj.

Gjithashtu, Rashiti është i angazhuar si kontabilist edhe në kompaninë “Gazi”, i cili bën përlogaritjet financiare të këtij biznesi.

Studenti Rashiti tha se sukseset e arritura janë falë UBT-së, pasi siç tha, institucioni i ofroi studime cilësore, punë praktike dhe trajnime të shumta.

“Padyshim që UBT më ka ofruar mundësi të shumta dhe më ka hapur rrugët për një karrierë të suksesshme, pasi që falë studimeve cilësore që kam ndjekur, kam vërejtur menjëherë efektin dhe dobishmërinë e tyre e ligjëratave dhe punës praktike. Jashtëzakonisht jam i kënaqur me UBT-në dhe do t’ia rekomandoja të gjithë atyre që mendoj të zhvillohen ose të avancojnë në karrierë”, potencoi ai.

Studenti Kadri Krasniqi, arkitekt në kompaninë Domus

Studenti i nivelit master në Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Kadri Krasniqi, është punësuar si arkitekt në kompaninë Domus, që është përfaqësimi i brendit italian, “DOMO”. Puna e tij është një cikël që nis me trajtimin e nevojave të klientëve dhe mbaron me realizimin e projekteve.

Kjo nuk është përvoja e parë e punës që Kadriu e ka pasur, pasi më parë ka kryer punë praktike në kompaninë Nartel, pastaj ka punuar si arkitekt operues në kompaninë për pllaka, mermer dhe granit, “Standard”, ka një vit përvojë pune në Drejtorinë e Planifikimit dhe Urbanizmit në njërin nga komunat e Kosovës, si dhe ka përvojë pune edhe në një studio të projektimit.

Për të gjitha këto suksese, ai tha se UBT i ka dhënë një ndihmesë të madhe, falë nivelit të cilësisë së lartë të studimeve, mundësive për punë praktike dhe vizitave brenda dhe jashtë Kosovës.


“Përmes përmbajtjes së kurrikulës së fakultetit për avancim në aspektin profesional dhe për qasje në tregun e punës, UBT ka qenë urë lidhëse për suksesin tonë në aspektin e formimit profesional. Akumulimi i informatave të ndryshme dhe përfitimi nga përvoja e profesorëve vendorë dhe ndër-kombëtarë, na kanë avancuar dhe na kanë bërë më të përgatitur për punë”, vlerësoi ai.

Kadriu planifikon që brenda një të ardhmeje të afërt të fillojë biznesin e tij personal në fushën e arkitekturës, si dhe synon që të vazhdojë edhe studimet e doktoraturës.

Ai theksoi se ndjekja e këtij programi në UBT, është mundësia më e mire për t’u bërë pjesë e tregut vendor dhe ndërkombëtar të punës.



Studenti Pjetër Monreca punësohet në portalin Telegrafi



Studenti i vitit të tretë në Fakultetin Media dhe Komunikim, Pjetër Monreca, është punësuar në portalin Telegrafi, në pozitën e kameramanit dhe montazherit. Ai ka theksuar se mënyra se si ka arritur të punësohet është falë bashkëpunimit të UBT-së dhe Telegrafit, ku përfaqësuesit e Fakultetit Media dhe Komunikim e kanë propozuar atë, për shkak të suksesit të treguar gjatë studimeve.

“Studimet në UBT më kanë ndihmuar më shumë se që kam pritur, më kanë përgatitur për tregun e punës, si dhe për mënyrën se si ta menaxhojmë kohën dhe presionin e punës. Po ashtu, mënyra e ligjërimit ka qenë në nivel të duhur, e qartë dhe shumë kapshme”, vlerësoi Pjetëri.

Sikurse në programet e të tjera të studimit, ashtu edhe në Fakultetin e Medias dhe Komunikimit, UBT po vazhdon të sistemojë në tregun e punës gazetarë, montazherë, kameramanë, fotografë e zyrtarë komunikimi, që janë entuziastë dhe po tregohen të suksesshëm në punën që po e bëjnë.

Ish-studenti Gramos Kamberi, i punësuar në Intes GmbH

Ish-studenti i UBT-së në Fakultetin e Shkencave kompjuterike dhe Inxhinierisë, Gramos Kamberi, menjëherë pas përfundimit të studimeve themelore ka arritur që të sistemohet në tregun e punës, ku aktualisht është pjesë e kompanisë, Intes “GmbH”, që ka e ka fokusin e punës në tregun evropian dhe degën kryesore e ka në Zvicër.

Puna e tij lidhet me asistimin e proceseve dhe njerëzve që janë të përfshirë gjatë zhvillimit të një projekti, ose edhe të gjithë kompanisë. Saktësisht, Gramosi është Scrum Master dhe Project Agile Manager, për kompaninë ku punon. Veçoria e punës që e kryen qëndron në faktin se pozita e Scrum Master nuk është shumë e përhapur në tregun e Kosovës.

Ai thotë se niveli i përgatitjes së studentëve për përshtatje me tregun e punës është jashtëzakonisht i lartë, andaj vlerësoi se secili student duhet ta vlerësojë këtë mundësi, siç e ka shfrytëzuar ai.

“Ndërthurja interesante e lëndëve menaxheriale me ato të teknologjisë, si dhe mundësia për t’i praktikuar gjërat teorike në laboratorët e UBT-së, padyshim që më kanë ofruar ide të qarta se ku saktësisht do të jetë përqendrimi im profesional në të ardhmen. Gjithashtu, me plotë kompetencë mund të them që unë nuk jam përfituesi i vetëm i programit të SHKI-së, por edhe shumica e ish-kolegëve të mi janë shumë mirë të sistemuar”, tregoi ai.

Gramosi i inkurajon studentët që të fillojnë të punojnë sa më herët, sepse, sipas tij, përveç që do të kenë një horizont më të gjerë të njohurive, do të kenë mundësi që të krijojnë edhe rrethin e tyre profesional.



Rrëfime sukcesi

Studenti i MBE-së, Arbnor Bunjaku i punësuar në Raiffeisen Bank



Arbnor Bunjaku është student i vitit të tretë në Fakultetin Menaxhmet, Biznes dhe Ekonomi në UBT, i cili ka disa muaj që është punësuar në Raiffeisen Bank. Ai mbanë pozitën e zyrtarit të shitjes direkte, ku analizon gjendjet financiare, ofron këshilla profesionale për klientët, propozon kredi dhe bën promocione për bankën.

Bunjaku theksoi se UBT-ja i ka ndihmuar që ai të del i gatshëm në tregun e punës, si dhe i ka mundësuar avancim në karrierë.

“Përgjatë studimeve në UBT, më është ofruar gjithmonë një ambient pune dhe staf i përkushtuar, gjë e cila më kanë bërë që t’u jap rëndësi më të madhe studimeve në anën teorike si dhe gërshetimit të tyre me punën praktike”, tha Bunjaku.

Bunjaku është shprehur i kënaqur që është pjesë e UBT-së, pasi siç tha, studentët e këtij institucioni përfitojnë njohuri të mjaftueshme për të siguruar vende pune.

Rektori Hajrizi priti në takim studentët e UBT-së që kaluan një semestër të studimeve në Gjermani

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi ka pritur në takim studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, të cilët, si pjesë e programit të shkëmbimit të studentëve, kanë përfunduar një semestër të studimeve në Anhalt University of Applied Sciences, në Gjermani. Anesa Mustafa, Blend Dema, Flaka Sylja, Floriana Zllanoga, janë katër nga shtatë studentët e UBT-së, të cilët u pritën nga rektori dhe i shpallën atij përvojën e paharruar gjatë muajve të kaluar në Gjermani.

Rektori Hajrizi u shpreh i lumtur që UBT ka ndihmuar studentët që ta përjetojnë ndjenjën e të studiuarit në njërin nga universitetet më të njohura në botë për arkitekturë.

“Jam i lumtur që përmes UBT-së ua kemi ofruar studentëve mundësinë që të studiojnë në një universitet me repute ndërkombëtare, sepse qëllimi ynë kryesor është që studentët tanë t’i dërgojmë jashtë kufijve për t’u inspiruar e për të sjellë përvojën e tyre që të zhvillojnë shtetin tonë”, theksoi Hajrizi.

Edhe studentët e UBT-së që ishin përfitues të kësaj burse u ndanë shumë të kënaqur me përvojën e fituar, teksa shprehën gatishmërinë e tyre që përvojën e fituar ta inkorporojnë në punën e tyre të përditshme në Kosovë.



Studenti i UBT-së, bashkëpronar dhe drejtues i Shkollës Digjitale në Prizren

Studenti i UBT-së në Fakultetin e Mekatronikës, Roni Kasemi është një ndër studentët e shumtë të UBT-së, i cili është pozicionuar me shumë sukses në tregun e punës. Aktualisht, ai është bashkëpronar dhe drejtues i Shkollës Digjitale në Prizren, ku fokus kryesor i kësaj shkolle është edukimi dhe zhvillimi në fushën e programimit i fëmijëve dhe të rinjve nga mosha 7 deri në 18 vjeç. Përpos kësaj, ai është edhe i angazhuar si asistent i lëndës së programimit në UBT.

Në Shkollën Digjitale në Prizren, Roni e ka rolin e drejtorit të operacioneve dhe të ligjëruesit, teksa si drejtor i operacioneve menaxhon punët ditore të shkollës, kontrollin e kualitetit dhe të cilësisë, menaxhimin e punëtorëve, zhvillimin e planeve javore, etj.

Ndonëse tash është në përfundim të studimeve të nivelit master, ai i kujton arsyet se pse kishte vendosur që ngritjen e tij akademike ta fillonte në UBT.

“UBT ishte i vetmi institucion në vend i cili ofronte studimet në fushën e mekatronikës. Anash kësaj, ky institucion veçse ishte zgjedhja e shumicës së rinjve të cilët dëshironin të zhvilloheshin në fushën e teknologjisë pasi që ishte institucioni me numrin më të madh të studentëve të suksesshëm në këtë drejtim”, tregoi Roni.

Ai tregoi se gjatë studimeve në UBT kanë punuar një numër të madh të projekteve, disa prej të cilave ishin prezantuar e vlerësuar edhe nga investitorë të huaj. Ndërkaq, sipas tij, UBT vazhdimisht ka bërë



Studio në UBT, bëhu pjesë e suksesit të garantuar

Blertë Retkoceri vijon studimet e nivelit master në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës, e cila zgjedhi të bëhet pjesë e UBT-së për një karrierë të suksesshme dhe për të përfituar njohuri e përvoja profesionale nga profesorë vendorë e ndërkombëtarë.

Duke folur për studimet në UBT, ajo theksoi se jesh pjesë e këtij institucioni do të thotë të jesh pjesë e suksesit të garantuar. Sipas saj, UBT është vend i përgatitjes akademike në profesionin e inxhinierisë.

“Në UBT aplikohet njëkohësisht ligjërimin teorik, interaktiviteti, hulumtimet, zhvillimin e projekteve dhe programeve teknike, mësimin praktik, vizitat studimore brenda dhe jashtë vendit, bashkëpunimin me shumë universitete Evropiane, rajonale dhe më gjerë. Gjithashtu, studentët e UBT-së aftësohen jashtëzakonisht që shumë saqë edhe kompanitë e ndryshme kërkojnë që ata të bëhen pjesë e tyre”, potencoi ajo.

Tutje, Blerta tregoi se UBT i ofron studentëve mundësi të shumta, përfshirë punësim dhe vazhdim të studimeve jashtë vendit.

Studentja Retkoceri tregoi se UBT është edhe i vetmi institucion që ofron sisteme online, bibliotekën më të madhe në rajon, kurse përgatitore, laboratorë shkencorë etj.



Rrëfime sukcesi

Studenti Genc Emini i angazhuar në departamentin e Shkollave Profesionale në UBT



Studenti i vitit të tretë në Fakultetin Menaxhmet, Biznes dhe Ekonomi, Genc Emini ka disa muaj që është angazhuar dhe punon në departamentin e Shkollave dhe Trajnimeve Profesionale.

Emini ka thënë se po fiton përvojë profesionale në aktivitetin që ushtron dhe, sipas tij, meritat për këtë janë të UBT-së.

Ai thotë që është bërë pjesë e stafit profesional të UBT-së, teksa tregon se ky institucion veç tjerash ofron kushte, programe inovative akademike dhe trajnime të fushave të ndryshme.

“Është një mundësi jashtëzakonisht e mirë pasi që në të njëjtën kohë po studioj dhe po marrë përvoja profesionale nga njerëz profesionist që veprojnë në UBT. Ky institucion faktikisht është një ndër më të mirët në vend, andaj përveç studimeve, ëndrra ime ka qenë që të jem pjesë e UBT-së”, potencoi Emini.

Gjeneratat që diplomohen në UBT arrijnë të qasen lehtësisht në tregun e punës dhe bëhen pjesë e kompanive më të suksesshme në vend dhe rajon. Studentët përveç që përfundojnë me sukses studimet themelore, ata po arrijnë edhe zhvillim profesional sikurse studenti në fjalë.

Ish-studentja e UBT-së, Alborita Mehana e punësuar në GCK dhe Coders Trust

Alborita Mehana ka studiuar në Fakultetin Shkenca Kompjuterike në UBT, e cila përvojat e marra gjatë studimeve po i praktikon në organizata që promovojnë programimin ose në përgjithësi sektorin e IT-së.

Aktualisht ajo është duke menaxhuar projekte të ndryshme për Girls Coding Kosovo (GCK), ku ka sjell frymëzim dhe ide inovative. Ish-studentja Mehana tregoi se në të njëjtën kohë është duke punuar edhe në kompaninë “CodersTrust”, ku deri më tani ka asistuar rreth 500 studentë të lindjes së mesme për t’i përvetësuar aftësitë teknologjike dhe të gjejnë punë online si mentor assistant. Përpara se ajo të punësohej, Mehana ka theksuar që ka ndjekur trajnime dhe seminare të shumta në mënyrë që të eksplorojë më shumë në industrinë e teknologjisë dhe programimit.

“Duke qenë pjesë e këtyre trajnimeve, gjithnjë më dhanë më të mirën në programim, duke punuar në grupe, duke ndihmuar të tjerët, duke shoqëruar dhe kështu me radhë. Pas kësaj, kam marrë oferta për të punuar për kompani që merren me programim ose promovim të këtij sektori”, potencoi Mehana.

Ajo i inkurajon gratë që të arrijnë potencialin e tyre të plotë akademik dhe profesional në fushat teknike, ndërkohë u bëri thirrje të jenë aktive në këtë aspekt.



Studentja Trinë Ismajli, zhvilluese e ueb-it në kompaninë austriake, “SCOOP & SPOON”



Studentja e nivelit master në Fakultetin e Shkencave kompjuterike dhe Inxhinierisë, Trinë Ismajli pothuajse tash e katër vite është pjesë e kompanisë së njohur austriake për marketing dhe dizajn, “SCOOP & SPOON”, ku punon si zhvilluese e ueb-it.

Trina tha se sigurimi i një vendi të punës pa i përfunduar studimet e nivelit bachelor është sfidë dhe përgjegjësi në vete, por që e ka arritur me përkushtim dhe punë të vazhdueshme.

“Falë profesorëve shumë të kualifikuar, asistentëve me të cilët kemi mbajtur ushtrimet gjatë periudhës së studimeve bachelor, si dhe gjithmonë interesi im në këtë lëmi, kanë ndikuar që unë të përfitoj shumë nga studimet e mia në këtë fushë dhe të punësohem ende pa i mbaruar studimet. Tash i bëj katër vite përvojë pune, pa ndaluar asnjëherë”, tregoi ajo.

E nga periudha e studimeve bachelor, tash edhe në master, Trina ruan shumë kujtime që i dhanë përvoja të reja dhe e shndërruan në profesioniste të vërtetë.

“Një nga ngjarjet të cilën do ta vlerësoja në nivelin bachelor është fitimi i bursave për dy vite radhazi për shkak notës sime mesatare, si dhe certifikata e fituar si “Studentja më e mirë e vitit”, në Ceremoninë e Diplomimit”, vlerësoi ajo.

Trina ka përfituar edhe nga marrëveshjet e bashkëpunimit të UBT-së me universitetet ndërkombëtare, me ç’rast gjatë studimeve master, ajo ishte pjesë e programit të shkëmbimit të studentëve, ku me bursë të plotë studimi kaloi një semestër në Staffordshire University, në Britani të Madhe.

Ish-studentja Andelina Biqkaj po vazhdon studimet në Itali

Ish-studentja e UBT-së në Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Andelina Biqkaj, rrugëtimin drejt zhvillimit profesional e nisi në UBT, kurse tash po e vazhdon me shumë sukses në Universitetin Politeknik të Milanos, ku po i vijon studimet e nivelit master.

Pranimi në njërën ndër universitetet më të mira evropiane për arkitekturë, ishte përvojë në vete për Andelinën, porse thotë që këtë sukses e ka arritur punë, përkushtim dhe me përkrahjen e profesorëve.

“Pranimi nga UBT në një ndër universitetet më të mira në Evropë për arkitekturë nuk ka qenë aspak një pengesë për mua. Njohuritë që kam marrë në UBT janë të përafërta me ato që jam duke i studiuar tani. Mundësitë që më janë dhënë pas përfundimit të studimeve në UBT, më bëjnë më tepër entuziaste që të vazhdoj me tutje karrierën time profesionale dhe një ditë të jem në gjendje të kontribuoj në edukimin për një arkitekturë të mirëfilltë”, vlerësoi ajo.

Sipas saj, përparësi për studentët e UBT-së është mirë koordinimi i programit të studimeve, dhe integrimi i të gjitha lëndëve të artit dhe shkencës në arkitekturë.



Rrëfime sukcesi

Studenti i UBT-së, Lirim Shabani i punësuar në Kompaninë e Derivateve “Shell”



Lirim Shabani ka vazhduar studimet e nivelit master në UBT, në Fakultetin Shkencë Kompjuterike dhe Inxhinieri, i cili më pas është punësuar në kompaninë ndërkombëtare të derivateve “Shell”, kompani që operon edhe në Kosovë.

Ai mbanë pozitën e inxhinierit të teknologjisë informative dhe konkretisht merret me administrimin e sistemit, duke përfshirë menaxhimin e sistemeve, të rrjetit, kontrollimin e sistemit dhe 120 pajisjeve fiskale etj.

Me theks të veçantë, studenti Shabani tha se dija që e fitoi gjatë studimit në UBT dhe përvojat e marra përgjatë dy viteve nga institucioni, i mundësuan atij të punësohet në këtë kompani ndërkombëtare.

“Vlerësoj shumë faktin që jam pjesë e UBT-së, për shkak se UBT më ofroi studime cilësore dhe i ndihmoi shumë në ngritje profesionale”, potencoi ai.

Po ashtu, tha se UBT është i vetmi institucion i arsimit të lartë që shërben edhe si urë lidhëse me industrinë apo tregun vendor të punës.

Ish-studenti Bujar Sekiraqa, udhëheqës i AKEE-së në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik

Ish-studenti i UBT-së, Bujar Sekiraqa i takon gjeneratave të para të të diplomuarve të UBT-së dhe Kosovës në Mekatronikë, si një fushë ende e re dhe fare pak e eksploruar në Kosovë.

Ai momentalisht është udhëheqës për Planifikim në Agjencinë e Kosovës për Eficiencë të Energjisë, në kuadër Ministrisë për Zhvillim Ekonomik. Kurse, që nga përfundimi i studimeve, ka fituar përvojë të jashtëzakonshme profesionale edhe nëpër kompani dhe institucione të ndryshme vendore, përfshirë KEK-un, KEDS-in dhe Komunën e Obiliqit.

Duke pasur parasysh sfidat me të cilat po përballlet sektori i energjisë në Kosovë, Bujari thotë se profesioni i tij është shumë i rëndësishëm dhe se Kosova ka nevojë për më shumë ekspertë të kësaj fushe.

“Duke e marrë parasysh që sektori i energjisë elektrike në Kosovë ndodhet në një pozitë jo të mire dhe kredibile, është mese e nevojshme që efienca e energjisë të gjejë përdorim më të madh, në mënyrë që të ndihmonte në ruajtjen e ambientit duke shfrytëzuar burime alternative dhe furnizim stabil me energji elektrike”, vlerësoi ai.

Bujari tha se studimet në UBT i kanë ndihmuar në marrjen e njohurive të reja, përmes ligjëratave produktive e profesionale, si dhe ushtrimeve laboratorike të zhvilluara gjatë viteve të studimeve. Ndërkaq, tash ka për synim kryesor që të fillojë studimet e doktoratës dhe të angazhohet në akademi, në mënyrë që njohuritë e tij teorike dhe praktike t’i ndajë me gjeneratat e reja të studentëve.



Projekti i studentit Benart Shala, fitues dhe më i preferuari i publikut në garën “Future Architecture”



UBT promovoi punën dhe talentin e studentit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Benart Shala, i cili me projektin e tij hyri në garën ndërkombëtare, “Future Architecture”, pjesë e të cilës ishin mbi 350 projekte të arkitektëve të rinj nga 70 shtete të ndryshme të botës.

Nga të gjitha këto punime, ai i Benartit arriti që të shpallet projekti më i votuar nga publiku dhe mbledhi gjithsej 1201 vota, më shumë sesa çdo garues tjetër i botës.

Lajmi për këtë të arritur të tij dhe vendit tonë është bërë e ditur nga vetë organizatorët e garës, me ç’rast nga pesë punime nga Kosova, Benarti është i vetmi i cili falë këtij sukcesi do ta përfaqësojë Kosovën dhe projektin e tij në Matchmaking Conference, si pjesë e Creative Exchange 2019, që do të mbahet më 13-15 shkurt, në Lubjanë të Sllovenisë.

“Përzgjedhja e 25 krijuesve ka përfunduar me zgjedhjen e idesë më të preferuar të publikut. Ndjekësit nëpër rrjete sociale të “Future Architecture” kanë zgjedhur përmes një votimi në internet, projektin “Arkitektura përmes Efektit të Fluturës” nga Benart Shala (Kosovë), si të preferuarin e tyre”, thuhet në njoftimin zyrtar të garës.

Përveç prezantimit të ideve, Benarti dhe fituesit e tjerë do të kenë mundësi që të bëhen edhe pjesë e Arkitektëve të së Ardhmes dhe e programit “Evropa Kreative”.

Studenti Nderim Bytyçi është punësuar në kompaninë gjermane, “TIM Solutions”

Studenti i vitit të tretë në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë, Nderim Bytyçi, është punësuar në kompaninë me bazë në Gjermani, “TIM Solutions”, në pozitën e zhvilluesit të Java EE.

Ai po ndihmon kompaninë në fjalë duke ofruar shërbime softuerike për shumë kompani të tjera të njohura në botë, teksa për procesin e punësimit paraprakisht ka kaluar në dy intervista.

Nderimi tha se punësimi nuk ka arritur në mënyrë rastësore, por për shkak të angazhimit të tij gjatë viteve të studimeve dhe me praktikim vetjak të njohurive të fituara.

“UBT po nxjerr kuadro shumë të përgatitura për tregun lokal dhe atë ndërkombëtar të punës, të cilët përpos mësimin në studime, këshillohen që të zhvillojnë veten edhe me mësim vetjak”, tregoi ai.

Momentalisht, Nderimi është në përgatitje të një projekti shumë të rëndësishëm, për jetësimin e të cilit është duke e përkrahur UBT.



Rrëfime sukcesi

Diploma e UBT-së, e barasvlershme me atë në Gjermani

Dardan Jashari është ish-student i Fakultetit të Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës, i cili pas përfundimit të studimeve të nivelit bachelor, ka vendosur që profesionin e tij prej inxhinieri ta ushtrojë në Gjermani.



Për këtë, paraprakisht atij i është dashur që të plotësojë dokumentacionin dhe të bëjë barasvlerësimin e diplomës, gjë të cilën e arriti me shumë lehtësi.

“Kushti ka qenë që diploma e studimeve për Inxhinieri Ndërtimore dhe Infrastrukturë në UBT, të jetë e barasvlerëshme me studimet për të njëjtën degë në Gjermani. Pastaj, kam aplikuar në Ministrinë e Arsimit në Gjermani, kurse konfirmimin e kanë kthyer pas 10 ditësh”, tregoi Dardani.

Sipas tij, kriter vlerësimi për njohje të nivelit bachelor të studimeve ka qenë përputhja e planprogramit.

“Pasi që më janë pranuar studimet themelore, unë kam gjetur punë si asistent i inxhinierit kryesor në një kompani ndërtimi në Gjermani. Kur e kam zgjedhur UBT-në, e kam ditur që diploma ka shumë vlerë, por njohja e saj në nivel ndërkombëtar vetëm se e forcon bindjen tonë”, tha Dardani.

Përpos ushtrimit të profesionit të inxhinierit, ai po planifikon që brenda pak kohësh të fillojë edhe studimet e nivelit master në Gjermani.

Vlera që e kanë studimet dhe diplomat e UBT-së brenda Kosovës, tash e shumë vite i kanë kaluar kufijtë shtetërorë. E vlefshmërinë e diplomave, studentët dhe ish-studentët e UBT-së po e provojnë çdoherë që po aplikojnë për vazhdim të studimeve apo punësim jashtë vendit.

Studentja e Juridikut, Ismije Pllana e angazhuar në Qendrën e Karrierës në UBT

Studentja e nivelit master në Fakultetin Juridik në UBT, Ismije Pllana, tashmë është angazhuar dhe është bërë pjesë e stafit të Qendrës së Karrierës në UBT.

Përveç që ndihmon në koordinimin e kësaj qendre, ajo merret edhe me studentët që synojnë të përfundojnë kurset e gjuhëve të huaja në UBT.

Ajo tha se institucioni në të cilin diplomoi në nivelin bachelor dhe është në përfundim të masterit, i ka ofruar mundësi të shumta në ngritje profesionale.

“Jam shumë e kënaqur që kam qenë pjesë e UBT-së për katër vite të studimeve bachelor, si dhe jam tejet falënderuese për mundësinë që më është dhënë që të jem pjesë e stafit të UBT-së”, theksoi ajo.

Tutje, ajo tha se përkushtimi i institucionit, qasja e stafit dhe e profesorëve ndaj studentëve, ka bërë që studentët e UBT-së të aftësohen dhe të tregohen të suksesshëm kudo në tregun e punës.



Studentja Luiza Hoxha, arkitekte në kompaninë “DEKORATIV”



Studentja e nivelit master në Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Luiza Hoxha është duke punuar tash e tri vite si arkitekte në kompaninë “DEKORATIV”, që merret projektim, ndërtim dhe instalime të sanitarisë dhe qeramikës.

Përgjegjësia e saj në ekip është në projektimi i enterierëve dhe mbikëqyrja e punëve deri në përfundimin e tyre.

Luiza tha se i gjithë ky sukses është i natyrshëm, sepse është angazhuar dhe i ka shfrytëzuar me përpikëri të gjitha mundësitë që i janë ofruar gjatë studimeve.

“Të gjitha arritjet gjatë studimeve janë mundësuar nga faktorë të ndryshëm, ku përveç përkushtimit tim personal, ndikues është edhe profesionalizmi që kanë treguar profesorët ndaj nesh, pajisjet teknologjike të cilat UBT i posedon në numër të mjaftueshëm për të gjithë studentët, e gjithashtu kushtet dhe hapësirat e përshtatshme, sidomos për studentët e Arkitekturës, të cilëve u nevojitet një hapësirë e madhe për punimet e tyre”, vlerësoi ajo.

Luiza tregoi se gjatë studimeve ka pasur mundësi të bëjë pjesë e ekspozitave, udhëtimeve dhe vizitave nëpër vende të ndryshme, teksa e përmendi edhe punëtorinë “EASA”, në Bullgari, pjesëmarrjen në të cilën ia mundësoi UBT.


Studentja Gertë Berisha e angazhuar në Qendrën e Karrierës në UBT

Studentja e Fakultetit Juridik në UBT, Gertë Berisha është angazhuar në Qendrën e Karrierës në UBT, me ç'rast ajo ndihmon studentët për qasje në tregun e punës dhe orienton maturantët në karrierë.

Gerta tha se përveç që institucioni i ofroi mundësi punësimi, ajo falë UBT-së përfaqësoi Kosovën në Garën Ndërkombëtare të Arbitrazhit në Vjenë, në të cilën marrin pjesë çdo vit ekupe të 400 universiteteve botërore.

“UBT është institucion që përkrahë dhe motivon studentët e vet, në mënyrë që ata të arrijnë të plotësojnë dhe realizojnë ëndrrat e tyre, përkrahje e cila vazhdon nga institucioni edhe pas mbarimeve të studimeve”, theksoi ajo.

Ajo tha se ndjehet e lumtur që është bërë pjesë e stafit të UBT-së, pasi siç tha, institucioni është më prestigjiozi dhe lider në Kosovë për arsim të lartë.



Studenti i UBT-së, ushtari më i mirë i Brigadës së Mbështetjes Operacionale

Studentët e UBT-së, përpos përgatitjes profesionale që e marrin gjatë studimeve, tregohen tejet të suksesshëm edhe në vendet e tyre të punës, qoftë edhe atëherë kur punë e kanë ruajtjen e sigurisë së qytetarëve dhe vendit.



I tillë është student i nivelit master, në Fakultetin e Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës, në UBT, Labinot Vuniqi, i cili e ka zënë vendin e parë në një garë të organizuar nga Forcat e Armatosura të Kosovës, ku mban pozitën e tetarit në Batalionin e Logjistikës.

Në këtë garë janë testuar njohuritë e përgjithshme, testi fizik, navigimi tokësor, si dhe marshimi prej 15 kilometrash me ngarkesë.

Ceremonia e garës së ushtarit më të mirë në kuadër të Brigadës së Mbështetjes Operacionale është mbajtur në kazermën “Adem Jashari”, të Komandës së Forcave Tokësore, ku pjesëmarrës ishin: komandanti i Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Enver Cikaqi, komandanti i BMO-së, gjeneral brigade Naim Haziri, zv. komandanti i BMO-së, kolonel Avdi Rraci, komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, kolonel Shaip Haziri, komandantët e batalioneve të BMO-së, si dhe oficerë dhe nënoficerë të FSK-së.

Kjo garë në kuadër të BMO-së ishte parapërgatitje për garën finale me karakter ndërkombëtar, e cila do të organizohet në nivel të FSK-së, në fund të muajit prill.

Vlen të theksohet se UBT ka qenë institucioni që ka përkrahur me bursa studimi dhe me trajnime gjeneratën e parë të kadetëve të TMK-së, tash Forcave të Armatosura të Kosovës.

Studenti i MBE-së, Andi Shemsedini, kontabilist dhe menaxher në disa kompani

Andi Shemsedini është student i vitit të dytë në Fakultetin Menaxhmet, Biznes dhe Ekonomi në UBT. Ai përveç studimeve, punon si kontabilist dhe menaxher në disa kompani vendore dhe gjermane.

Andi punon në “Buchhaltung Discount Service”, në Prishtinë, e cila është pjesë e kompanisë gjermane “Black Currant Group” GmbH & Co.KG, ku kryen shërbime të kontabilitetit për kompani të njohura në Gjermani.

“Konkretisht unë punoj për kompaninë “Papierwelten” e cila ka pesë filiale në Gjermani. Për këtë kompani e kam pozitën e Category Management-it ku merrem me menagjimin e stokut, menagjimin e porosive të dërguara nga filialet për furnitorët, një pjesë të financave dhe kontabilitetit etj.”, tregoi ai.

Ai gjithashtu është i punësuar në rrjetin e librarive “Meti”, me filialet “Evetare” dhe “Idea” në Prizren, ku ka pozitën e menaxherit të përgjithshëm dhe kontabilistit. Po ashtu, ditëve të fundit është i angazhuar në një ndër libraritë më të madhe në Kosovë, librarinë “Altera” në Prizren, ku kryen detyra menaxheriale. “Përmes UBT-së unë kam marrë shumë njohuri të reja dhe i kam forcuar njohuritë paraprahe. UBT më ka ofruar mundësi shumë të mira të studimit, si nga infrastruktura, profesorët e sidomos asistentët të cilët janë shumë të motivuar për punën e tyre dhe janë të gatshëm në çdo kohë për studentët e tyre”, theksoi ai.

Sipas tij, studimet në UBT i bën të veçanta cilësia në arsim, ligjërimi, stafi akademik dhe administrativ.



Ish-studentja Arda Hasani, arkitekthe në kompanitë “Swiss Bau” dhe “Teuta.cos”

Ish-studentja e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, Arda Hasani është punësuar si arkitekthe në dy kompani “Swiss Bau” dhe “Teuta.cos”, në Prizren.

Ajo në cilësinë e arkitektes mbikëqyr punimet e objekteve në ndërtim e sipër. Arda tregoi se gjatë studimeve dhe me mbajtjen e punës praktike ka marrë përvojat profesionale, falë të cilave është sistemuar në tregun e punës.

“Nga profesorët dhe asistentët e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësi-

nor në UBT, kam mësuar të gjitha aspektet kryesore në fushën e arkitekturës. Gjithsesi, lëndët, puna praktike në terren, më kanë ndihmuar për avancimin tim në karrierë, si dhe kjo ka bërë që ne studentët të dalim mjaft të përgatitur në tregun e punës”, tha ajo.

Arda theksoi se Fakulteti Arkitekturës dhe Planifikim Hapësinor në UBT, është i vetmi program i studimit në Kosovë që ofron njohuri dhe përgatitë arkitekthe të e së ardhmes në projektim, planifikim dhe menaxhim të projekteve.

Studenti Faton Sertolli, arkitekt në L&A Architects

Pas përfundimit të studimeve bachelor, tash student i nivelit master, Faton Sertolli, tash e dy vite është punësuar në zyrën projektuese “L&A Architects”, ku mban pozitën e arkitektit dhe merret me projekte të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, sikurse projektimi i objekteve shoqërore, afariste, banesore e individuale, dizajn enterier dhe mbikëqyrje në terren.

Përpos punëve të zakonshme të arkitektit, Fatoni dhe byroja në të cilën punon, kanë dëshmuar profesionalizmin edhe në Bienalen e Arkitekturës që është mbajtur në Kosovë, ku kanë fituar Çmimin “Projekti më i mirë i ndërtesave të ardhshme në zhvillim”.

Ai tha se me përvojat që i ka fituar gjatë studimeve në UBT, e ka pasur shumë të lehtë përshtatjen në tregun e punës.

“Programi UBT-së për arkitekturë të mundëson të zhvillohesh shumë në aspektin profesional sepse me njohuritë dhe eksperiencën që e fiton në UBT, bëhesh mjaftueshëm i përgatitur për t’u ballafaquar me sfidat në punën profesionale”, vlerësoi Fatoni.

E nga momentet më interesante gjatë studimeve bachelor, ai e kujton pjesëmarrjen në koncept idenë për projektimin e Kampusit Inovativ të UBT-së, në Lipjan.

Studenti i UBT-së, i punësuar në Nartel Construction & Design

Studenti i Fakultetit të Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës, Arxhent Jakupi është duke punuar si asistent i inxhinierit kryesor në kompaninë “Nartel Construction & Design”.

Në këtë kompani ndërtimore ai merret me projektimin e planeve të strukturës e arkitekturës, si edhe detajeve. Arxhenti tha arritja deri tek punësimi është përcjellë me punë intensive, por, sipas tij, tash investimi është i kthyer sepse ka arritur të punësohet në profesionin për të cilin edhe ka studiuar.

“Falë angazhimit tim kam arritur këtu ku jam, ndërsa UBT mund të them që ka qenë udhërrëfyesi për të ardhmen, e njohuritë që kam fituar në UBT gjatë studimeve, kanë qenë themelore dhe shpresë se në një të ardhme të afërt mund të arrij suksesin e dëshiruar, gjë që edhe ka ndodhur”, u shpreh ai.

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit në UBT, është program i akredituar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim, dhe është ndër fakultetet më të suksesshme në rajon në përgatitjen e inxhinierëve të ardhshëm.

Studenti Gent Avdijaj është punësuar në Verpura GmbH

Studenti i Fakultetit të Shkencave kompjuterike dhe Inxhinierisë, Gent Avdijaj është punësuar në kompaninë “Verpura GmbH”, ku mban pozitën e zhvilluesit të Java-s.

Ai ka arritur deri tek kjo pozitë e punës me ndihmën e ofruar nga Qendra e Karrierës në UBT.

Genti tha se kjo punë do ta ndihmojë në zhvillim e mëtejshëm profesional, teksa shtoi se UBT i ka ndihmuar shumë në këtë aspekt.

“UBT më ka ndihmuar shumë në ngritje profesionale, sepse ato që i kam mësuar në UBT, tani e tutje po i shfrytëzoj çdo ditë në vendin tim të punës”, potencoi ai. UBT ka shkollën më të madhe të shkencave kompjuterike në region, prandaj kompanitë vendore, por edhe ato ndërkombëtare, janë gjithmonë në kërkim të kadrove që dalin nga UBT, për shkak të nivelit të lartë të kompetencave profesionale që i fitojnë gjatë studimeve.

Përmes Erasmus+, UBT ka ngritur laboratorin më modern multimedial në Kosovë

Laboratori medial i UBT-së është pasuruar me dhjetëra pajisje multimediale të teknologjisë së fundit, të cilat kanë arritur si rezultat i projektit DMTV (Zhvillimi dhe Implementimi i Multimedias dhe Televizionit Digjital), të mbështetur dhe financuar nga programi Erasmus+, si i pari i këtij lloji i ngritur në Kosovë.

Laboratori është pasuruar me pajisjet më të sofistikuar në fushën e mediave, të cilat do të përdoren nga stafi dhe studentët, për organizim të ligjëratave dhe ushtrimeve me mjetet më moderne për t'i realizuar projektet e tyre.

Laboratori multimedial u siguron studentëve kushtet optimale për realizim të të gjitha projekteve brenda vetë institucionit, dhe atë, në mënyrën më profesionale të mundshme.

Stafi mësimdhënës i UBT-së ka vizituar universitetet më prestigjioze, ku janë trajnuar në përdorimin e të gjitha pajisjeve moderne, që në mënyrë direkte do të transmetohen edhe tek studentët, të cilët do të përgatiten për të punuar me pajisjet më të sofistikuar që momentalisht gjenden në tregun medial.



Ndërmarrësia dhe digjitalizimi, temë bosht e diskutimit të hapur që ndërmarrësi amerikan, Ari Zoldan e pati me studentët e UBT-së



Drejtori ekzekutiv i Quantum Media Group, Ari Zoldan mbajti një diskutim të hapur dhe shumë interkativ me stafin dhe studentët e UBT-së, ku u trajtuan mënyrat dhe hapat që i shtynë ndërmarrësit drejt suksesit, për mediat dhe fuqinë e tyre, si dhe për ndikimin e digjitalizimit në nivel global.

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi tha se ndarja e përvojave nga ndërmarrës të suksesshëm në tregun amerikan, është modeli më i mirë edhe për ndërmarrësit e ardhshëm kosovarë, që të kenë sukses në tregun tonë.

Drejtori ekzekutiv i Quantum Media Group, Ari Zoldan tha se hapi i parë që ndërmarrësit duhet të ndërmarrin çdo ditë, është që të definojnë suksesin dhe të punojnë që të njëjtin ta arrijnë, e sipas tij, vetëm në këtë formë arrihet brendimi i vetes dhe produktit.

“Ndërtimi i brendit personal është investimi në veten tuaj, e tek më vonë i shtohet vlera dhe kuptimi ndërlidhjes së brendit me audiencën”, theksoi ai.

Ai i këshilloi studentët që të punojnë me veten e tyre dhe t'i gjejnë mangësitë që mungojnë në tregun kosovar, sepse në këtë formë rrjedhin inovacionet dhe sukcesi i tyre.

Në fund, studentët dhe stafi i UBT-së parashtruan pyetje për format më efektive të brendimit, për taktikat e gjetjes së mangësive në treg dhe për mënyrat se si dikush mund të bëhet influencues në rrjete sociale.

Dhjetëra produkte ushqimore ekspozohen e konsumohen në Panairin e Produkteve Ushqimore të UBT-së

Dhjetëra kompani e udhëheqës të tyre, bashkë me qindra studentë të UBT-së, e pasuruan Panairin e Produkteve Ushqimore të UBT-së, në u ekspozuan produkte ushqimore nga më të ndryshmet.

Krahas produkteve të prodhuara nga kompanitë vendore, vlerë e shtuar e këtij panairi ishin edhe ushqimet e përgatitura nga studentët e Fakultetit Shkencë të Ushqimit dhe Bioteknologji, që u pëlqyen jashtëzakonisht shumë nga pjesëmarrësit në panair.

Në hapje të ngjarjes, rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi tha se në këtë moment është tejet i rëndësishëm bashkëpunimi i ngushtë dhe i mirëfilltë ndërmjet akademisë dhe industrisë.

“Në çdo shtet të zhvilluar të botës gjërat ecin siç duhet sepse academia dhe industria punojnë së bashku dhe studentët i shndërrojnë në ekspertë të secilës fushë. UBT është gjithmonë gati që të ndihmojë industrinë dhe kompanitë në secilën fushë që kanë nevojë, e këtë mund ta bëjmë me nivel të lartë të përgjegjësisë dhe kompetencës, gjë për të cilën edhe jemi dëshmuar”, theksoi ai.

Ai, bashkë me prodhuesit e shumtë vendorë të produkteve ushqimore, vizituan laboratorët e sofistikuar të UBT-së, ku kryhen të gjitha përgatitjet dhe testimet e cilësisë së produkteve, teksa prodhuesit kosovarë treguan interesim të lartë për bashkëpunim me UBT-në, për zgjidhjen e problemeve me të cilat po përballen aktualisht.

Panairi i Produkteve Ushqimore u pasurua falë kompanive vendore që morën

pjesë dhe të cilat ekspozuan produktet e tyre, për t'i dhënë shtytje përdorimit dhe përkrahjes së produkteve të vendit.

Kompanitë që morën pjesë ishin: VIPA Chips, Birra Peja, Fluidi, ABI, Gazi-com, Kompania Fitimi, Komnia Fungi dhe KABI.



Vizita studimore

Studentët e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor vizituan punishten më të madhe në Prizren



Studentët e Fakulteti të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në Prizren, realizuan vizitë studimore në punishten më të madhe në Prizren, me sipërfaqe ndërtuese prej 50000m².

Vizita është organizuar në kuadër të modulit “Bazat e konstruksionit të betonit të armuar, dru dhe çelik”.

Qëllimi i kësaj vizite ishte që studentët të shohin nga afër procesin e punës në këtë punishte, të fitojnë njohuri shtesë rreth elementeve konstruktive në varësi të materialeve të ndërtimit të analizuar në punishte, si dhe konstruksionin e betonit dhe çelikut. Fakulteti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, vazhdimisht po organizon vizita të karakterit studimor, me qëllim të ndërlidhjes së teorisë dhe praktikës, si dhe me qëllim që studentët të përfitojnë njohuri e përvoja profesionale.

Studentët e UBT-së vizitojnë ndërmarrjen prodhuese “Stone Castle”

Studentët e Fakultetit të Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë kanë realizuar vizitë studimore në Rahovec me ç’rast kanë parë nga afër proceset e prodhimit të verërave sipas varieteteve të tyre.


Vizita është bërë nën shoqërimin e profesorëve, Violeta Lajqi Makolli, Hamëz Rama dhe Luljeta Ajdini.

Studentët janë pritur nga stafi i fabrikës të cilët u shpjeguan studentëve në detaje për ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të prodhimit që nga lënda e parë, përpunimi i rrushit, mushtit dhe verës, si dhe proceset e fermentimit, sulfimit, filtrimit, stabilizimit, ajrosjes, qartësimit, vjetërsimit në burela, e deri tek procesi i paketimit si produkt final për shitje.

Me këtë rast studentët u shprehën të kënaqur me realizimin e vizitës së tillë studimore, pasi që sipas tyre, institucioni UBT po u mundëson ndërlidhjen e teorisë me praktiken.



Studentët e UBT-së vizituan Komunën e Prishtinës



Studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës, konkretisht të specializimit “Menaxhim dhe Teknologji”, kanë realizuar vizitë studimore në Komunën e Prishtinës.

Vizita është bërë në kuadër të lëndës “Rregullativa ndërtimore”, nën udhëheqjen e profesorëve, Ramë Hamzaj dhe Nexhmi Krasniqi.

Gjatë kësaj vizite studentët u pritën nga shefja e urbanizmit, Lendita Beçiraj-Çeku dhe zyrtarja për urbanizëm, Nazife Krasniqi, të cilat i njoftuan me procedurat e pranimit të kërkesave dhe dokumentacioneve.

Tutje, ata vizituan edhe sektorin e planifikimit hapësinor, sektorin e ndërtimit dhe sektorin e mbrojtjes së mjedisit dhe efijencës.

Në secilin sektor studentët u njoftuan nga zyrtarë të tyre mbi punën dhe funksionimin e punëve brenda sektorëve.

Studentët e Inxhinierisë Ndërtimore vizituan laboratorin “GEOKOS A&A”

Studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës kanë vizituar laboratorin e gjeomekanikës, “GEOKOS A&A”, me seli në Prishtinë, të shoqëruar nga ligjëruesit në UBT, Hysen Ahmeti dhe Hazir Çadraku. Qëllimi dhe rëndësia e kësaj vizite ishte që studentët të mësojnë se si të zbatojnë studimin teorik në atë praktik, duke parë se si nxirren mostrat nga shpimet në terren dhe sjellja e tyre në laborator për analizim dhe nxjerrje të parametrave fiziko-mekanikë, përfshirë peshën vëllimore, peshën specifike, lagështinë natyrore, përbërjen granulometrike, plasticiteti-kufijitë e Atterberg-ut, shkallën e ngopshmërisë, porozitetin, densitetin, metodën e proktorit të modifikuar, ASTM D-698: AASHTO T-99, etj.

Studentet arritën të njohin nga afër ecurinë e punës laboratorike për nxjerrjen e parametrave fiziko-mekanikë, ku studentët u ndanë të kënaqur nga kjo vizitë, teksa bashkëpunimi do të vazhdojë edhe me tej ndërmjet UBT dhe laboratorit “GEOKOS A&A”.

Studentët e Arkitekturës vizituan Prekazin – Marrin ide për projektimin e ndërtesave kulturore

Studentët e vitit të dytë të Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, kanë realizuar vizitë studimore në Prekaz, me ç’rast ata kanë marrë ide mbi dizajnimin dhe projektimin e ndërtesave kulturore, respektivisht Muzeun e Luftës së Kosovës, si Palimpsest i Kompleksit Memorial-Historik në Prekaz.

Kjo vizitë është bërë me qëllim të informimit, përjetimit, observimit dhe analizimit të lokacionit ku do të punohet detyra semestrare.

Vizita është bërë në kuadër të lëndës “Studio Dizajn 2”, teksa studentët kanë të shoqëruar nga ligjërueset në UBT, Arnisa Kryeziu dhe Sadije Kelmendi.

Studentët e UBT-së vizitojnë punimet e autostradës “Arbën Xhaferi”

Studentët e nivelit master të Fakultetit Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastrukturë, në UBT, kanë vizituar punimet që po bëhen në autostradën “Arbën Xhaferi”, në relacionin rrugor Prishtinë-Shkup.

Kjo vizitë është zhvilluar në kuadër të lëndës Projektimi i Autostradave, ku panë nga afër procesin e punëve që po realizohen nga kompania e njohur “Bechtel & Enka”. Me këtë rast, studentët janë njoftuar me ndërtimin e urave që po bëhen në kuadër të projektit, vendosjen e barrierave mbrojtëse, shtresat, llojet dhe përbërjen e asfaltit, etj.

Fakulteti Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastrukturë në UBT, gjatë gjithë vitit akademik organizon vizita të shumta me karakter studimor ku vëzhgojnë nga afër realizimin e punëve në objekte të ndryshme, autostrada dhe rrugë regjionale.

Studentët e Ndërtimtarisë vizituan Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Studentët e vitit të dytë të nivelit master në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturë në UBT, kanë vizituar Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në kuadër të lëndës Rregullativat Ndërtimore dhe Vlerësimi Mjedisor. Qëllimi i kësaj vizite ishte që studentët të njoftohen lidhur me aktivitetet që zhvillohen në këtë departament. Studentët janë pritur nga drejtori i departamentit të mjedisit të kësaj ministrie, Muhamet Musliu dhe profesori Ramë Hamzaj. Drejtori Musliu u tha studentëve se në bazë të legjislacionit për objektet ndërtimore kërkohet vlerësim strategjik mjedisor, kurse për objektet tjera vlerësim i ndikimit në mjedis. Po ashtu, ai tha që në këtë ministri vlerësimi mjedisor fillon nga projekti ideor dhe vazhdon deri tek fillimi i shfrytëzimit të objekteve ndërtimore. Sipas tij, ky departament kryen punë administrative dhe profesionale dhe merret me lëshimin e lejeve, certifikatave dhe vërtetimeve në kërkesat e personave fizik dhe juridik, bazuar në legjislacionin për mbrojtjen e natyrës.

Vizita studimore

Studentët e UBT-së vizituan autoudhën “Ibrahim Rugova”



Studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës, përkatësisht të specializimit të Komunikacionit dhe Infrastrukturës, kanë realizuar vizitë studimore në autoudhën “Ibrahim Rugova”, konkretisht pjesën Arllat-Suharekë, me ç’rast në fokus kanë qenë elementet e pajisjeve dhe të sinjalizimit të autoudhës, si elemente të rëndësishme në sigurinë e komunikacionit rrugor.

Gjatë vizitës studimore në autoudhë studentët, të shoqëruar nga profesori Nol Dedaj, kanë evidentuar disa elemente të rrugës, të cilat paraqesin një rrezik potencial për aksidente të komunikacionit, përfshirë mosmirëmbajtjen e pahijeve elastike, pusetat për përcjelljen e ujët janë mbuluar nga mbeturinat, mungesa e kapakëve të pusetave rrezikon qarkullimin e automjeteve, disa nga shenjat për lajmërim apo për rrezik nuk janë vendosur në vende të duhura, si dhe sinjalizimi vertikal është vendosur në bazë të standardeve evropiane.

Vizita të ngjashme po mbahen në vijimësi, me qëllim të bashkërendimit të pjesës teorike dhe praktike të studimeve.

Studentët e UBT-së, vizituan Fabrikën e Përpunimit të Ujit në Shkabaj

Studentët e nivelit master në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës në UBT, konkretisht ata të specializimit për Hidro, nën shoqërimin e profesorit Ilir Abdullahu, kanë realizuar vizitë studimore objektin e Fabrikës së Përpunimit të Ujit në Shkabaj.

Vizita kishte për qëllim njohjen nga afër me proceset e përpunimit të ujit, teksa studentët u pritën nga menaxheri i fabrikës, Veli Gashi, i cili u tregoi studentëve proceset nëpër të cilat kalon përpunimi i ujit dhe përbërësit e nevojshëm

që i shtohen ujit për pirje. Tutje, ai bëri të ditur se kjo fabrikë ka kapacitet të madh të përpunimit të ujit falë instalimit dhe aplikimit të teknologjisë moderne. Sipas tij, nga kjo fabrikë, me ujë të pijes furnizohet Prishtina, Podujeva, Obiliqi, Fushë Kosova dhe Graçanica.

Gjithashtu, studentët vizituan sistemin e pompimit, operimit dhe monitorimit përmes SCADA-s, sistem ky i cili mbledh dhe përpunon të dhënat në kohë reale, njëherësh panë edhe modele tjera hidroteknike që aplikohen nga fabrika.



Studentët e UBT-së vizituan objekte banesore dhe afariste në Prishtinë



Studentët e Fakultetit të Ndërtimit dhe Infrastrukturës në UBT, kanë realizuar vizitë studimore në objektin 42-katësh dhe objektin banesor të kompanisë “Nartel” në Prishtinë. Vizita është realizuar në kuadër të lëndës Organizim dhe Teknologji Ndërtimore, nën shoqërimin e profesorëve Muhamet Ahmeti dhe Anjeza Alaj.

Studentët janë pritur nga përfaqësuesit e kompanive në fjalë, të cilët i njoftuan me proceset e ndërtimit dhe rrjedhën e punimeve.

Tek objekti 42-katësh studentët patën mundësinë të shohin kantieret e ndërtimit, masat që ndërmerren për siguri në punë, teksa panë edhe sanimin e strukturës për shkak të ndryshimeve që ndodhin në projekt, si dhe sistemin skeletor të objektit.

Ndërsa, fokusi i vizitës në objektin banesor ishte fasada strukturale dhe teknologjia e montimit të saj.

Studentët vizituan laboratorin për testim të materialeve ndërtimore “Proing”

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës në UBT, vazhdimisht po organizon vizita të karakterit studimor nëpër kompani vendore dhe jo vetëm, me qëllim të ndërlidhjes së teorisë dhe praktikës, si dhe për përfituar njohuri e përvoja profesionale. Së fundmi, studentët e vitit të dytë të Fakultetit Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës në UBT, kanë vizituar laboratorin për testim të materialeve ndërtimore “Proing” në Prishtinë, në kuadër të lëndës Teknologjia e Betonit.

Në këtë laborator, studentët patën rastin të realizonin disa teste të cilësisë dhe rezistencës së materialeve të betonit apo çimentos.

Studentët bashkërisht me teknikët e laboratorit “Proing”, i diskutuan edhe mostrat që ata i kanë zhvilluar në laboratorin inovativ të UBT-së, me ç’rast komentuan rezultatet e fituara përfshirë masën vëllimore, peshën specifike, rezistencën e shtypjes etj.

Studentët e Shkencave të Ushqimit vizituan fabrikën e vajit “Floil”

Studentët e vitit të parë në Fakultetin Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT, kanë realizuar vizitë studimore në fabrikën për prodhimin e vajit ushqimor “Floil” në komunën e Gjilanit. Vizita është realizuar në kuadër të lëndës Hyrje në Shkencat e Ushqimit, nën shoqërimin e profesorëve përkatës.

Ata u pritën nga menaxherët e fabrikës, me ç’rast u kanë treguar studentëve ka shpjeguar studentëve për procesin e përpunimit të këtij vaji ushqimor.

Gjithashtu, studentët panë nga afër laboratorët e fabrikës në fjalë dhe u njoftuan në detaje lidhur me analizat dhe llojet e analizave që ata bëjnë për të matur cilësinë e vajit.

Studentët e Shkencave të Ushqimit vizituan fabrikën për përpunimin e mishit “Calabria”

Studentët e vitit të parë të Fakultetit Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji në UBT, kanë realizuar vizitë studimore në fabrikën për përpunimin e mishit “Calabria” në komunën e Gjilanit.

Vizita është realizuar në kuadër të lëndës Hyrje në Shkencat e Ushqimit, nën shoqërimin e profesorëve përkatës.

Ata u pritën nga pronari i fabrikës Xhelal Selimi, i cili u ka shpjeguar studentëve për lëndën e parë në industrinë e mishit, si dhe për prodhimin e produkteve tjera nga mishit.

Ai potencoi se kapaciteti i plotë i prodhimit ditor është therja e mbi 700 krerë gjedhë, teksa sipas tij, produktet e përpunuara janë të cilësisë së lartë. Tutje, ai tha se në të ardhmen do ketë bashkëpunim mes fabrikës dhe UBT-së, në fushat që janë në interes për dyja palët.

Fakulteti i Shkencave Politike

Programi i Shkencave Politike në UBT, fakultet që ju siguron diplomë të dyfishtë dhe të njohur ndërkombëtarisht

Ekspertizat dhe përvojat profesionale në këtë program japim profesorë vendorë dhe ndërkombëtarë, që njëherësh janë edhe zyrtarë institucionesh ose kanë përvojat shume vjeçare në organet politikbërëse në vend dhe jo vetëm. Ata janë pjesë e një procesi mësimor në përputhje me standardet bashkëkohore dhe shërbejnë si burim i rëndësishëm i njohurive teorike dhe praktike për studentët përgjatë mësimnxënies. Por, sigurisht që edhe profesorët e Shkencave Politike në UBT, janë të kualifikuar me grada shkencore të mbrojtura në universitetet më me renome ndërkombëtare

Fakulteti i Shkencave Politike në UBT është themeluar qe shtatë vite duke u mbështetur para së gjithash në nevojat praktike dhe ideologjike të shtetit të ri të Kosovës, interesat e shtuar të të rinjve të vendit për shkenca politike, si dhe ambicien e themeluesve dhe drejtuesve të UBT-së për t'i ofruar vendit mundësi për studime cilësore në këtë fushë.

Që prej vitit akademik 2013/2014, kur filloi studimet gjenerata e parë e studentëve, interesimi i të rinjve për këtë fakultet është rritur krahas rritjes së profesorëve. Ekspertizat dhe përvojat profesionale në këtë program japim profesorë vendorë dhe ndërkombëtarë, që njëherësh janë edhe zyrtarë institucionesh ose kanë përvojat shume vjeçare në organet politikbërëse në vend dhe jo vetëm. Ata janë pjesë e një procesi mësimor në përputhje me standardet bashkëkohore dhe shërbejnë si burim i rëndësishëm i njohurive teorike dhe praktike për studentët përgjatë mësimnxënies. Por, sigurisht që edhe profesorët e Shkencave Politike në UBT, janë të kualifikuar me grada shkencore të mbrojtura në universitetet më me renome ndërkombëtare.

Krahasuar me fakultete të tjerë të ngjashëm të Kosovës, por edhe të rajonit, Fakulteti i Shkencave Politike të UBT-së ka veçoritë e veta që mund të shërbejnë për ta shquar atë prej të fakulteteve të tjerë të ngjashëm.

Para së gjithave, ky Fakultet është pjesë përbërëse e një institucioni si UBT i cili është vlerësuar me katër yje të ekselencës nga ekspertë ndërkombëtarë të fushës përkatëse. Gjatë javës së mesit të prillit 2019, UBT ka qenë e përfshirë në një proces të ri vlerësimi ndërkombëtar për të marrë yllin e pestë dhe më të lartë të ekselencës.

Së dyti, janë standardet e larta cilësore të mësimdhënies ata që e shquajnë si këtë program ashtu edhe të gjithë fakultetet e tjerë të UBT-së. Në Fakultetin e Shkencave Politike, mësimi teorik është i ndërthurur ngushtë me studimin vetjak, diskutimet teorike, mësimin praktik, pjesëmarrjen në projekte dhe studime të ndryshëm, pjesëmarrjen në konferenca shkencore, vizita studimore etj.

Së treti, nëpërmjet themelimit të dy veprimtarive të përvitshme si Konferenca Shkencore Ndërkombëtare që mbahet në muajin tetor dhe Shkolla Verore në fillim të korrikut, si profesorëve edhe studentëve u janë krijuar kushtet më të mira për të qenë të pranishëm dhe pjesëmarrës në veprimtaritë shkencore të fushave politike të studimeve. Këto veprimtari shërbejnë edhe ndërlidhëse me veprimtarinë akademike ndërkombëtare, me nevojat e shtetndërtimit të Kosovës dhe me nevojat e integritimeve euroatlantike të saj.

Së katërti, Fakulteti i Shkencave Politike shquhet për organizimin e shpeshtë dhe të rregullt të veprimtarive të ndryshme me të ftuar zyrtarë të ndryshëm të institucioneve politike dhe diplomatike vendas dhe të huaj. Këto veprimtari ju japin studentëve njohuri shtesë nga zhvillimet në fushën e politikës dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare. Pikërisht për këtë synim është krijuar dhe vepron Forumi i Shkencave Politike ku organizon thaujse për çdo javë aktivitete të tilla folës dhe të ftuar, ku ndajnë me studentët përvojat e tyre të punës nëpërmjet ligjërimeve mbi tema të veçanta dhe diskutimeve të shoqëruara me pyetje dhe përgjigje. Në mënyrë të veçantë Forumi mundëson edhe krijimin e lidhjeve ndërmjet studentëve dhe të ftuarve të veprimtarive nëpërmjet të cilave studentët informohen, shfaqin interesat e tyre për probleme të ndryshme, apo për punësimin e tyre.

Së pesti, ky fakulteti ofron mundësi të shumta dhe mbështet vizitat studimore të shpeshta të studentëve në institucionet më të rëndësishëm të vendit si Kuvendi i Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Mbrojtjes, etj. Po ashtu, studentëve u mundësohet që të bëjnë vizita studimore edhe në vendet e rajonit ku vizitojnë institucione të rëndësishëm të shtetit.

Së gjashti, Fakulteti i Shkencave Politike shquhet edhe për një marrëdhënie bashkëpunuese shumë të veçantë profesor-student ku shprehet në veprimtari shkencore të përbashkëta, në studimet e veçanta që ata ndërmarrin, në punimet shkencore të vetë studentëve, në artikujt shkencorë të përbashkëta, në sondazhe të opinionit publik për çështje të ndryshme, etj.

Fakulteti i Shkencave Politike ka tri specializime të veçanta të nivelit bachelor të cilat janë: "Marrëdhëniet Ndërkombëtare", "Administrimi Publik" dhe "Integritet Evropian".

Mbështetur në marrëveshjet përkatëse të UBT-së, studentët e këtij Fakulteti kanë mundësi që të kryejnë një apo më tepër semestër procesit mësimor në universitete të tjerë jashtë vendit, si p.sh. në Varshavë, Vjenë, Salzburg, Lubjanë, etj., ndërsa studentët që i kanë përfunduar studimet themelore kanë mundësi të kryejnë studime master në Kosovë dhe në vende të tjera të rajonit ose të Evropës, kjo falë programit Erasmus+ të BE-së.

Vitin shkollor 2018/19, në UBT studentët janë duke vijuar studimet në specializimin "Administrim Publik", në nivelin master, ndërkaq së shpejti, pritet të akreditohen edhe dy specializimet: "Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Diplomci"



Fakulteti i Shkencave Politike ka tri specializime të veçanta të nivelit bachelor të cilat janë: "Marrëdhëniet Ndërkombëtare", "Administrimi Publik" dhe "Integritet Evropian" : Dr. Arian Starova, dekan i Fakultetit Shkenca Politike në UBT

dhe "Studime të Sigurisë Ndërkombëtare". Arsyet se përse studentët duhet të studiojnë në Fakultetin e Shkencave Politike janë përgjithësisht të dy llojeve. E para, është arsyeja e përgjithshme se shkencat politike po bëhen gjithnjë dhe më të larmishme dhe të specializuara dhe roli i tyre po rritet përherë dhe më shumë në botën e stome kaq shumë të ndërvarur. Shkencat politike si pjesë e pandarë e shkencave shoqërore, janë një fushë e dijes dhe e studimeve dhe një profesion ku pafundësia e dijes, ndoshta, ndjehet më shumë dhe më shpejt se në fushat e tjera të studimeve dhe profesionet e tjerë. Prandaj në këtë fushë, përpjekja për të studiuar duhet t'i përngjajë përpjekjes për të kapur diçka që është e pafundme, çka mund të arrihet duke lexuar dhe u përpjekur sa më shumë në fushën e të menduarit dhe të të arsyetuarit. Çelësi i suksesit në shkencat politike është dija sa më e gjerë. Dhe natyrisht, gjithnjë do të ketë njerëz të interesuar dhe para së gjithave të rinj të interesuar për këto fusha.

Tri arsyet e tjera janë të veçanta të lidhura me Fakultetin e Shkencave Politike të UBT-së.

E dyta, me punë dhe përpjekje 18 vjeçare është themeluar Fakulteti i Shkencave Politike me mësimdhënie shumë cilësore dhe ku të gjithë profesorët janë me grada shkencore dhe plotë ambicie për t'u kualifikuar më tej si mësimdhënës dhe shkencëtarë. Kjo përbën një mundësi të mrekullueshme për studentët.

E treta, mundësitë e studentëve që përfundojnë këtë Fakultet për punësim janë shumë të mira, në Kosovë, në rajon, apo jashtë rajonit, në Evropë dhe në botë. Shkencat politike nuk janë vetëm një fushë studimi, por edhe veprimtari e gjallë shoqërore. Kjo është një arsye madhore që krahas studimit i nxit studentët që të mendojnë edhe për realitetin shoqëror dhe politik që i rrethon duke u përpjekur që të ndikojnë mbi të në dobi të më të mirës për të gjithë vendin, Kosovën.

E katërta, Fakulteti i Shkencave Politike në UBT, ofron mundësi të gjera për studime bachelor dhe master në universitete njohura jashtë vendit. E numri i studentëve që prej UBT-së vijojnë studimet jashtë vendit, nga viti në vit rritet. Por, edhe një numër i madh i tyre punësohen në institucione të shtetit, ose për ta është tregohet interes për t'i punësuar që në vitet e para të studimeve.

Studio Media dhe Komunikim në UBT, zhvillohu profesionalisht në fushën e gazetarisë

Gjatë tri viteve të studimit, studentët do të njihen me teorinë e Medias dhe të Komunikimit, si dhe me praktikën në këto fusha, duke u mundësuar që pos teorisë të zhvillojnë edhe praktikën nëpër institucionet e ndryshme shtetërore, publike e private që kanë të bëjnë me media dhe komunikim. Në këtë mënyrë, studentët do të jenë në gjendje të punojnë në institucione shtetërore, publike e private të fushave të ndryshme që ndërlidhen me Media dhe Komunikim, edhe atë: Moderatorë studiosh televizive; Moderator studiosh në radio; Gazetarë terreni; Fotoreporterë; Kameramanë; Montazherë; Regjisorë programesh; Shërbyes në marrëdhënie me publikun; Zëdhënës të subjekteve të ndryshme politike dhe jopolitike; Zyrtarë për informim; etj.



Programi për Media dhe Komunikim, që ofrohet nga UBT, ka parasysh hulumtimin e nevojave për kuadro në fushën e Mediave dhe të Komunikimit në Kosovë. Ky program është strukturuar në atë mënyrë që studentëve t'u ofrojë kombinim të teorisë dhe praktikës. Programi akomodon një shumëllojshmëri të gjerë të përkatësive dhe mjediseve mësimore: Dr. Ferid Selimi, dekan i Fakultetit Media dhe Komunikim

Programi për Media dhe Komunikim, që ofrohet nga UBT ka parasysh hulumtimin e nevojave për kuadro në fushën e Mediave dhe të Komunikimit në Kosovë. Ky program është strukturuar në atë mënyrë që studentëve t'u ofrojë kombinim të teorisë dhe praktikës.

Programi akomodon një shumëllojshmëri të gjerë të përkatësive dhe mjediseve mësimore.

Curriculi është i përshtatshëm për të diplomuarit e rinj të shkollave të mesme, profesionistëve që kërkojnë për të përmirësuar aftësitë e tyre dhe profesionistët nga fusha të tjera që kërkojnë një ndryshim në karrierë.

Duke ndjekur aspektet teorike ushtrojnë praktikën në industrinë e medias, Fakulteti Media dhe Komunikim inkurajon studentët që të zhvillojnë aftësitë e tyre në forcimin e ndërgjegjësimit shoqëror. Gjatë tri viteve të studimit, studentët do të njihen me teorinë e Medias dhe të Komunikimit, si dhe me praktikën në këto fusha, duke u mundësuar që pos teorisë të zhvillojnë edhe praktikën nëpër institucionet e ndryshme shtetërore, publike e private që kanë të bëjnë me media dhe komunikim. Në këtë mënyrë, studentët do të jenë në gjendje të punojnë në institucione shtetërore, publike e private të fushave të ndryshme që ndërlidhen me Media dhe Komunikim, edhe atë: Moderatorë studiosh televizive; Moderator studiosh në radio; Gazetarë terreni; Fotoreporterë; Kameramanë; Montazherë; Regjisorë programesh; Shërbyes në marrëdhënie me publikun; Zëdhënës të subjekteve të ndryshme politike dhe jopolitike; Zyrtarë për informim; etj..

Fakulteti Media dhe Komunikim ka për qëllim që studentëve t'u ofrojë dije teorike dhe praktike, në mënyrë që kuadrot e dala nga ky institucion të kryejnë me sukses punët në organizatat ku do të punojnë, duke performuar të gjitha format e komunikimit jo vetëm në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhë të tjera botërore. Programi i studimeve është dizajnuar në atë mënyrë që studentët t'i aftësojë në aspektin medial dhe komunikues.

Nëpërmjet dijeve teorike të medias, ata do të njihen me më të rejat dhe zhvillimet e mediave në tërësi, ndërsa nëpërmjet dijeve teorike të komunikimit do të aftësohen në përdorimin e formave dhe llojeve të ndryshme të komunikimit. Programi i studimeve ka për qëllim të zhvillojë aftësitë e studentëve për format e komunikimit, të analizojnë e të kuptojnë marrëdhëniet mes medias dhe audiencës brenda një konteksti të ndryshimit në kulturën politike dhe në media dhe në teknologji të informacionit. Gjithashtu shqyrton mënyrat të cilat qytetarët, aktivistët e politikanët dhe gazetarët ndryshojnë formën dhe natyrën e sferës publike nëpërmjet zhvillimit të teknologjive të reja, duke thyer barrierat tradicionale midis shtetit, medias dhe publikut. Prandaj, si i tillë, programi Media dhe Komunikim domosdo në plan të parë ka zhvillimin profesional të studentit. Duke pasur parasysh që mësimdhënia efektive është bazë për të nxënëit e suksesshëm, UBT është përkujdesur që në radhët e veta të angazhojë mësimdhënës me përvojë, e që studenti jo vetëm që lidhet thjesht me informimin, por edhe me të mësuarit e metodave të shpjegimit, kontrollit, dhe të njohurive të reja, si dhe motivimin e tyre. UBT është përkujdesur që të nënshkruaj marrëveshje me ministri përkatëse dhe me kryetarë të disa komunave në Republikën e Kosovës, me qëllim të bashkëpunimit në zhvillim dhe implementim të projekteve në fusha të ndryshme jetësore që janë në interes të përbashkët të ministrive, komunave dhe UBT-së. Në sajë të këtyre marrëveshjeve, studentët e UBT-së përfitojnë duke u inkuadruar në programe të ndryshme si dhe duke përfutuar nga puna praktike në këto komuna.

UBT ka një ambient të përshtatshëm për studime. Ka Campusin në hyrje të Lipjanit dhe Campusin kryesor në Prishtinë. Në kuadër të Campusit në Prishtinë e në hyrje të Lipjanit funksionojnë klasat e përshtatshme për leksione e ushtrime, amfiteatri, Biblioteka, laboratorët, radio, gazeta, revista, etj. Klasat janë të pajisura me të gjitha mjetet e përshtatshme për mësim e ushtrime, si: bankat, ulëset, projektorët, dërrasat, pëlhurat, air-conduction, etj..

Fakulteti Media dhe Komunikim në UBT zhvillon procesin mësimor dhe atë të kërkimit shkencor bazuar në një infrastrukturë të pajisur mirë me pajisjet e nevojshme dhe ato mbështetëse në nivel të lartë. Një element i rëndësishëm i sigurimit të transparencës akademike në institucion është edhe Sistemi Informativ i Menaxhimit të Shkollës (SMIS), i cili mundëson informim efikas për studentët dhe stafin menaxhues. Infrastruktura, në të cilën zhvillon aktivitetin Fakulteti Media dhe Komunikim ka të ngritur Zyrën e pritjeve dhe të informacionit, zyrat e personelit akademik dhe administrativ, Bibliotekën, Zyrën e Teknologjisë Informative, Sallën për organizimin e punës në redaksi, Qendrën e Studentëve, Qendrën e Karrierës, Qendrën për Transferimin e Teknologjisë pjesë e Institutit për Inovacionin dhe Zhvillimin e Ndërmarrësisë në UBT (RIED), UBT Stats dhe UBT Campus, Radion, si edhe shërbime të tjera lehtësuese.

Prandaj, duke pasur për bazë këto të dhëna që flasin për seriozitetin dhe kujdesin që UBT tregon ndaj studentit, secili i ri dhe secila e re që vendos për studime bachelor dhe master, e që do të bëhet më i miri, le të zgjedh UBT-në, sepse vetëm nëpërmjet studimeve që bën në UBT, do të bëhet më i miri.

Kur gazetaria online viktimizohet nga rrjetet sociale, cilat janë sfidat e profesionistëve?

Sulmi ndaj një gruaje të pafajshme, me aq brutalitet fizik e mediatik, flet qartë për probleme serioze etike dhe teknike në fushën e gazetarisë. Këto sulme jo profesioniste nga fusha e gazetarisë online do të vazhdojnë të ndodhin edhe në të ardhmen, nëse nuk imponohet një edukim medial nga ana e vet pronarëve, redaktorëve dhe gazetarëve. Rrjetet sociale vazhdojnë ta infektojnë gazetarinë e shëndoshë online, e cila ndonëse me numër të kufizuar për nga korrektësia e objektiviteti, vazhdon të jetë e pranishme. Gazetarët, patjetër duhet t'i përmbahen maksimës së njohur "hulumto, verifiko dhe raporto", të ruajnë etikën dhe kodet e saj, të ruajnë atë pak kredibilitet dhe ndershmëri profesionale në gazetari. "Kur bie telefoni në mesnatë, zjarrfikësit i duhet vetëm të veshë pantallonat dhe të shuaj flakët. Kurse gazetari duhet t'u tregojë një milion vetave se kush e ndezi shkrepësen dhe pse". (Mort Rosenblum, Associated Press)

E mora jo rastësisht këtë citat, sepse mendoj se është shumë aktuale në këto sulmet e fundit ndaj një gruaje rome dhe jo vetëm asaj. Fitili nxitës ishin rrjetet sociale të shumta dhe të pakontrolluara. Ishin rrjetet falso ato që i dhanë publicitet negativ dhe shkatërrimtar një rasti, i cili pastaj si lajm i rremë u bartë si rrufeja tek portalet kryesore.

Nuk dëshiroj të minimizojë përgjegjësinë që kanë shumica e portaleve që kanë transmetuar një lajm kaq jo etik dhe kaq jo profesional, por dua që të vë në spikamë mënyrën se si portalet shërbehen nga rrjetet sociale, mënyrën se si infektohen ose viktimizohen nga këto rrjete sociale.

Krejt filozofia e gazetarisë hulumtuese dhe profesionale qëndron tek e vërteta. Pra, si ta themi të vërtetën, si ta bindim publikun dhe lexuesin që jemi objektiv dhe jemi etik në atë që themi. Kjo është lufta e çdo mediumi dhe e çdo gazetari të sinqertë, të ndershëm dhe të përkushtuar.

Në këtë rast, dëmi nuk është vetëm fizik, por edhe dëm etik, madje i pariparueshëm. Nëse hyni nëpër rrjete sociale, shumica e komentuesve etiketojnë dhe fyejnë portalet, pra gazetarinë online e cila dallon shumë në thelb nga rrjetet sociale.

Në facebook as që pritet diçka më mirë, meqenëse niveli i atyre që komentojnë në fushën e medias, është periferik, por i kushtueshëm për portalet, sepse në pyetje është kredibiliteti dhe besueshmëria e tyre.

Ku gabuan portalet?

E di që mund të ketë mospajtime edhe nga kjo kategori e medias, por ne duhet të pranojmë gabimet kur rrëshqasim profesionalisht. Tek e fundit gabimet mund të jenë njerëzore dhe mund të korrigjohen, kur distancohesh prej tyre me kohë. Viktima janë kryesisht portalet që nuk i verifikojnë lajmet nga rrjetet sociale, por i marrin dhe i publikojnë si të vërteta. Shpesh dëgjoj nga kolegët teksa arsyetohen se ne po e citojmë burimin. Ju lutem raportimi për situatat e ndjeshme, situatat e jashtëzakonshme, raportimi për krimet, dhunën etj kërkon shumë përgjegjësi, kërkon shumë llogaridhënie dhe verifikim. Edhe manipulimi i fotografisë ishte diçka e veçantë dhe sikur e porositur.

Të kthehemi tek çështja kryesore dhe ajo që po më shqetëson shumë dhe thjesht po ndihem në siklet kur po shoh e vërej gabime amatoreske.

Gjithmonë kam kërkuar dhe kam qenë i thartar i rregullimit të portaleve dhe tani fatmirësisht e kemi KMSHK, kemi kodet, kemi kriteret se çka duhet dhe çka nuk duhet të botojnë portalet. Por, është një gabim teknik i cili mund të zbatohet në momentin e regjistrimit të një portali. Jo gjithkush mund të bëhet pronar i një portali. Kam insistuar dhe propozuar që në momentin e regjistrimit të një portali, qoftë si biznes individual, kriter kryesor të jetë fakulteti i mbaruar i gazetarisë për themeluesin e portalit. Pse e them këtë dhe pse kjo është e domosdoshme? Një student që ka kaluar nëpër filtrat akademik dhe ka ndjekur ligjëratat e nevojshme në fushën e etikës, mënyrën e raportimit nga të gjitha situatat, ai asnjëherë nuk do të bëjë gabime fillestare që do ta dëmtojnë në thelb mënyrën e raportimit.

Pra jo të gjitha portalet kanë gabuar. Viktimë ranë portalet që u nxituan pas një lajmi të pa verifikuar. Amerikanët e kanë një thënie: "Edhe kur nëna të thotë të dua, prapë verifikoje". Pra mos ngurroni, mos hezitoni të bëni përpjekje që të merrni lajmin e duhur, lajmin e saktë e të vlerësuar nga të gjitha palët, sepse kredibiliteti i gazetarit ndërtohet vështirë, ndërsa rrënohet shumë lehtë dhe shpejt.

Shpejtësia e botimit të lajmeve, është sëmundje për shumë portale dhe kjo vështirë se mund të eliminohet aq shpejt. Tek e fundit, më mirë të jesh i dyti, por i saktë, se sa i pari dhe i pa saktë.

Në Amerikë, shtylla kryesore e gazetarisë është raportimi i fakteve të verifikueshme dhe ky është çelësi kryesor që duhet të zbatohet edhe tek ne dhe që po luftoj tash e sa kohë për këtë. Thjesht, raporto në mënyrë objektive dhe të dukshme dhe bëhu bindës ndaj burimeve dhe mos i keqpërdor apo mos i keqinterpretato ato.

Deniss McQuail, profesor i Universitetit të Amsterdemit, njëri nga teoricienët më të njohur të komunikimit masiv modern, etikën gazetareske e ka definuar me këtotribute:

- vërtetësia dhe saktësia
- paanshmëria dhe ndershmëria
- respekti i individualitetit dhe privatësisë
- pavarësia nga interesat e caktuara



Musa Sabedini, profesor në Fakultetin e Medias dhe Komunikimit

– përgjegjësia ndaj shoqërisë dhe të mirave shoqërore – respektimi i ligjit

– morali, bontoni dhe shija e mirë.

Ka shumë rëndësi që në rastet e tilla, pra të raportimit siç ndodhi me gruan rome, mediat të mos shfaqin paragjykime apo emocione. Janë tre minuta kohë që ju duhen për ta verifikuar një ngjarje sot në Kosovë, hiq më shumë. Jetojmë në një kohë kur teknologjia është shumë e avancuar dhe vetëm se duhet të dimë si ta përdorim mënyrën e teknikave të raportimit.

Kam përcjellë edhe raste të vdekjeve, vrasjeve apo vetëvrasjeve, ku portalet dhe gazetaret kanë bërë skandale. Në rastin e Hamdi Sopës, p.sh., kam hasur në një titull jashtëzakonisht të çuditshëm. "Hamdi Sopa është vrasë dhe pikë".

Shumë është e dobishme dhe e shëndetshme që gazetari në teren të mos rrëmbet nga emocionet që krijon vet ngjarja, por gjatë tërë kohës të qëndrojë i paanshëm dhe i drejtë me palët. Gjithmonë është e këshillueshme që t'u japim hapësirë palëve për të cilat jemi duke bërë lajmin, që ato të thonë qëndrimet e tyre dhe në veçanti të shmangim gjuhën e urretjes.

Gazetaria pas "like" po dëmton gazetarinë dhe shoqërinë

Shumë nga komentuesit e rrjeteve sociale, kur po ndodhin këto skena, zakonisht fajin e adresojnë te portalet, me arsyen se gjithçka po bëhet për një "like".

Nuk e përjashtoj edhe këtë mundësi, sepse shpejtësia e lajmeve në portale ka disa të mira, por edhe anët negative.

Fakti që botues e redaktor mund të jetë çdokush në brendësi të një portali, krijon edhe paqartësi në raportim apo besueshmëri të lajmit në aspektin etik.

Thjesht, skandalet e kësaj fushe vijnë pikërisht nga kjo kategori që prioritet mund ta ketë garën për klikime. Kjo kategori dëshmon se synim kryesor ka ndjekjen e "like"-ve si mënyrë për të arritur audiencën dhe realizuar anën financiare.

Dhe këtu kemi pastaj një defekt të pranishëm ku për punën e portaleve flasin njerëzit më jo kompetentë të mundshëm. Një gazetar, redaktor, ligjërues, profesor që nuk ka përjetuar punën e të bërit gazetari ditore online, ai e ka të vështirë ta kuptojë e lëre më të flas për median online. Tek ne të gjithë fatkeqësisht bëhen ekspertë, studiues të medias online.

Në mungesë të redaksive profesionale, në mungesë të redaktorëve të shkolluar e ngritur profesionalisht dhe në mungesë të gazetarëve nga terreni, po krijojmë dhe po rrezikojmë mënyrën e të bërit gazetari profesionale, në fakt po rrezikojmë vet ekzistencën e medias profesionale.

Vetërregullimi për median online ekziston, vetëm duhet ta zbatojmë në praktikë. Është Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK), i cili prej disa vitesh merret me vetërregullimin e portaleve dhe kjo ka qenë një dritare e mirë dhe një udhëzues i dobishëm për ato portale që i kanë pranuar kodet e etikës. Vetë fakti që ka ende portale që nuk dëshirojnë të jenë nën ombrellën e KMSHK, tregon qartë se ato dëshirojnë anarki në këtë profesion dhe papërgjegjësi ndaj publikut. Ndoshta nuk është bërë më e mira, por janë trajtuar qindra ankesa e raste interesante dhe serioze nga KMSHK. Pra rregullat i kemi, kriteret janë, kodet ekzistojnë dhe na mbetet që me ndershmëri profesionale, kredibilitet më të shtuar dhe rritje e edukim medial për ta bërë më të pranueshme dhe më të dobishme punën tonë të përditshme. Duhet ta duam këtë profesion më shumë se veten, ta respektojmë jetën private e shoqërore të secilit prej nesh, por mos të dorëzohemi në asnjë mënyrë në luftimin e të këqijave, dukurive negative, devijante, krimet të organizuar, mafias politike etj.

Fakulteti Sistemet e Informacionit, program unik që u mundëson studentëve dizajnimin dhe organizimin e sistemeve



Blerton Abazi, menaxher i Fakultetit Sistemet e Informacionit

Teknologjia po luan një rol gjithnjë e më integral në të gjitha aspektet e rëndësishme të jetës sonë. Ajo ka gjetur rrugën e saj në shtëpitë tona, sistemin arsimor, punën dhe ndërveprimet tona sociale gjithashtu.

Në këtë epokë informacioni, UBT përmes Fakultetit të Sistemeve të Informacionit përgatit studentët me aftësitë dhe teknologjitë e nevojshme për të pasur një karrierë me plotë suksese në jetën e tyre.

Sistemet e Informacionit nuk janë thjesht në lidhje me kompjuterët, ose trajnim se në përdorimin e kompjuterik dhe paketave kompjuterike të njohura si Microsoft Office. Bëhet fjalë për mënyrën se si bizneset mund të përdorin më mirë teknologjinë kompjuterike për të siguruar informacionin e nevojshëm për të arritur qëllimet e tyre.

Në të njëjtën mënyrë si nevojat dhe prioritetet tuaja janë unike për ju, secila organizatë ka qëllime dhe kërkesa të ndryshme dhe zbatimi i suksesshëm i sistemeve të informacionit kërkon një kuptim të plotë të çështjeve të biznesit, si dhe të teknologjive të ndryshme që janë në dispozicion.

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të pajisë të diplomuarit me teoritë dhe praktikën e sistemeve moderne të informacionit dhe shërbimeve në nivele kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare. Programi u mundëson studentëve të fitojnë njohuri për aspekte të rëndësishme të sistemeve të informacionit, për dizajnimin, organizimin dhe menaxhimin e sistemeve të informacionit. Kompjuterët bazuar në sistemet e informacionit janë bërë një pjesë kritike e produkteve, shërbimeve, operacioneve dhe menaxhimit të organizatave.

Përdorimi efektiv dhe efikas i informacionit dhe teknologjisë së komunikimit është një element i rëndësishëm në arritjen e avantazheve konkurruese për organizatat e biznesit dhe përsosmërinë e shërbimeve qeveritare dhe organizatat jo-fitimprurëse. Teknologjia e informacionit/Strategjia e sistemeve të informacionit është një pjesë integrale e strategjisë organizative.

Sistemet e informacionit mbështesin proceset e menaxhimit në të gjitha nivelet – menaxhimin operacional, taktik dhe strategjik. Sistemet e informacionit janë jetike për identifikimin e problemeve, analizave dhe vendimmarrjes. Rëndësia e teknologjisë së informacionit dhe sistemeve të informacionit për organizatat dhe nevojën për arsimim të mirëfilltë të profesionistëve në këtë fushë është bazë për një lidhje të fortë në mes të programeve arsimore dhe komunitetit profesional të praktikantëve të sistemeve të informacionit. Ne synojmë që përmes programit tonë studentëve t'ju ofrojmë njohuri themelore të elementeve të ndryshme të sistemeve të Informacionit si dhe funksionaliteti i tyre që mund të kombinohen në mënyra të ndryshme për t'iu përshtatur nevojave të veçanta të biznesit.

Shumë studentë mendojnë se Sistemet e Informacionit është vetëm rreth programimit, por në të vërtetë programimi është një pjesë e vogël (por e rëndësishme) e zhvillimit të sistemeve të informacionit për organizatat. Është për studentin të vendosë nëse dëshirojnë të vazhdojnë më tej pas prezantimit bazë të programimit që marrin gjatë studimit të Sistemeve të Informacionit ose të përqendrohet në një nga shumë fushat e tjera të interesit të mundshëm.

Përparimet në teknologji jo vetëm që kërkojnë njerëz që mund të punojnë me harduerë dhe softuerë (Specialistë të Teknologjisë së Informacionit), por edhe ata individë që kanë një kuptim të qartë se si organizatat përdorin kompjuterët për të funksionuar në mënyrë efektive dhe efikase. Aftësia për të kuptuar proceset e ndryshme të biznesit dhe për të krijuar një lidhje midis përdoruesve apo konsumatorëve dhe teknologjisë është roli kryesor i Specialistëve të Sistemeve të Informacionit.

Programi i Sistemeve të Informacionit ofron mundësi të ndryshme të karrierës. Andaj, studentët mund të gjejnë një zonë që i intereson atyre dhe ta ndjekin më tutje. Megjithatë mundësitë e karrierës janë të shumta, secili prej tyre kërkon që një i diplomuar të ketë këto shkathtësi themelore:

- Aftësitë analitike
- Aftësitë ndërpersonale
- Aftësi prezantimi
- Aftësitë e identifikimit të problemeve
- Raportimi dhe aftësitë e shkrimit
- Aftësitë e vetë-zhvillimit
- Aftësitë e menaxhimit të kohës

Mundësitë e karrierës në fushën e sistemeve të informacionit përfshijnë:

- Analist i sistemeve të biznesit
- Menaxher i Projektit
- Administratori i bazës së të dhënave
- Inteligjenca e biznesit
- Konsulent ICT
- Web design
- Programmer
- Arkitekt i Sistemeve

Departamenti do të ndihmojë të gjithë të diplomuarit e Sistemit të Informacionit, për aq sa është e mundur, për të siguruar mundësi punësimi, për shembull, duke organizuar praktika që mund të çojnë në punësim të përhershëm dhe duke ftuar punëdhënësit potencialë që të vizitojnë Departamentin dhe të kryejnë intervista. Niveli i suksesit që një student do të arrijë do të mbështetet shumë në nivelin në të cilin ata kanë zotëruar aftësitë bazë të renditura më herët.

UBT është bërë qendër testimi për TOEFL ITP®, TOEIC ®L&R dhe TFI™

UBT është shndërruar në një qendër të gjuhëve të huaja, ku përveç IBT- TOEFL, tashmë është qendër testimi edhe për testet TOEFL ITP®, TOEIC ®L&R dhe TFI™, që ofrohen në formatin 'paper based'.

Rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi dhe prof. ass. Ines Dika, si përfaqësuese e përhershme e S.T.A (Country Master Distributor for ETS), kanë nënshkruar bashkëpunimin për ofrimin e testeve standardizuese ndërkombëtare (TOEFL ITP®, TOEIC ®L&R dhe TFI™), për sigurimin e standardit gjatë procesit të testimit të gjuhës angleze dhe frënge, si dhe për garantimin e certifikimit zyrtar të rezultatit të arritur gjatë testimit.

Të gjitha këto teste janë të akredituara nga CEFRL dhe janë të njohura ndërkombëtarisht.

Të gjitha këto teste janë të akredituara nga CEFRL dhe janë të njohura ndërkombëtarisht.



TOEIC TFI TOEFL ITP

Qendra Këshilluese për Studentë

Qendra Këshilluese e UBT-së mbështet studentët në aspektin psikologjik

Qendra Këshilluese për Studentë në UBT, e udhëhequr nga psikologjia/psikoterapistja e licencuar Vjollca Pllana Shahini, është e para dhe e vetmja qendër e llojit të vet në Kosovë dhe në rajon. Qëllimi i qendrës është të promovojë rëndësinë e shëndetit mental tek studentët, si dhe atyre tu ofrojë përkrahje psikologjike. Si një mjedis i ngrohtë, i sigurt, mirëkuptues, i besueshëm dhe konfidencial, Qendra u mundëson studentëve që të shprehin shqetësimet e tyre, të njohin e të kuptojnë më mirë vetveten e personat e rëndësishëm në jetën e tyre, si dhe të eksplorojnë e të kuptojnë burimin e vështirësive dhe të dilemave me të cilat ata përballen. Përmes pjesëmarrjes së rregullt në këshillim psikologjik dhe psikoterapi, studentët kanë mundësi edhe të përfitojnë shkathtësi efektive për të tejkaluar situata stresuese, si dhe të bëhen më të qëndrueshëm e më rezilient. Mbi të gjitha, përkrahja profesionale psikologjike mund të ketë ndikim të madh dhe afatgjatë për tu shtuar mundësi studentëve që të arrijnë potencialin e tyre të plotë në sferën personale dhe akademike



Qendra Këshilluese për Studentë në UBT, e udhëhequr nga psikologjia/psikoterapistja e licencuar Vjollca Pllana Shahini, është e para dhe e vetmja qendër e llojit të vet në Kosovë dhe në rajon. Qëllimi i qendrës është të promovojë rëndësinë e shëndetit mental tek studentët, si dhe atyre tu ofrojë përkrahje psikologjike. Si një mjedis i ngrohtë, i sigurt, mirëkuptues, i besueshëm dhe konfidencial, Qendra u mundëson studentëve që të shprehin shqetësimet e tyre, të njohin e të kuptojnë më mirë vetveten e personat e rëndësishëm në jetën e tyre, si dhe të eksplorojnë e të kuptojnë burimin e vështirësive dhe të dilemave me të cilat ata përballen. Përmes pjesëmarrjes së rregullt në këshillim psikologjik dhe psikoterapi, studentët kanë mundësi edhe të përfitojnë shkathtësi efektive për të tejkaluar situata stresuese, si dhe të bëhen më të qëndrueshëm e më rezilient. Mbi të gjitha, përkrahja profesionale psikologjike mund të ketë ndikim të madh dhe afatgjatë për tu shtuar mundësi studentëve që të arrijnë potencialin e tyre të plotë në sferën personale dhe akademike.

Shërbimet, aktivitetet dhe të arriturat e Qendrës Këshilluese për Studentë

Qendra Këshilluese për Studentë në UBT u themelua në shkurt të vitit 2018. Që nga ajo kohë, ka ofruar shërbime përkrahëse psikologjike, pa pagesë, siç janë: Këshillimi Individual, Këshillimi Grupor dhe Punëtori për të gjithë studentët e të gjitha niveleve dhe drejtimeve të studimeve. Në ditët e para të themelimit, psikologjia e qendrës Vjollca Pllana Shahini, përmes Media Grup në UBT lansuan një video informuese dedikuar studentëve, me temën "Si të menaxhojmë stresin gjatë kohës së provimeve." Fakti se brenda disa ditësh, numri i shikuesve të videos tejkaloi numrin njëzet e tre mijë (23000), vërtetoi se studentët ballafaqohen me një rrezik të shtuar për të përjetuar stres dhe ankth, si dhe ata kanë nevojë të theksuar për informata, udhëzime dhe mbështetje për të tejkaluar këto fenomene të dëmshme për shëndetin e tyre të gjithmbarshëm, e posaçërisht atij emocional e mendorë, gjatë jetës studentore.

Gjatë muajit mars, 2018, psikologjia e qendrës organizoi punëtori në tri lokacione të UBT-së: Prishtinë, Lipjan dhe Ferizaj, me temën "Si të menaxhojmë ankthin." Në këto punëtori morën pjesë rreth gjashtëdhjetë studentë të programeve të ndryshme të studimeve si: Infermieri, Dizajn, Shkenca Kompjuterike, MBE, Shkenca Politike. Shkenca të ushqimit dhe Mekatronikë. Punëtorja u fokusua në ofrimin e informatave thelbësore rreth ankthit përmes psikoedukimit dhe ndërtimit të shkathtësive bazike për të menaxhuar dhe tejkaluar atë. Shumë studentë pjesëmarrës u shprehën të kënaqur me informatat që përfituan rreth ankthit dhe menaxhimit të tij dhe si rezultat disa prej tyre shprehën interesim për të përfituar nga shërbimet tjera të qendrës, siç është këshillimi individual.

Në prill, 2018 filluan regjistrimet e para të studentëve të cilët shprehën gatishmëri për të përfituar nga shërbimet përkrahëse të qendrës. Gjatë muajve në vijim ka pasur ngritje konstante në numrin e studentëve të cilët përfituan nga shërbimet e qendrës. Të gjithë studentët të cilët janë pranuar në Qendrën Këshilluese dhe

kanë përfituar nga këshillimi, sipas protokollit, në seancën e parë kanë plotësuar:

- Fletë pëlqimin për marrjen e shërbimeve psikologjike, dhe
- Formularin e pranimit të klientit/studentit.

Duke u bazuar në Etiken Profesionale të Psikoterapisë dhe Këshillimit Psikologjik të ruajtjes së anonimitetit dhe konfidencialitetit të të gjithë përfituesve të Qendrës, të gjitha dokumentet vendosen në folder, i cili pastaj vendoset në inventarin e mbyllur me çelës, në mënyrë që të gjitha informatat e paraqitura në to të mbahen konfidenciale. Vlen të theksohet se ndër shqetësimet dhe vështirësitë më të shpeshta të shprehura nga studentët janë: marrëdhënie të vështira ndër-personale, vështirësi në koncentrim, ankth dhe stress të theksuar gjatë provimeve, vështirësi për të tejkaluar ngjarje traumatike, simptoma depresive, vështirësi në menaxhimin e zemërimit, etj. Secilit student që iu drejtua qendrës iu ofrua përkrahja profesionale nga psikologjia, dhe pothuajse të gjithë vijuan me rregull seancat në baza javore, në mënyrë që të arrihen sa më shumë qëllimet e synuara të këshillimit, të përcaktuara bashkërisht me psikologun në takimin e parë. Si rezultat është vërejtur një përmirësim gradual, por i dukshëm i gjendjes së studentëve të rregullt në seanca.

Pjesa dërmuese e studentëve që iu drejtuan qendrës preferuan këshillimin individual dhe një numër më i vogël i studentëve kërkuar këshillim grupor. Psikologjia (citim): "Këshillimi individual me studentë sistematikisht ka dëshmuar efektshmëri të lartë, pasi që u ofron studentëve mundësinë për të krijuar një marrëdhënie terapeutike me një profesionist/psikolog në nivel personal. Ndarja e shqetësimeve personale, të cilat të rinjtë dhe të rejtat ndoshta janë munduar gjatë për ti luftuar vetë, me një person të paanshëm, shpeshherë sjellin lehtësim. Përmes këshillimi individual shumë studentë kanë filluar të kuptojnë në mënyrë më objektive eksperiencat dhe brengat e veta, duke i lidhur ato me rrethanat personale, familjare e shoqërore. Kjo shpeshherë ndikon tek një ndryshim i pikëpamjes së problemit, dhe në ngritje të shkathtësive për të tejkaluar atë." Që nga prilli i vitit 2018 deri në prill të vitit 2019 janë mbajtur rreth 150 seanca me studentë.

Në korrik, 2018, Qendra Këshilluese ka ideuar, organizuar dhe implementuar Akademinë e parë Ndërkombëtare Verore në Psikologji, si bartëse e tematikave psikologjike, me temën kryesore "Reziliencia njerëzore." Në Akademinë Verore morën pjesë rreth 21 studentë nga UBT dhe nga institucione të ndryshme të edukimit të lartë vendore dhe ndërkombëtare, si: Universiteti I Prishtinës, Universiteti i Tetovës, Universiteti i Sheffildit, kolegji AAB, etj. Gjatë Akademisë Verore, Qendra Këshilluese ka themeluar bashkëpunim të ngushtë me organizatat ndërkombëtare dhe vendore, si:

- Qendra Psikosociale për Traumatëri-Diakonie;
- Fondacioni Together Kosova, me platformen online Nukjvet.net;
- Peer Educators Network-PEN; si dhe
- SOS Fshatrat e Fëmijëve.

Të gjitha këto organizata ofrojnë mbështetje dhe aktivitete psiko-sociale për njerëzit në nevojë, e posaçërisht të rinjtë, dhe duke sjellë përvojat e tyre profesionale, e bënë Akademinë Verore më informative, më të larmishme dhe më atraktive për studentët.

Qasja në Qendrën Këshilluese për Studentë Qendra gjendet në Kampusin Inovativ në Lipjan, në Objektin 3, nr. G303. Me qasjen studentit-në-qendër, ajo është themeluar që tu ndihmojë atyre që të adresojnë dilemat dhe sfidat personale dhe emocionale, dhe përmes terapisë së shkurtër dhe të fokusuar të fuqizojë ata për të arritur potencialin e plot personal dhe akademik.

Të gjithë studentët e të gjitha niveleve dhe drejtimeve mund të kërkojnë termin duke kontaktuar personalisht psikologun apo përmes email-it zyrtar: qendra.keshilluese@ubt-uni.net

Gjatë muajve të verës, Qendra Këshilluese do të jetë e qasshme dhe do të vazhdojë të ofrojë shërbime për të gjithë studentët të cilët shprehin nevojë për mbështetje psikologjike. Gjithashtu, seancat me të gjithë klientët ekzistues të cilët janë në proces të trajtimit afat-gjatë do të vazhdojnë të mbahen rregullisht edhe gjatë pushimit veror, duke iu përshtatur nevojave dhe disponueshmërisë së studentëve. Gjatë muajit korrik, qendra sërish do të jetë pjesë e Akademisë Ndërkombëtare Verore. Udhëheqësja e qendrës, psikologjia Vjollca Pllana Shahini thekson "vitin e kaluar Akademia Verore e Qendrës shënoi sukses të lartë dhe u mirëprit nga studentët, sidomos për faktin se përveç njohurive që u ofroi, u dha atyre edhe mundësi që të ndajnë brengat brenda grupit, të kalojnë nëpër një lloj përpunimi personal e grupor, dhe të zhvillojnë shkathtësi të reja për fuqizimin e reziliencës. Kjo më motivon që edhe sivjet, në bashkëpunim me bashkëpunëtorët e qendrës, të organizoj diçka të ngjashme për studentët tanë nikoqir dhe atyre mysafir nga vendet tjera"

Publikohet libri “Shkathtësitë e shkrimit” i profesorit Safet Zejnullahu



“Shkathtësitë e shkrimit” është libri i ri i profesorit Safet Zejnullahu, i publikuar nga UBT.

Ky është libri i tretë i profesorit Zejnullahu, dedikuar studentëve të gazetarisë, por edhe profesionistëve të kësaj fushe.

Në rreth 400 faqe, libri trajton specifikat e shkrimit gazetaresk, me specifika të veçanta të medias: shkrimin për median e printuar, radio gazetarinë, gazetarinë televizive, ndërsa me theks të veçantë trajton shkrimin për median e internetit. Në këtë kuadër, specifikë e veçantë e librit është trajtimi i marrëdhënies së re media-publik. Ai trajton një numër të madh çështjesh që ndërlidhen me qasjen e medias së re ndaj publikut dhe qasjen e publikut të kohës së internetit ndaj medias.

Libri është i plotësuar me shembuj të shumtë tekstesh dhe figurash e grafikësh, që e plotësojnë atë dhe e bëjnë më tërheqës dhe më të kompletuar.

“Gazetaria ka ndryshuar, me zhvillimin e teknologjisë. Teksti gazetaresk ka ndryshuar po kështu. Nga informacionet e gjata dhe shpesh monotone të medias tradicionale, kur një ngjarje mund të mos përfshihej në edicionet e sotme të lajmeve apo në faqet e gazetës së nesërme, gazetarët sot përballen me garën për lajmin sa më të shpejtë. Thjesht, sot koha e publikimit të një informacioni matet me sekonda, jo më me minuta, orë ose ditë”, thekson autori Zejnullahu në parathënien e librit.

Ai thekson gjithashtu specifikat e medias së re dhe qasjen që duhet të kenë profesionistët e gazetarisë sot.

“Gazetarët sot shkruajnë për lexuesin “shumë të zënë”, për lexuesin me mundësi të pakufishme të burimeve për ta marrë informacionin, për lexuesin gjithnjë më të informuar. Prandaj, shkrimi dhe raportimi për lexuesin e kohës sonë është kthyer në një sfidë, në garë me të cilën shpesh gazetarët gjenden edhe para dilemave rreth parimeve të profesionalitetit”, shkruan profesori Zejnullahu.

“Shpresoj që ky libër, përveç studentëve të gazetarisë, t’u hyjë në punë edhe të gjithë profesionistëve, të cilët sot kryejnë punën e gazetarit, përmes formave të pakufishme të komunikimit me publikun, të mundësuar nga zhvillimi i teknologjisë”, shton ai.

UBT boton librin Marketingu Ndërkombëtar, i ligjëruesit dr. Nehat Ramadani


Ligjëruesi në UBT, prof.dr Nehat Ramadani ka botuar librin e tij me titull: “Marketingu Ndërkombëtar”, në të cilin pasqyrohen aktivitetet bazike dhe zhvillimet në fushën e marketingut.

Libri është botuar nga UBT, teksta në të paraqiten edhe strategjitë e marketingut dhe aplikimi i tyre në tregun vendor dhe ndërkombëtar.

Libri “Marketingu Ndërkombëtar” është i ndarë në njëmbëdhjetë kapituj, të cilët si tërësi trajtojnë në mënyrë të përmbledhur dimensionin e marketingut përtej kufijve nacionalë, ndërsa çdo kapitull fillon me përshkrimin dhe objektivat që pretendohen të arrihen.

Po ashtu, paraqiten edhe raste studimore ku provokojnë mendimin kritik të lexuesit për fushën konkrete.

Profesori Nehat Ramadani që nga viti 2012 ligjeron lëndët nga fusha e marketingut në UBT, dhe ka të botuar disa libra. Ai është autor i më shumë se 50 artikujve shkencor, të prezantuar në konferenca dhe zhurnale ndërkombëtare.



Profesori nga Portugalia, Jorge Isidoro mbajti ligjëratë për studentët e FIN-it



Profesori nga Universiteti Algarve, në Portugali, Jorge Isidoro, për studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës, ka mbajtur ligjëratë tematike më temë “Hidrologjia Urbane, përmytjet dhe vërshimet në zona urbane”.

Gjatë kësaj ligjërate ai sqaroi rolin dhe rëndësinë e hidrologjisë dhe modeleve hidrologjike për parashikimin dhe evitimin e vërshimeve dhe përmytjeve.

Profesori Isidoro përmendi aspektet e modelimit hidrologjik për mbrojtjen e zonave urbane dhe çështjet tjera të rëndësishme që duhet konsideruar në fazën e planifikimit dhe ndërtimit në zona urbane.

Kjo ligjëratë u mbajt me qëllim të zhvillimit, avancimit dhe ngritjes së cilësisë së studimeve dhe njohurive për studentet e nivelit master.



- 18 vite libër i Arsimit të Lartë
- 1 sistem i certifikuar me 5 vite për cilësimin ISO 9001
- 1 certifikuar sipas standardit ISO 9001:2017 për cilësi
- Partner i EON Realty për themeliminë e Qendrës për Realitet Virtual dhe të Situar në Kosovë
- Përfundim për herë të katërt nga Kosova i Programit Evropian, Erasmus Mundus
- Përfundim i programit për bursë, Agjencitë (AEP)
- Përfundim i Kosovës në organizata evropiane dhe botërore
- Kampion Evropian në Robotikë
- Kampus i parë për shkencë dhe inovacion

ZGJEDH MË TË MIRIN QË TË BËHESH MË I MIRI!

Come to UBT and Go International...

PROGRAMET E AKREDITUARA

SHKENCA KOMPUTERIKE DHE INXHINIERI

- Inxhinieri e Sistemeve Software
- Baza e të Dhënave dhe Sistemet e Informacionit
- Grafika Komputerike dhe Multimedia
- Web Programim
- Rrjeta dhe Telekomunikacion
- Robotikë dhe Sistemet Inteligjente
- Informatikë Biomjekësore
- Siguria dhe Sigurimi i Informacionit
- Multimedia dhe Vizualizim
- Inxhinieri e Komunikimit
- Shkenca e të Dhënave Statistike
- Informatikë Mjekësore

MENAXHMENT, BIZNES DHE EKONOMI

- Financa, Banka dhe Sigurime
- Kontabilitet, Auditim dhe Tatime
- Marketing dhe Shitje
- Menaxhment, Ndërmarrësi dhe Inovacion
- Biznes Ndërkombëtar
- Logjistikë dhe Menaxhim i Prokurimit

MEKATRONIKË DHE MENAXHMENT

- Menaxhim i Mekatronikës
- Automatizim Industrial dhe Kontroll i Procesit
- Robotikë dhe Sisteme Inteligjente
- Inxhinieri Biomjekësore
- Inxhinieri e Telekomunikacionit
- Inxhinieri Mekanike
- Inxhinieri e Aeronautikës
- Dizajn i Produkteve Industriale
- Inxhinieri e Proceseve të Prodimit

SISTEMET E INFORMACIONIT DHE MENAXHMENT

- Sistemet e Informacionit të Biznesit
- Sistemet e Informacionit - GIS (Geo Information Systems)
- Sistemet e Informacionit të Bibliotekave dhe të Arkivave
- Statistika, Procesimi dhe Simulimi i të Dhënave
- Siguria e Informacionit dhe Privatësia
- Komercil Elektronik (E-Komercil)

ARKITEKTURË DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR

- Arkitekturë e Qëndrueshme
- Menaxhim Urban
- Restaurim Arkitekturor
- Dizajni i Interierit

INXHINIERI NDËRTIMOR (NDËRTIMTARI) DHE INFRASTRUKTURË

- Inxhinieri Strukturor - Konstruktiv
- Menaxhim i Ndërtimitarisë dhe Teknologjisë
- Infrastruktura Rrugore
- Inxhinieri e Ujrave - Hidro
- Inxhinieri e Gjeoteknikës
- Inxhinieri e Materialeve

SHKENCA POLITIKE

- Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci
- Integritime Evropiane
- Administratë Publike

JURIDIK

- Civile
- Pensale
- Ndërkombëtare

E DREJTA BIZNESORE NDËRKOMBËTARE DHE EVROPIANE

MEDIA DHE KOMUNIKIM

- Gazetari
- Komunikim
- Menaxhimi i Medias
- Marrëdhënie me Publikun
- Regjia Televizive
- Gazetaria On-Line
- Kamera dhe Fotografia

POLITIKA PUBLIKE DHE MENAXHIM

- Politika Publike
- Menaxhimi Publik

INFERMIERI

FARMACI

STOMATOLOGJI

INXHINIERI E ENERGJISË DHE MENAXHMENT

- Burimet e Energjisë
- Konservimi i Energjisë
- Efienca e Energjisë
- Menaxhimi i Energjisë
- Energji Elektrike

DIZAJNI INTEGRUAR

- Dizajni Grafik dhe i Komunikimit
- Dizajni Mode dhe Tekstil
- Dizajni i Produkteve
- Dekorimi i Ndërtësive dhe Mobilimi

SHKENCAT E USHQIMIT DHE BIOTEKNOLOGJI

- Teknologji e Ushqimit
- Nutricion (Të Ushqyerit)
- Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë e Ushqimit

PROGRAMET NË PROCES TË AKREDITIMIT JANË:

- Muzika Moderne, Prodhimi Digital dhe Menaxhimi
- Laborant i Biokimisë Mjekësore
- Teknik i Radiologjisë
- Teknik dentar
- Inxhinieria e Agrikulurisë dhe Mjedisit
- Arti dhe Mediat Digjitale

- Shkenca Politike MA
- Energjia Elektrike dhe Tregu i Energjisë
- Shkenca e Ushqimit dhe Bioteknologji MA
- E Drejta Civile dhe Pronës
- E Drejta Penale
- Juridik, Krimnologji kompjuterike dhe Forenzikë

REGJISTRIMI

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

Diploma, dëftesat e notave, certifikatat pikëve të maturës, certifikata e lindjes dhe kopja e letërnjoftimit.

Gjuha e studimeve:

Gjuhë shqipe, gjjuhë angleze, si dhe mundësia e studimit në gjjuhë të tjera. Ofrohen ligjërrata edhe pas orarit të punës dhe gjatë fundjavës.

Mënyra e studimit:

UBT ofron ligjërrata të mequlita, me korrespondencë dhe studim në distancë. Ofrohen ligjërrata edhe pas orarit të punës dhe gjatë fundjavës.

Për sukses të garantuar, UBT ofron për studentët:

- Orientim dhe praktika profesionale, kurse, vizita dhe certifikime;
- Sistem online dhe qasje në kompjuterë
- Licenca falas për softuerë
- Internship në kompani vendore dhe ndërkombëtare;
- Librari me mbi 200 mijë tituj dhe qasje në libraritë elektronike botërore;
- Praktika dhe eksperimente në laboratorë bashkëkohorë;
- Trajtime: CISCO, Microsoft, AutoCad, ECDL, IPMA, etj.
- Certifikime për kontabilistë në bashkëpunim me SCAA-K.

Financat dhe pagesat:

- Qmimi i studimeve për një vit akademik në Bachelor është 12000€, për nivelin Master është 15000€, me mundësi pagese deri në 12 kështe.
- Për të gjithë nxënësit e dalluar, UBT ofron bursa studimi.

UBT ofron zbritje deri në 50% edhe për këto kategorit:

- Të punësuarit në Doganat e Kosovës;
- Pjesëtarët e FSK-së dhe Policisë së Kosovës;
- Të punësuarit në institucionet publike të Kosovës;
- Familjarët e dëshmoreve dhe veteranëve të luftës;
- Studentët që vijnë nga njëjta familje dhe si grup;
- Studentët që paguajnë në fillim të vitit akademik;
- Studentët e punësuar në Policinë e Kosovës;
- Studentët me sukses të shkëlqyeshëm;
- Studentët të cilët kanë arritur 100% në testim kombëtar dhe kanë të gjitha 5 në shkollimin paraqark;
- Studentët e Luginës së Preshevës, Malit të Zi;
- Studentët që marrin pjesë në programin përgatitor të maturës.